RRJETI BALLKANIK PËR ZHVILLIMIN E SHOQËRISË CIVILE

Në bashkëpunim me

ecas
European Citizen Action Service

# Praktika Qytetare Ballkanike #3

## Udhëzues mbi Financimet e Bashkimit Europian për OJF-të

**Partnership in Action - Strengthening Balkan Civil Society Development Network**
This project is funded by the European Union
**Partneriteti në veprim - Rrjeti ballkanik për zhvillimin e shoqërisë civile**
Ky projekt është i financuar nga Bashkimi Evropian

© Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile dhe ECAS

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë nga publikimi nuk mund të riprodhohet pa lejen e Rrjetit Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

Kopje të publikimit mund të porositen me anë të postës ose me e-mail.

**Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (BCSDN)**
Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN) — Sekretariati
Drejtor ekzekutiv i QMBN: Sasho Klekovski
Koordinator i BCSDN: Tanja Hafner — Ademi
Adresa: Nikola Parapunov p.n. f.p. 55, 1060 Shkup, Maqedoni
E-mail: secretariat@balkancsd.net

Botues: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar
Botues Kryesor: Tanja Hafner — Ademi
Autor: Marika Harjula, ECAS, Belgjikë
Redaktuar: Pandeli Theodhori dhe Daniela Dyrmishi
Përkthyer në shqip: Albanian Civil Society Foundation (ACSF)
Dizenjimi dhe faqosja: Koma, Shkup, Maqedoni
Shtypur nga Borografika, Shkup, Maqedoni
Botuar në Maqedoni, Janar 2007

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека
„Св. Климент Охридски",
Скопје

341.171.073.52 (4-672EU) : 061.2(036)

HARJULA, Marika
Udhëzues mbi financimet e Bashkimit Evropian për OJQ-të/ [author Marika Harjula]. - Shkup : Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN) 2007. – 254 str.; 24 cm. - (Praktika Qytetare Ballkanike 3)

ISBN 987-9989-102-40-6

а) Европска унија - Финансирање невладини организации - Водичи

COBISS.MK-ID 68288010

*Ky dokument është botuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e BCSDN dhe ECAS dhe nuk reflekton qëndrimet e Bashkimit Evropian.*

# PËRMBAJTJA

**KAPITULLI 1** **7**

**Hyrje në Fondet e BE-së** **7**

- **1.1 Pamje të përgjithëshme** **7**
- **1.2 Buxheti i BE-së** **10**
- **1.3 DG-të dhe Shërbimet e lidhura me Financimin e Jashtëm** **13**
- **1.4 Reforma e administrimit të ndihmës nga jashtë** **16**
- **1.5 Këshilla të SHEAQ për rritjen e fondeve të jashtme** **16**
- **1.6 Anekse** **20**

**KAPITULLI 2** **22**

**Financimi nga Fondacione dhe Korporata Sponsore** **22**

- **2.1 Hyrje për Fondacionet** **22**
- **2.2 Kategorizimi** **23**
- **2.3 Financimi i Fondacioneve** **24**
  - 2.3.1 Karakteristika të sektorit të fondacioneve **24**
  - 2.3.2 Sektori i fondacioneve në Shtetet e reja të BE-së **25**
- **2.4 Një Hartë e Sektorit te Fondacioneve** **25**
- **2.5 Proçesi i Aplikimit** **28**
  - 2.5.1 Kërkime paraprake **28**
  - 2.5.2 Bazat e Projekt-Propozimeve **31**
- **2.6 Hyrje për Korporatat Sponsore** **33**
- **2.7 Profile fondacionesh dhe korporatat sponsore** **33**
  - 2.7.1 Fondacionet **33**
  - 2.7.2 Korporatat sponsore **65**

**KAPITULLI 3** **70**

**Zërat e Buxhetit të Brëndshem** **70**

**3.1 Lista e zërave të Buxhetit** **70**

3.1.1 Audiovizive, Media, Shtypi, Komunikimi dhe Informacioni **75**

3.1.2 Shoqëria Civile,Shoqatat Evropiane, Evropa e Përparuar, OJQ-të **83**

3.1.3 Edukimi, Trajnimet,Rinia dhe Kultura **90**

3.1.4 Punësimi dhe Punët Sociale **98**

3.1.5 Energjia dhe Transporti **106**

3.1.6 Zgjerimi **110**

3.1.7 Ndërmarrjet **112**

3.1.8 Mjedisi **115**

3.1.9 Shëndetësia dhe Mbrojtja e Konsumatorit **121**

3.1.10 Drejtësia dhe Tregëtia Vëndase **125**

3.1.11 Kërkimi, Zhvillim Teknologjik **133**

**KAPITULLI 4** **137**

**Fondet Strukturore dhe Fondi i Kohezionit** **137**

**4.1 Politika e BE për kohezionin shoqëror, ekonomik dhe territorial** **138**

4.1.1 Të përgjithëshme **138**

4.1.2 Programimi dhe parimet thelbësore **141**

**4.2 Fonde strukturore dhe aktuale** **146**

4.2.1 Fonde strukturore dhe Fondi i Kohezionit 2000-2006 **146**

4.2.2 Fonde strukturore dhe Fondi i Kohezionit 2007-2013 **155**

4.2.3 Evoluimi i Instrumentave dhe Objektivave **160**

**KAPITULLI 5** **161**

**Zërat e Buxhetit të Jashtëm** **161**

**5.1 Lista e zërave të Buxhetit** **161**

**5.2 Programet financues** **164**

5.2.1 Informacion i përgjithshëm mbi Programet Financues **164**

5.2.2 Programet sipas kategorive tematike **165**

**KAPITULLI 6 207**
**Ndihma për Para-Pranimit, Ndihma per Ballkanin Perendimor dhe Politika Evropiane e fqinjësisë 207**
**6.1 Ndihma Para-Pranimit 207**
6.1.1 Instrumenta për Ndihmë Para-Pranimit (IPA) **207**
6.1.2. Evropa Qëndrore dhe Lindore **213**
6.1.3. Turqia **222**
**6.2. Ndihma për Ballkanin Perëndimor – CARDS 224**
**6.3. Politika e Fqinjësisë Evropiane (PFE) 229**
6.3.1 Vëndet jo anëtare të Mesdheut **234**
6.3.2. Zëra të tjerë të Buxhetit të pa mbuluara nga MEDA **236**
6.3.3. Evropa Lindor dhe Azia Qëndrore – TACIS **237**
6.3.4. Faqe interneti të vlefeshme **241**

**KAPITULLI 7 243**
**Lidhje të vlefëshme dhe kontakte 243**

**RRETH SHËRBIMIT EUROPIAN TË AKSIONIT QYTETAR (SHEAQ) 250**
**RRJETI BALLKANIK PËR ZHVILLIMIN E SHOQËRISË CIVILE (BCSDN) 252**
**QENDRA MAQEDONASE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR (QMBN) 255**

# KAPITULLI 1

## Hyrje në Fondet e BE-së.

### 1.1 PAMJE TË PËRGJITHËSHME

Qëllimi i udhëzuesit tonë është që të japë një pamje të përgjithshëme, e cila përmbledh informacionin e shpërndarë nëpër faqe interneti të Drejtorive të Komisionit të Përgjithshëm.
Nëse ju përdorni udhëzuesin tonë për të identifikuar programme të mundshme me interes dhe pastaj të shkoni në faqen e internetit të përcaktuar, ju do të gjeni më shumë detaje për programet dhe thirrjet për tender, megjithëse shuma varjon nga një drejtori e përgjithshme tek tjetra. Shembuj të tipeve të projekteve të financuara janë të vlefshme në faqet e internetit të disa Drejtorive të Përgjithshme.
Komisioni Evropian pa diskutim është donatori më i madh i Evropës. Është vënë re që një bilion Euro (nga një total prej 100 bilion Eurosh) është i vlefshëm per projektet e OJQ-ve, e megjithatë kjo është vetëm maja e ajsbergut. Shumë punë është bërë në dekadën e fundit nga vetë OJQ-të me mbështetjen e Parlamentit Evropian për të zgjeruar një buxhet të fokusuar më teper në politikat ekonomike në çdo zonë aktiviteti të prodhuar nga shoqatat e qytetarëve. Kështu që çështja nuk është mungesa e programeve apo fondeve. Ato mbulojnë një hapësirë shumë të madhe veprimi. Praktikisht çdo projekt që ka një dimesion vërtet Evropian dhe mund të lidhet me politikat e BE-së duhet të gjejë një fond korrespondues. Çështja lidhet më tepër me gjetjen e një strategjigje të mirë për të patur të drejtë hyrjeje në buxhetin e BE-së.

**Mbledhja e suksseshme e fondeve fillon me zotësinë për të hyrë në informacione të sakta për atë që kërkohet**

Nëse ju dhe organizata juaj i jepni kohë vetes për të përshtatur një pamje të përgjithshme strategjike dhe të caktoni rregullat bazë në mënyrë që të shmangni kurthet në nënshkrimet e kontratave dhe menaxhimit financiar, atëhere nuk ka asnjë arsye pse ju nuk do të mund të zgjeronit fushën e mundësive të ofruara nga projektet Evropiane. Kjo është arsyeja pse në këtë kapitull hyrës, ne kemi përfshirë këshilla për ta bërë financimin Evropian shumë më të lehtë.

Mbledhja e suksseshme e fondeve fillon me zotësinë për të hyrë në informacione të sakta për atë që kërkohet. Pastaj kjo duhet të ndiqet nga vendosmëria për t'i shkuar deri në fund. Gjithashtu do t'ju duhet të përcaktoni pro-të dhe kundra-t e financimit të BE-së. Nga anën tjetër, aspektet negative vërtiten përreth sistemeve burokratike dhe të ngurta. Veçanërishtë është e nevojshme që OJQ-të e vogla të kenë parasysh disavantazhet .

- Kërkesat financiare janë shumë të larta. Fatmirësisht ka patur disa lëshime në kërkesën për një garanci dhe nuk është gjithmonë e nevojshme që organizatat të kenë një të tillë. Megjithatë për ato raste kur kjo akoma kërkohet, gjetja e një garancie apo kërkesa e kapitaleve ose e mbështetjes me para në dorë në një klimë ku bankat, madje edhe ekonomia sociale dhe bankat e përbashkëta të afë afërta me sektorin, mund të jetë e pa mundur.

- Proçedurat e aplikimit janë shumë të rënda. Një përgjigje tipike ndaj një thirrje për propozime, shkrimi i një aplikimi, bërja e buxhetit në një format të veçantë, marrja e letrave të angazhimit nga bashkë-themeluesit dhe përballja me të gjithë kërkesat zyrtare siç janë deklaratat nga bankat dhe auditorët, është pothuajse një muaj punë. Të duhet të bllokosh një ditë për të vendosur të gjithë dokumentacionin në mënyrën e duhur në zarfe të mbyllura, para se të mbarojë afati. Është e rëndësishme të punosh shumë për të bërë aplikimin pasi ai mund të refuzohet thjesht për arsye formale: statutet ishin në gjuhën e gabuar, llogaritë mungonin, e kështu me rradhë.

- Një metodë tepër e ngurtë dhe e paracaktuar mund të frenojë krijushmërinë. Shpesh aplikimet arrijnë ose jo që t'i përshtaten objektivave tashmë ekzistuese, duke ngurtësuar programet e adoptuara tashmë nga Institucionet, më tepër sesa të rrezikojnë

duke shtyrë limitet e politikave. Për më tepër, variacionet e krijuara në buxhet ose ndryshimet në tabela janë shumë të ngushta duke e bërë të vështirë që OJF-të eksperimentojnë në mënyra të ndryshme zbatimin e gjërave në rrjedhën e projektit.

Nga ana tjetër, të punosh me fondet e BE-së mund të jetë shpërblyese. Megjithëse mbushja e formularëve të aplikimit është një barrë, është gjithashtu një ushtrim i mirë në planifikimin strategjik. Jo vetëm që rrit kapacitetet administruese financiare të një organizate, por gjithashtu i detyron OJQ-të të kërkojnë partnerë duke zgjeruar kështu rrjetet e tyre në shtete të tjera dhe tipe të tjera organizatash. Fondet e BE-së gjithashtu mund të përdoren shumë shpesh për të eksperimentuar me skema të reja- p.sh; për ripërtëritjen urbane, krijimin e njohurive të gjera duke u bërë pjesë e rrjeteve evropiane dhe duke dalë jashtë nga shabllonet e burimeve tradicionale të financimit nga qeveri apo autoritete vendore. Gjithashtu eksperiencat e marra nga puna me fondet e BE-së e bën më të lehtë të punën me organizma të tjerë financues.

Bashkimi Evropian është një nga aktorët më të rëndësishëm në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ndihmën për zhvillimi.
Komuniteti Evropian dhe shtetet anëtare sigurojnë në total më shumë se 50% të shumës të të gjithë botës si Asistencë Zhvillimi Zyrtar (AZHZ) dhe më shumë se 2/3 e subvencioneve. Vetë Komisioni ka një përllogaritje prej 10% të (AZHZ) botërore. Angazhimi i ndihmës së jashtme në fillim drejtohet nga katër Drejtori të Përgjithshme (DP) të Komisionit Evropian. Këto janë:

1) Zyra e Koperimit Ndihmë-Evropës.
2) DP për Marrëdhëniet e Jashtëme.
3) DP për Zhvillimin
4) Zyra Humanitare e Komunitetit Evropian

Kohët e fundit proçedura e Menaxhimit të ndihmës së jashtme që jepet nga BE ka qënë nën mbikqyrje. "Reforma e Ndihmës nga Jashtë" po shkon më shumë drejt efektshmërisë, përgjegjësisë ndaj problemeve në vendet në zhvillim dhe frutshmërisë në përdorimin e fondeve përfshirë një periudhë kohore prej katër vitesh (2000-2004). Reforma e cila tani është në vëndin e duhur, i jep më shumë autonomi dhe përgjegjësi delegacioneve të Komisioneve Europiane në vëndet në zhvillim. Si rezultat i kësaj, shumë fonde dhe linja buxhe-

**Bashkimi Evropian është një nga aktorët më të rëndësishëm në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ndihmën për zhvillimi. Komuniteti Evropian dhe shtetet anëtare sigurojnë në total më shumë se 50% të shumës të të gjithë botës si Asistencë Zhvillimi Zyrtar (AZHZ) dhe më shumë se 2/3 e subvencioneve. Vetë Komisioni ka një përllogaritje prej 10% të (AZHZ) botërore.**

tore do të menaxhohen në mënyrë të decentralizuar duke përfshirë drejtpërsëdrejti delegacionet e BE-së në shtetet përkatëse. Për më shumë informacion dhe për të rejat më të fundit në procesin e reformës, ju lutemi referohuni lidhjes së mëposhtëme:
http://www.europa.eu.int.comn/europeaid/reports/reforms_ def_ en.pdf

## 1.2 BUXHETI I BE-SË

*Prespektivat Financiare 2007-2013*

Ky udhëzues vjen në një kohë kur sapo është rënë dakord (prill 2000 për prespektivat financiare të 2007-2013-ës duke ndjekur marrëveshjen politike të BE-së, që u bë në fund të presidencës së Mbretërisë së Bashkuar në dhjetor 2005. Përfundimimi I dalë nga këto negociata mund të shihet si një kompromis.

Në komunikatën e tij (korrik 2004) Komisioni propozoi të rriste pjesën e të ardhurave të BE-së për të mbajtur 1.24% të Ardhurat Bruto Kombëtare (ABK), të cilat në çfarëdo rasti mund të nënkuptonin reduktim të burimeve të vlefshme si pasojë e zgjerimit. Kështu u propozua gjithashtu që struktura e prespektivës financiare të modifikohej në mënyrë që të arrihej një përdorim më i mirë i fondeve, duke pasur si fokus kryesor rritjen e konkurencës dhe punësimit. Megjithatë Këshilli i Dhjetorit 2005 ra dakord për prespektivat financiare 2007-2013 (siç ishin vendosur në dok.15915/05, një prozim nga presidenca Austriake) dhe për këtë reduktoi kufirin maksimal në vetëm 1.045% që do të thotë 862.4 bilion Euro.

Parlamenti i pakënaqur me buxhetin e reduktuar bëri thirrje për një rritje prej 12 bilon Eurosh, por në prill 2006 negociatat me Presidencën Austriake vendosën një rritje prej vetëm 4 bilionesh, duke e çuar buxhetin e BE-së në 866.4 bilion Euro. Kjo rritje u përqëndrua në programet e fushave të konkurencës dhe risive, duke patur fokus kryesor rrjetet trans-europiane, të nxënit gjatë gjithë jetës dhe RRD. Pra, ishte e qartë që përfundimi ishte kompromis i pastër dhe ndërmjet të tjerave komisioneri për programimin Financiar dhe Buxhetin GryBauskaite e mirëpriti arritjen e marrëveshjes por theksoi që ky nuk ishte një buxhet i nevojshëm për të ardhmen e Europës. Rishikimi i buxhetit të BE-së 2008 mirëpritet nga shumë njerëz si një mundësi për të përmisuar buxhetin e BE para 2013.

## *Proçedura Buxhetore*

Proçedura buxhetore e vendosur në artikullin 272 të traktatit të shteteve Lindore Europiane kushtëzon limitet kohore të cilat duhen respektuar nga Këshilli dhe Parlamenti (dy anët e autoritetit buxhetor). Kjo proçedurë siç është përcaktuar edhe në traktat shtrihet nga 1 shtatori deri në 31 dhjetor të vitit paraprirës të atij buxhetor në fjalë.

Në këtë përmbledhje përgatitja e buxhetit është një proçedurë e përbërë nga tre faza.

1) Komisioni përgatit draftin buxhetor parapërgatitor në **Maj**. Para kësaj do të kete pasur tre hapësira diskutimesh ndërmjet Komisionit Parlamentar dhe Këshillit para se Komisioni të miratojnë Draftin Buxhetor parapërgatitor. Buxheti i kalohet Këshillit për t'u shqyrtuar nga ekspertët e buxhetit. Pastaj do t'i kalojë COREPER që do t'i votojë nga mazhoranca e kualifikuar dhe në fund do të kaloj në Këshillin e Buxhetit. Me anë të kësaj vote Këshilli vendos projekt-buxhetin **(fund korriku).**

2) Në fazën tjetër projekt-buxheti i kalohet Parlamentit për leximin e parë.
Raportuesit e Komiteteve që projektojnë amendamentet të bazura në rekomandime nga antarë të komiteteve pastaj këto i kalojnë Komitetit të Buxhetit. Komiteti i Buxhetit do t'i rreshtojë të gjitha amendamentet e propozuara nga komitetet dhe grupimet politike në një takim të gjatë të komitetit dhe të vendosë pozicionimin për secilin prej amendamenteve para se buxheti të votohet në sesionin plenar që mbahet ne **Tetor**. Në këtë fazë vendoset fati i amendamenteve të buxhetit megjithëse do të ketë një lexim të dytë.

3) Në fazën e tretë, projekt-drafti i kthehet Këshillit për leximin e dytë gjatë javës së tretë të **Nëntorit**. Këshilli ka fuqinë të ndryshojë projekt-buxhetin, duke marrë parasysh amendanentet e votuara nga parlamenti në leximin e parë. Këshilli në këtë pikë mund të bëjë disa propozime. Më pas projekt-buxheti amendohet dhe i kthehet Parlamentit në fund të Nëntorit. Në **gjysëm të dhjetorit** Parlamenti rishikon amendamentet dhe propozimet e bëra nga Këshilli dhe do të mbajë të njëjtin Buxhet pasi të jetë kthyer nga

Këshilli. Gjithsesi e ka fuqinë që ti propozojë ose ti refuzojë ato. **Varianti i fundit votohet ne sesionin parlamentar të Dhjetorit** ku Presidenti i Parlamentit e deklaron Buxhetin të miratuar dhe tashmë mund të zbatohet.

### 1.2.1 SHPJEGIMI I PLANEVE FINANCUESE

*Subvencione dhe Prokurime Publike*

Për të zbatuar projekte aktivitete Komisioni jep para në formën e **subvencioneve**. Aktivitetet dhe projektet që do të merren në konsideratë **duhet të jenë të lidhura me politikat e BE**. Subvencionet mund të jepen në fusha të ndryshme si p.sh. ajo kërkimore, edukuese, shëndetsore, mbrojtje e konsumatorit, mbrojtje e Ambientit, ndihmë humanitare etj. Fushat e ndryshme karakterizohen nën linjat e buzhetit (shpjegimi i mëposhtëm). Subvencionet do të jepen në **përgjigje të thirrjeve të tyre** për propozimeve që publikohen nga Komiteti në faqet e tyre të internetit. Thirrjet për propozime ftojnë kandidatët të prezantojnë brënda një afati të caktuar një propozim për të vepruar që korrespondon me objektivat dhe përmbush kushtet e kërkuara. Këto thirje për propozime mund të publikohen në Gazeten Zyrtare te BE-së-Seria C.

**Për të zbatuar projekte aktivitete Komisioni jep para në formën e subvencioneve. Aktivitetet dhe projektet që do të merren në konsideratë duhet të jenë të lidhura me politikat e BE.**

Komisioni gjithashtu bën kontrata për prokurime publike per furnizim mallrash, zbatim punësh ose pregatitje shërbimesh. Këto kontrata ndiqen nga **thirjet për tender.** Për informacion të mëtejshëm do t'u duhet të konsultoheni në faqet e internetit të departamenteve të shumta të komisionit dhe në Gazeten Zyrtare të BE-se ku publikohen lajmërimet e tenderave.

**Komisioni gjithashtu bën kontrata për prokurime publike per furnizim mallrash, zbatim punësh ose pregatitje shërbimesh. Këto kontrata ndiqen nga thirjet për tender**

*Linjat e Buxhetit*

Linjat e buxhetit janë të koduara sipas fushave të politikave. Një shëmbull jepet për të shpjeguar se si secila fushë e politikave thuhet nën një nomeklaturë te re.

Linja e Buxhetit: **15020202** është për:

Politikë: **15** (Edukim dhe kulturë)
Kapitulli: **1502** (Edukim)

Artikull: **150202** (Edukim i përgjithshëm dhe i lartë)
Element: **15020202** (Sokrati )"[1]

## 1.3 DG-të DHE SHËRBIMET E LIDHURA ME FINANCIMIN E JASHTËM

### EUROPEAID

Komisioneri Ferrerro-Waldner (për mardhëniet e jashtme të DG) ka rolin e Kryetarit dhe Komisioneri Mr.Louis Michel (per zhvillimin e DG) si shef ekzekutiv për programin Ndihmë-Evropës. Zyra zbaton instrumentet e jashtme të ndihmës së Komisionit të cilat financohen nga buxheti i Komunitetit Evropian dhe fondi Evropian i Zhvillimit (EDF). Kjo zyrë menaxhon të gjitha fazat e ciklit të projektit të 80% të programeve të asistencës (Afrikën, Karaibet dhe Paqësorin, Mesdheun, Ballkanin Perëndimor, ish Bashkimin Sovjetik, Azinë dhe Amerikën Latine), dhe mbi 80% të 9.6 bilion Eurosh që është Buxheti vjetor i asistencës së jashtme të BE-së. Që në një Janar të vitit 2001 kur zyra e Koperimit Ndihmë- Europës u krijua marrëdhëniet e jashtme dhe zhvillimi i DG—ve kanë qënë përgjegjëse për programimin shumëvjeçar dhe programi Ndihmë-Evropës për ciklin tjetër të Projektit. Qëllimi është të ndash çështjet politike dhe strategjike nga identifikimi dhe zbatimi i projektit.

*Hollësitë e kontaktit:*

Komisioni Europian
Ndihmë-Europës H 05, B-1049 Bruksel
Tel +32 2 299 4237/4825, Faks +32 2 299 6407
E-mail EuropeAid-info@cec.eu.int
Faqja elektronike: http://europa.eu.int/comm/europeaid

### MARRËDHËNIET E JASHTME TË DREJTORISË së PËRGJITHSHME (RELEX)

Marrëdhëniet e jashtme të Drejtorisë së Përgjithshme janë përgjegjëse për marrëdhëniet në lidhje me shtetet jashtë zonës së BE-së si dhe për organizatat internacionale siç janë Shtetet e Bashkuara. Gjithashtu

1.3 DG-të dhe Shërbimet e lidhu
Financimin e Jashtëm. 13

2.1 Hyrje për Fondacionet 22

3.1.10 Drejtësia dhe Tregëtia Vë

At chapter 1 Prezantim i Përgjit

please correct …… pamje të
përgjithëshme …

1 PE 331.944; RR/509681EN. Faqe e dok. 366

kjo drejtori është përgjegjëse për administrimin e më shumë se 120 delegacione komisionesh në vendet e botës së tretë. Komisionere për Marrëdhëniet e Jashtme është Znj. Benita Ferrero-Ëaldner e cila është lidhja parësore e Komisionit me Përfaqësuesit e Lartë për Politikat e Përbashkëta të Jashtme dhe të Sigurimit, ashtu siç është edhe lidhje parësore për Këshillin e Punëve të Përgjithshme të BE-së. Një përmbledhje e përgjegjësive të Drejtorisë së Përgjithshme mund të gjendet në adresën e internetit më poshtë:
http://europa.eu.int/comm/dgs/external_relations/index_en.htm

## ZHVILLIMI I DG

Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit punon në bashkëpunim të ngushtë me DG e Marredhënieve të Jashtme, Ndihmë-Evropës dhe ECHO. Komisioneri për Zhvillim dhe për ECHO (shikoni më poshtë), është Z. Louis Michel. Detyra e tij kryesore eshte të ndihmojë financiarisht vendet e AKP (Afrikës, Karaibeve dhe Paqësorit) si dhe Shtetet dhe Territoret përtejdetit (SHTP). EDF është themeluar nga kontributet e drejpërdrejta të shteteve anëtare. Informacion të mëtejshëm për DG-të e Zhvillimit do të mund të gjeni në këtë faqen elektronike më poshtë:
http://europa.eu.int/comm/development/index_en.htm

*Hollësitë e kontaktit:*

Unit B/1—Politika e Zhvillimit, Studimet Koherente dhe të
Përparuara Kryetare Njësie
Ms Françoise MOREAU
Tel +32 2 299 0772, Fax +32 2 299 2915
E-mail Development@cec.eu.int

Unit A/3 — Marrëdhëniet me Shoqërinë Civile
Mr P BANGMA
Tel +32 2 296 6052, Fax +32 2 299 3206
E-mail Development@cec.eu.int

## ZYRA HUMANITARE E KOMUNITETIT EUROPIAN (ECHO)

Qëllimi i ECHO, e cila u krijua në 1992, është të japë ndihmë humanitare emergjente të cilat vijnë si pasojë e shkatërrimeve

natyrore dhe konflikteve të armatosura në shtetet jo-anëtare. ECHO punon duke u bazuar ne Kuadrin e Marreveshjes se Partneritetit (FPA) me OJQ humanitare dhe organizata lehtësuese ndërkombëtare si dhe ne Kuadrin e Marrëveshjeve Financiare dhe Administrative (FAFA) me agjencitë e Shteteve të Bashkuara. Një Marrëveshje e re në Kuadrin e Partneritetit filloi në 1 Janar 2004 me qëllim thjeshtësimin e proçedurave administrative që lidhen me financimin e EC-së dhe për të zbatimin dhe rezultatet e Shteteve Europiane të financuara me ndihmë humanitare. EDF ka nënshkruar një kontratë me kuadër të ri partneriteti me 130 OJF.

ECHOmerr fonde nga buxheti i Komisionit të ndihmës humanitare e cila gjendet nën titullin 23 dhe Fondit të Zhvillimit Europian. ECHO është përgjegjëse si për financimin e ndihmës humanitare ashtu edhe për financimin e skemave të trajnimit dhe fushata për ndërgjegjësimin e publikut, e cila ka të bëjë me ndihmën humanitare. Ju lutemi kontrolloni për më shumë informacion:
http://europa.eu.int/comm/echo/index_en.html

Hollësitë e kontaktit: ECHO 7 - Informacion dhe komunikim
Mr Simon Anthony HORNER (Head of the unit)
Tel +32 299 2996
E-mail echo-info@cec.eu.int

ECHO 1 — Afrikë, Karaibe, Paqësor
Mr Cornelis WITTEBROOD (Head of the unit)
Tel +32 2 295 7312
E-mail cornelis.wittebrood@cec.eu.int

ECHO 2 — Vendet e Europës Qëndrore dhe Lindore, NIS, Vendet Mesdhetare dhe Lindja e Mesme
Mr Jean-Claude HEYRAUD (Head of the unit)
Tel +32 2 296 9471
E-mail jean-claude.heyraud@cec.eu.int

ECHO 3 - Azi, Amerikë Qëndrore dhe Jugore
Mr Esko KENTRSCHYNSKYJ (Head of the unit)
Tel +32 2 295 3420
E-mail esko.kentrschynskyj@cec.eu.int

ECHO 4 — Politikat e Përgjitshme; marrëdhëniet me institucionet

Evropiane, partnerë dhe donatorë të tjerë; planifikim kordinimi dhe mbështetjeje; mbështetje e përgjithshme në krizat e mëdha
Mr Johannes LUCHNER (Head of the Unit)
Tel +32 2 296 8811
E-mail johannes.luchner@cec.eu.int

**Një element kryesor i kësaj reforme thuhet se është shpërqendrimi i administrimit të ndihmës drejt delegacioneve të Komisionit në mënyrë që të përmirësohet cilësia dhe shpejtësia e dhënies së kësaj ndihme nga të gjitha programet**

## 1.4 REFORMA E administrimit TË NDIHMËS nga jashtë

Një element kryesor i kësaj reforme thuhet se është shpërqendrimi i administrimit të ndihmës drejt delegacioneve të Komisionit në mënyrë që të përmirësohet cilësia dhe shpejtësia e dhënies së kësaj ndihme nga të gjitha programet. Aktualisht Komisioni është i perfaqesuar në 128 shtete në të gjithë botën, dhe këto duhet të luajnë një rrol në rritje të rëndësishëm në ndihmën e zhvillimit që ka të bëjë me influencën në rritje mbi identifikimin dhe vlerësimin e projekteve, kontraktimin dhe dhënien e fondeve të komunitetit si dhe monitorimin dhe vlerësimin e projekteve. Megjithatë ngelet akoma shumë punë për të bërë. Komisioni Evropian, si pjesë e kësaj proçedure, gjithashtu ka si qëllim të intensifikojë kordinimin ndërmjet Shteteve Anëtare me bazë ndërlidhjenlidhje me autoritetet shtetërore.

**Identifikoni mundësitë e duhura të financimit**

Për më shumë informacion mbi ndihmën e jashtme, kontaktoni delegacionin përkatës. Ju lutemi konsultoni faqen e mëposhtme të internetit për detajet e kontaktit të delegacioneve të BE-së.
http://europa.eu.int/comm/external_relations/delegations/intro/web.htm

**Së pari, monitoroni rregulllisht faqen e internetit të Ndihmë-Evropës (europa.eu.int/comm/europeaid) e cila është një burim qëndror informacioni për ndihmën e jashtme**

## 1.5 KËSHILLAT E SHEAQ PËR NGRITJEN E FONDEVE TË JASHTME

### Identifikoni mundësitë e duhura të financimit

Së pari, **monitoroni** rregulllisht faqen e internetit të Ndihmë-Evropës (europa.eu.int/comm/europeaid) e cila është një burim qëndror informacioni për ndihmën e jashtme. Faqja e internetit përmban detaje të plota të proçedurave të kontratave si dhe gjithë dokumentacionin përkatës: formate aplikimi, kontrata standarte, lajmërime prokurimesh, thirrje për propozime, etj. Kushdo që mund të jetë i interesuar (firma, OJF, etj) mund t'i nxjerrë këto dokumenta

menjëherë nga faqja e internetit. (Kini parasysh që SHEAQ jep regullisht informacion mbi thirrjet për propozime dhe tendera për anëtarët e saj. Për detaje të mëtejshme mund të kontaktoni library@ ecas.org ).

**Sigurohuni që keni në dispozicion kohën, mjetet e nevojshme si**

**Sigurohuni që keni në dispozicion kohën, mjetet e nevojshme si dhe aftësitë projektuese**

T'i përgjigjesh një thirrjeje për propozime apo tender mund të jetë një punë që kërkon kohë të plotë për një njeri për një muaj. Githashtu mund të përfshijë edhe konsumim kohe në negociata me partnerët në lidhje me rolet e tyre përkatëse dhe buxhetin. Mund të mos jetë e nevojshme t'a bësh vetëm nëse e klasifikon shkallën e suksesit shumë lart. Kini parasysh këto gjëra:

- Caktoni kohën — për shembull do t'ju duhet një ditë e tërë për t'i vënë të gjitha gjërat bashkë.

- Meqënëse projektet tuaja do të kenë të bëjnë kryeshit me ndihmën e jashtme të Shteteve Evropiane do t'ju duhet të dini se si të përdorni instrumentet e BE-së për zhvillimin e projektit siç janë: Administrimi i Ciklit të Projektit (MCP); dhe Trajtimi i Kuadrit Llogjik **Kuadri i Përafrimit Logjik.** Këto mjete përdoren nga Komisioni në përgatitjen dhe përcaktimin e projekteve (ju lutemi t'i referoheni fundit të këtij kapitulli - Klauzola I për të marr informacion mbi këto mjete).
- Do t'ju duhet të keni një ide se si do të zgjidhen projektet që do financohen dhe se çfarë do t'ju duhet të përfshini në buxhet. Sigurohuni që buxheti të pregatitet sipas formularit të kërkuar në udhëzues.

**Ndërtoni një sistem pajtushmërie kontratash**

**Ndërtoni një sistem pajtushmërie kontratash**

Për t'a bërë këtë, kini parasysh hapat e mëposhtëm:

- Mbani rregjistrimet e duhura. Do të jetë e nevojshme të mbani bordero dhe fatura nga furnizuesit dhe partnerët në mënyrë që të mund të ndiqet një rrugë e lehtë auditimi — si elektronike ashtu edhe manuale. Me raportin e fundit do të duhet gjithashtu që të gjitha justifikimet financiare të paraqiten dhe të pranohen para pagesës[2] së fundit.

2 Cf. Neni 97 i rregullave të Zbatimit

- Ndryshime në buxhet. Një rregull i përgjithshëm: shmangni ndryshimet në buxhet. Por nëse ndryshimi është i nevojshem dhe ka të bëjë me formën aktuale të projektit, atëherë duhet të kërkohet më parë aprovimi i Komisionit Evropian para se të zbatohet ndryshimi. Nëse ndryshimi është thjeshtë një transferim buxheti nëpër titujt e vendosur, dhe është me më pak se 10 % rritje në një titull të veçantë, atëherë ndryshimi mund të zbatohet, por Komisioni duhet te informohet për këteësa më parë që të jetë e mundur.

**Ndiqni kërkesat e raportimit**

## Ndiqni kërkesat e raportimit

Per informacion të plotë mbi Klauzolat e Përgjithsme Administrative ju lutemi vizitoni:
http://europa.eu.int/comm/europeaid/tender/gestion/cont_typ/st/cg_en.pdf

Raportet e mëposhtme me të cilat mund t'ju nevojitet të punoni përfshijnë:

*Raporte Vazhdimësie* — në varësi të tipit dhe kohëzgjatjes së projekit do t'ju kërkohet të bëni raporte vazhdimësie javore, mujore, 3 ose 6 mujore. Raporti zakonisht duhet të jetë katër deri në gjashtë faqe i gjatë dhe duhet të shkruhet në gjuhën që është bërë kontrata.

*Raporte të Përkohshme* — ky, ashtu siç e sugjeron edhe emri, duhet të dorëzohet në gjysëm të projektit. Raporti duhet të shkruhet si një tregim ngjarjesh dhe datash, përveçse në rastin kur mund të jetë kërkuar ndryshe, ku të shpjegohet se si e shikoni progresin e projektit në të ardhmen dhe rolet e partnerëve të ndryshëm. Përfshini një dokument të shkurtër ku vlerësoni projektin, i cili duhet të listojë çfarëdo problemi që ka të bëjë me zbatimin e projektit, fuqitë dhe dobësitë e tij; dhe deri ku po arrihen objektivat e projektit. Do t'ju kërkohen dokumenta dhe shëmbuj mbështetës. Ju gjithashtu keni mundësinë që në këtë pikë të bëni rekomandime.

*Raportet Përfundimtare* — para se të përfundoni projektin duhet të pregatisni një raport të të gjitha aktiviteteve. Normalisht raporti nuk duhet të jetë më shumë se 20 faqe dhe duhet të bëhen tre kopje. Raporti duhet të jetë tregues i aktiviteteve që janë bërë dhe duhet të listojë rezultatet që jane arritur. Në këtë vlerësim duhet të përfshini

ndonjë rekomandim qe mund të keni për të ardhmen. Klauzola shtesë mund të përfshihen nëse jeni referuar atyre në raportin përfundimtar. Tipet e dokumentave që duhen përfshirë në këto shtesa përfshijnë: programe, raporte, lista pjesëmarrësish, statistika për shumën dhe tipin e materialeve të prodhuara, për shëmbull: dokumenta, video, software, së bashku me detaje për mënyrën se si dhe se kujt i janë shpërndarë. Gjithashtu duhet t'i bashkëngjiten kopje të deklaratave për shtyp.

*Raporte Financiare*— duhet të bëni një raport të plotë, financiar, të audituar para se të bëhet çfarëdolloj pagese e fundit, normalisht në tre kopje, para afatit përfundimtar të vendosur në kontratë. Zakonisht afati i vendosur është tre muaj para se të përfundojë projekti. Ju duhet t'i bashkëngjisni raportit të gjithë borderotë e duhura, fatura etj. Buxheti përfundimtar duhet të bëhet, për aq sa është e mundur, përgjatë të njëjtave linja që kishte buxheti i mëparshëm. Një shpjegim duhet të jepet për çdo variacionet e duhura. Një rrugë e pastër auditimi duhet të sigurohet nga raporti deri tek burimi i dokumentave. Kini parasysh që personi që ka nënshkruar kontratën duhet të nënshkruajë raportin përfundimtar. Duhet t'ë bashkëngjisni raportit tuaj financiar një letër ku kërkoni pagesën finale duke dhënë detajet e kontaktit të bankës tuaj. Në letrën tuaj mund t'ju kërkohet të thoni nëse është përfituar apo jo ndonjë lloj interesi nga parapagimi që është bërë nga Komisioni.

Pagesa duhet të arrijë brenda 60 ditëve pasi të jenë aprovuar të dy raportet, ai final dhe ai financiar. Megjithatë eksperienca tregon se pagesat mund të vonohen, gjë e cila mund të ketë si pasojë disa vështirësi financiare për organizaten tuaj. Jini të pregatitur të përdorni fonde rezervë ose edhe të merrni një kredi bankare.
Është e nevojshme të eksploroni gjithashtu mundësi të tjera financimi, siç janë kreditë me perqindje te ulet nga banka që i ofrojnë ato ose edhe të ndërtoni fonde në formë garancie me PJF të tjera.

**Është e nevojshme të eksploroni gjithashtu mundësi të tjera financimi, siç janë kreditë me perqindje te ulet nga banka që i ofrojnë ato ose edhe të ndërtoni fonde në formë garancie me PJF të tjera.**

## 1.6 ANEKSE

### 1.6.1 DY INSTRUMENTA TË BE-së PËR ZHVILIMIN E PROJEKTEVE

**Administrimin e Cilit të Projektit' (MCP), i cili është një tërësi konceptesh të projektit dhe instrumentash administrues, për të përmirësuar gjithashtu edhe cilësinë e projektimit dhe administrimit duke përmirësuar efektshmërinë e ndihmës.**

**Menaxhimi i Ciklit të Projektit (MCP)**

Në 1992, Komisioni Evropian miratoi 'Administrimin e Cilit të Projektit' (MCP), i cili është një tërësi konceptesh të projektit dhe instrumentash administrues, për të përmirësuar gjithashtu edhe cilësinë e projektimit dhe administrimit duke përmirësuar efektshmërinë e ndihmës. Ky është një instrument që kryesisht përdoret për të zbatuar efektivisht ndihmën e jashtme të Shteteve Europiane. MCP ndihmon për të siguruar që:

- Projektet janë mbështetëse *të qëllimeve kryesore dhe të objektivave politike të Shteteve Europaine dhe të partnerëve në zhvillim;*
- Projektet *janë të lidhura me një strategji* për të cilën është rënë dakort dhe për problemet e vërteta të grupeve/përfituesve të synuara;
- Projektet janë të r*ealizueshme,* që do të thotë se realisht objektivat mund të arrihen brenda kufizimeve të mjedisit në të cilën dhe kapaciteteve të agjensive zbatuese; dhe
- *Përfitimet* e dala nga projektet ka mundësi që të jenë të *përballueshme*.

Cikli i projektit të Shteteve të Evropës ka 5 faza kryesore, siç tregohet në Figurën e mëposhtme[3].




3 Tabela dhe informacioni janë marrë nga faqja e internetit Ndihmë-Evropës: www.europa.eu.int/comm/europeaid/qsm/project_en.htm

Për të hyrë tek manuali i përpunuar elekronikisht, vizitoni faqen elektronike: www.europa.eu.int/comm/europeaid/qsm/documents/pcm_manual_2004_en.pdf

### Metoda e Korrnizes Logjike (LFA)

Kjo është një instrument administrimi dhe projektimi e cila ofron mjete për të kontrolluar logjikën e brendshme të projekt-planit. Instrumenti e mundëson planifikuesin që të mendojnë se si do t'a monitorojnë dhe do t'a vlerësojnë projektin që nga fillimi. Informacioni kryesor për dokumentin futet në një dokument - skeleti – që ofron gjithashtu një përmbledhje si dhe një bazë për pregatitjen e planeve të veprimit, zhvillimin e sistemit monitorues dhe një strukturë vlerësimi. Ky është një instrument bazë që përdoret brenda Ciklit të Administrimt të Projektit. LFA ilustrohet më poshtë[4]:
Për më shumë informacion mbi metodat e vlerësimit vizitoni faqen elektronike:http://www.europa.eu.int/comm/europeaid/evaluation/methods/index.htm

**Instrumenti e mundëson planifikuesin që të mendojnë se si do t'a monitorojnë dhe do t'a vlerësojnë projektin që nga fillimi.**

METODA E KORNIZËS LLOGJIKE

| FAZA ANALIZUESE | FAZA PLANIFIKUESE |
|---|---|
| ▸ **Analiza bankare –** identifikimi dhe vlerësimi i përgjegjësve të mëdhenj bankarë; llogaritja e kapaciteteve të tyre<br>▸ **Analiza e problemit** – identifikimi i problemeve kryesore, detyrimeve dhe mundësive; duke përcaktuar shkaqet dhe efektet e marrëdhënieve<br>▸ **Analiza objektive** – zhvillimi i zgjidhjeve në bazë të problemeve të identifikuara; identifikimi i mjeteve për të përfunduar marrëdhëniet.<br>▸ **Analiza strategjike** – identifikimi i strategjive të ndryshme për të arritur zgjidhje; zgjedhja e strategjisë së duhur | ▸ **Zhvillimi i struktures së matrices logjike** – përcaktimi i struktures së projektit, testimi i logjikës dhe testimeve të brëndshme, formulimi i treguesve matës të suksesit.<br>▸ **Planifikimi i aktiviteteve** – përcaktimi i shpeshtësisë dhe varësisë të aktivitetit; vlerësimi i kohëzgjatjes së tyre dhe ngarkimi i përgjegjësive<br>▸ **Planifikimi i burimeve** – zhvillimi i planifikimit informativ dhe buxhetit në varësi të planifikimit të aktivitetit |

4 Nga faqja e internetit të Europës: ttp://www.europa.eu.int/comm/europeaid/qsm/project_en.htm

# KAPITULLI 2

# Financimi nga Fonadacione dhe Korporata Sponsore

## 2.1 HYRJE PËR FONDACIONET

Fondacionet kanë një histori të gjatë pune me OJQ-të. Që nga zhvillimi i tyre gjatë periudhës së hershme fondacionet janë përfshirë gjithmonë në një farë niveli në veprimtari sociale dhe punë humanitare. Suksesi i modelit amerikan të fondacionit së bashku me mëkëmbjen ekonomike dhe stabilitetin politik të Evropës Perëndimore kanë kontribuar për të rivendosur rëndësinë e sektorit të fondacioneve europiane.

Për shkak të kësaj, roli i fondacioneve po bëhet gjithmonë e më i fortë në fushën e kërkimeve të fondeve. Rreth 200.000 mijë fondacione thuhet se ekzistojnë në Europën Qëndrore, Lindore dhe Perëndimore, të cilat kanë arritur të përfaqësojnë një palë të rëndësishme të fondeve institucionale nga qeveritë kombëtare dhe Bashkimi Europian.[5]

5 Karina Holly, "Udhetim pa Kufi — Duke Kerkuar dhe Aplikuar tek Fondacionet" Drejtoria Nderkombetare e Fondacioneve 2003, edicioni 112. (Londer: Publikimet Europa , 2003) 19-22. Gjithashtu shikoni komentet nga William Thomson, kryetar i bordit te trustees te Carnegie MB Trust ne Charlie McConnell, "Fondacionet e heqin fokusin nga subvencionet per te mbeshtetur ndryshimet," Carnegie UK Trust Online, 1 Dhjetor 2004, i vlefshëm në http://www.carnegieuktrust.org.uk/news_and_events/all_change (20 Shkurt 2006)

Roli i fondacioneve në lidhje me qeverisjen dhe zhvillimin global jashtë BE-së u bë i ditur në komunikatën e Komisionit Europian dhe së fundmi e njëjta çështje u diskutua nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Kofi Annan[6].

Sektori i Fondacioneve është shumë i gjerë dhe i ndryshueshëm. Fondacionet në të gjithë Europën financojnë mijëra projekte dhe programe të ndryshme çdo vit, duke i renditur që nga Programet Ndërkombëtare Jo Qeveritare (INGOs) deri tek projektet në bazë; që nga çështjet e specializuara shkencore siç është kërkimi i qelizave të kërcellit, deri tek më të përgjithshmet dhe abstraktet siç janë të drejtat e njeriut.

Si rrjedhojë, për shkak të rolit në rritje që fondacionet luajnë në financim, kapitulli i mëposhtëm kërkon të hedhë pak dritë në mënyrën se si ato punojnq dhe se si duhet tq veproni për të marrë fonde nga ato.

## 2.2 KATEGORIZIMI

Të jesh i zoti të percaktosh fondacionet është një aftësi e veçantë që duhet të zhvillojnë fond-kërkuesit nëse duan që përçapjet e tyre të jenë të frytshme. Në rradhë të parë kërkuesit e subvencioneve do të kenë nevojë të klasifikojnë fondacionet në mënyrë që të kenë një ide mbi potencialin e tyre të plotë. Ne kemi përdorur kategoritë e mëposhtme për t'ju ndihmuar në kërkimin tuaj.:

- Fondacionet që bëjnë subvencione: këto janë organizata donatore që i japin fondet e tyre për qëllime të caktuara. Këto tipe organizatash janë më të zakoshme në Shtetet e Bashkuara se sa në Europë.
  - » Shembuj: Fondacioni Ford (SHBA), Leverhulme Trust (MB), Volkswagen Stiftung (Gjermani), Fondacioni Bernard Van Leare (Hollandë), Carlesberfond (Danimarkë).

6 Komisioni i Komuniteteve Evropiane, "Komunikimi dhe Zhvillimi në Qeverisje" faqja e internetit të Europës, 20 Tetor 2003, i vlefshëm në http://www.europa.eu.int/eur-lex/en/com/cnc/2003/com2003_0615en01.pdf. "Annan thërret për një mendësi të re në SHBA në përfshirjen jo vetëm të qeverive por edhe të njerëzve" Fjalim i 26 Janarit 2006, i vlefshëm në: http://www.un.org/apps/news/story.asp?NewsID=17305&Cr=economic&Cr1=forum (20 Shkurt 2006) http://www.un.org/apps/news/story.asp?NewsID=17305&Cr=economic&Cr1=forum (20 Feb 2006)

- Fondacione Operative: Fondacione që veprojnë mbi programet dhe projektet e tyre.
    - » Shembuj: Instituti Pasteur (Francë), Fondacioni Pescatore (Luksemburg), Fondacioni Calouste Gulbenkian (Portugali).

- Fondacionet Mikse: Këto tipe fondacionesh operojnë programet dhe projektet e tyre ndërkohë që merren edhe me subvencionime thelbësore.
    - » Shembuj: Fondacioni BBV (Spanjë), Robert Bosch Stiftung (Gjermani).

## 2.3 FINACIMI I FONDACIONEVE

Fondacionet janë një burim i rëndësishëm financimi për OJQ-të. Fondacionet zakonisht aplikojnë një përqasje më pak institucionale në financim e cila ju drejtohet organizatave me më pak burime, ose më thjeshtë, atyre që kërkojne bashkë-financim. Për më tepër, perceptimi i zakonshëm i fondacioneve është që ato e vlerësojnë më shumë ndërveprimin personal se sa përafrimin jo personale të bërë nga Komisioni Evropian. Fond-kërkuesit kanë arritur në pikën që i shohin fondacionet si aleate në kërkesat e tyre për fonde, më tepër se sa pengesa.

Në mënyrë që të jenë të suksesshëm, fond-kërkuesit duhet të adaptojnë strategjinë e tyre tek ndërlikimet e shumëllojta që rrethojnë proçesin e aplikimit për fonde të fondacionit.

### 2.3.1 KARAKTERISTIKA TË SEKTORIT TË FONDACIONEVE

Sektori i fondacioneve është zhvilluar shumë shpejt gjatë katër dekadave të fundit duke na lejuar që të dallojmë më mirë disa nga modelet dhe karakteristikat e tij. Këto tendeca duhet të meren parasysh nga aplikuesit e mundshëm në mënyrë që të kuptojnë më mirë dinamikën e punës në sektorin e fondacioneve.

Çështjet e axhendës globale i prekin fondacionet, ashtu siç i prekin dhe ato aktorët në sektorin e tretë. Përkushtimi i fondacioneve ndaj qëllimeve[7] të zhvillimit të mijëvjeçarit pa dikutim do të influencojë

7 Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuar (UNDP), Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2003: Synimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit — Një Marrëveshje ndëveshje

shumën e fondeve që ato i përkushtojnë reduktimit[8] të varfërisë dhe projekteve të parandalimit të SIDA-s, pa marrë në konsideratë fondet e dhuruara për projektet e mbështetura kryesisht në zhvillim.

### 2.3.2 SEKTORI I FONDACIONEVE NË SHTETET E REJA TË BE-SË.

Përkushtimi i sektorit të fondacioneve ndërkombëtare dhe veçanërisht ai i Europës Perëndimore për të kryer veprime në Europën Qëndrore dhe Lindore ka kontribuar pa masë drejt zhvillimit të fondacioneve në këto shtete. Inisiativa si ajo Besimit për Shoqërinë Civile, e financuar nga Instituti i Shoqërise së hapur dhe pesë fondacione ndërkombëtare, kanë dhënë infrastrukturën e duhur për zhvillimin e sektorit të tretë në këto shtete të reja anëtare[9].

Angazhimi i sektorit ndërkombëtar të fondacioneve në shtetet e reja anëtare të Europës Qëndrore dhe Lindore ka ndihmuar në prodhimin e ndryshimeve politike dhe institucionale në favour të zhvillimit të sektorit lokal të fondacioneve. Për shembull në Republikën Çeke, pas nëntë vitesh negociata Fondacioni i Financimit të Investimeve (FFI) filloi të merrte subvencionet e para në 2001[10].. Iniciativa të tilla po ndërmerren nga Qeveria Rumune në tentativën për të promovuar zhvillimin e aktiviteteve lokale filantropike.

## 2.4 NJË HARTË E SEKTORIT TE FONDACIONEVE

Harta e mëposhtme jep një pamje të përgjithshme të sektorit të fondacionit duke përdorur një numër treguesish që duhet të merren në konsideratë nga subvencion-kërkuesit kur planifikojë strategjitë e marrjes së fondeve[11].

---

ndërmjet Kombeve për t'i dhënë fund Varfërisë Njerëzore (New York: UNDP, 2003)

8 "Fondacionetondacionet takohen për të shtyrë pë përpara kërkimin për "Synimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit," Qendra e Fondacionit Evropian, elektronikisht 27 May 2004, i disponueshëm në http://www.efc.be/agenda/event.asp?EventID=1839 (20 shkurt 2006)

9 Pavlína Kalousová, "fondacioni i Investimit të Rritjes së Fondit Cek të të Ardhurave të Fondacioneve" Besimi për Shoqëri Civile në Evropën Lindore dhe Qëndrore, June 2002, elektronikisht e disponueshme në http://www.ceetrust.org/news/3.html (20 shkurt 2006)

10 Idem

11 Të dhënat e mbledhura për këtë sektor vijnë nga raportet e vendeve të ndry-

| Përmasa e Sektorit të Fondacionit (5) | Niveli i Zgjerimit i Sektorit të Fondacioneve | Fusha të preferuara të financimit të Fondacioneve | | | Tipe të përbëra Fondacionesh | Ndarja relative e Fondacioneve subvencionues | Numri i Fondacioneve | Shteti |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | E Para | E Dyta | E Treta | | | | |
| **I / E Madhe** | E Lartë (2) | | | | | Shumica | 50,201 | **SHBA** |
| | E Lartë (2) | Edukimi | Shërbime Sociale | Kulturë & Arte | 43% | 15% | 1 300 (1) | **Itali** |
| | | | | | | | 600 (1) | **Litenshtajn** |
| | | | | | | | 20.00 – 30.000 | **Suedi** |
| | Mesatare (3) | Edukimi | Shërbime Sociale | Kulturë & Arte | | 5% | 8.000 (1) | **Zvicër** |
| **Mesatare** | | | | | | | 14.000 (1) | **Danimarkë** |
| | Mesatare (3) | Edukimi | Kulturë & Arte | Shërbime Sociale | 20% | 50% | 2,522 | **Finland** |
| | Mesatare (3) | Edukimi | Shërbime Sociale | Kulturë & Arte | 25% (1) | 50% (1) | 8,312 | **Gjermani** |
| | | Aktivitete Ndërkombëtare | Shërbime Sociale | Shëndetësi | | Shumica | 1.000 (1) | **Hollandë** |
| | | Shërbime Sociale | Edukimi | Kulturë & Arte | | | 2,989 | **Norvegji** |
| | Mesatare (3) | | | | | Pothuajse 100% | 8.800 (1) | **Mbretëria e Bashkuar** |

| Përmasa e Sektorit të Fondacionit (5) | Niveli i Zgjerimit i Sektorit të Fondacioneve | Fusha të preferuara të financimit të Fondacioneve | | | Tipe të përbëra Fondacionesh | Ndarja relative e Fondacioneve subvencionues | Numri i Fondacioneve | Shteti |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | E Para | E Dyta | E Treta | | | | |
| Mesatare e Vogël | E Lartë (2) | Shërbime Sociale | Kulturë & Arte | Edukimi | | | 664 | **Portugali** |
| | E Lartë (2) | Kulturë & Arte | Shëndetësi | Edukimi | | 5% | 6000 (1) | **Spanjë** |
| | E Lartë (2) | Shërbime Sociale | Edukimi | Besim | Shumica | | 9.326 | **Turqi** |
| E Vogël | E Ulët (4) | Edukimi | Shërbime Sociale | Kulturë & Arte | Shumica | | 803 | **Austri** |
| | E Ulët (4) | Edukimi | Shëndetësi | Shërbime Sociale | Shumica | Pakica | 310 | **Belgjikë** |
| | E Ulët (4) | Shëndetësi | Shërbime Sociale | Edukimi | | | 404 | **Francë** |
| | Mesatare (3) | Edukimi | Shërbime Sociale | Shëndetësi | Pakica | Pakica | 500 (1) | **Greqi** |
| | | Strehim | Shëndetësi | Edukimi | 3% | 27% | 30 | **Irlandë** |
| | | | | | | | 143 | **Luksemburg** |

(1) Përafërsisht
(2) Nivelet e larta i atribohen një ndryshimi në strukturën ligjore përsa i përket Fondacioneve (E.G. Ligji Amato në Itali, 1990) ose zhvillim ekonomik i shpejtë. (psh Spanja dhe Portugalia pas hyrjes së BE - së)
(3) Nivele ekonomike mesatare janë të shpeshta në shtete të cilat historikisht kanë patur sektorë të mëdhaja fondacionesh dhe periudha të gjata stabiliteti politik dhe ekonomik.
(4) Nivele të ulëta janë rezultat i proçedurave ligjore të vjetëruara që bëjnë themelimin e fondacioneve të vështirë.
(5) Tërësia e masave të kapitaleve, stafi i punësuar, dhe numri i fondacioneve.

## 2.5 PROÇESI I APLIKIMIT

Proçesi i aplikimit të financimit nga fondacionet mund të bëhet shumë konfuz nëse e merrni lehtë. Fondacionet, ndryshe nga institucionet ndërkombëtare, nuk kanë një tërësi kriteresh aplikimi standartesh. Fond-kërkuesit duhet të jenë të kujdesshëm me çfarëdolloj kërkese specifike të financuesit para se të dorëzojnë çfarëdo projekte propozimi. Duke ndjekur fazën e parë fond-kërkuesit duhet të planifikojë me llogjikë një projekt-propozim që i përmbush të gjitha kushtet e financuesit. Një studim nga Qendra e Studimeve Europiane vlerëson që 90 % e të gjithë aplikimeve për fonde refuzohen menjëherë nga financuesit[12]. Kështu që fond-kërkuesit duhet të jenë shumë të kujdesshëm kur janë në proçesin e aplikimit nëse duan të jenë të suksesshëm.

### 2.5.1 KËRKIME PARAPRAK

Kërkimet paraprake janë thelbësore për shkak të kritereve të mëdha të aplikimit të ndërmarra nga fondacionet. Fond-kërkuesit me eksperiencë rekomandojnë të kalohet 60% e kohës së nevojshme për të bërë një projekt-propozim duke bërë kerkime dhe planifikime[13]. Megjithatë, nëse doni që kërkimi të jetë shpërblyes ai duhet bërë deri në lodhje, imtësisht dhe në mënyrë të organizuar. Këtu keni disa çështje që fond-kërkuesit duhet të mbulojnë në kërkimet e tyre paraprake[14].

---

shme në Andreas Schlüter, Volker Then dhePeter Walkenhorst, Eds., Fondacionet në Evropë, administri i shoqërisë dhe Ligjjit (London: Drejoria e Ndryshimit Social, 2001)

12 Karina Holly, "Udhetim pa Kufi — Duke Kerkuar dhe Aplikuar tek Fondacionet" Drejtoria Nderkombetare e Fondacioneve 2003, edicioni 112. (Londer: Publikimet Europa , 2003) 19-22. Gjithashtu shikoni komentet nga William Thomson, kryetar i bordit te trustees te Carnegie MB Trust ne Charlie McConnell, "Fondacionet e heqin fokusin nga subvencionet per te mbeshtetur ndryshimet," Carnegie UK Trust Online, 1 Dhjetor 2004, i vlefshëm në http://www.carnegieuktrust.org.uk/news_and_events/all_change (20 Shkurt 2006)

13 Idem

14 Ky seksion kombinon eksperiencën e ECAS me informacionin e dhënë në "Subvencion-kërkuesit" Financuesit Online, i vlefshëm në http://www.fundersonline.org/grantseekers/ (20 Shkurt 2006); J.C. Geever,Qendra e Guidës së Fondacionit për Propozimet, botimi i 3-të. (Nju Jork: Qendra e Fondacionit, 2001); David Lopez, "Conceptos Basicos," Justificacion Tecnica y Administrativa de Proyectos Subvencionados, Centro de Estudios Ramon Areces Ed. (Madrid: Centro de Estudios Ramon Areces, 2003)

## Rreth projektit

- A e mbështet fondacioni çështjen kryesore të projektit? (p.sh edukimi i fëmijëve me sindromën daun nën moshën 5 vjeç)
  » Këshillë: Organizatat duhet të përcaktojnë dhe të rafinojnë çështjen kryesore të projekteve të tyre para se të futen në çfarëdolloj aktiviteti për kërkim fondesh. Organizatat duhet të shmangin tundimin e përcaktimit të çështjes kryesore vetëm për t'ju përshtatur kërkesave dhe parimeve të financuesit. Më tej, organizatat duhet të jenë gati të shpjegojnë pse kjo çështje është e rëndësishme. Kjo mund të vendoset nëpërmjet një analize për përcaktimin e nevojave.

- A pranon fondacioni vetëm projekte që veprojne në një vendndodhje gjeografike specifike? (p.sh. lagjet e brëndshme të Londrës)
Organizat dhe institucionet publike, gjysëm-publike dhe isntitucionet e angazhuara në trainimin profesional.

**Zona e financimit:**
Shtetet Anëtare të Bashkimit evropian, vendet e EFTA të cilat janë anëtare të EEA: Islanda, Liechtenstein dhe Norvegjia sipas kushteve të marrëveshjes së EEA dhe vendet kandidate për në Evropën e Bashkuar.

**Kontaktoni:** Ms Monika HOLIK
P3 — Leonardo da Vinci
Education, Audiovisual and Culture Executive Agency
Bour 3/30, B-1049 Brussels
Tel +32 2 298 5807
E-mail eacea-info@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/education/programmes/leonardo/leonardo_en.html

### **15 02 02 02** - Socrates

**Buxheti i dhënë:** 383.32 milion

Qëllimi kryesor i programit SOCRATES është të forcojë dimensionin Evropian të edukimit në të gjitha nivelet, të përmirësojë njohjen e gjuhëve Evropiane, të nxisë bashkëpunimin dhe lëvizjen gjatë tërë edukimit, të inkurajojë novacionin dhe të nxisë mundësitë e barabarta në tërë sektorët e edukimit.

Kështu kjo linjë buxheti mbulon aktivitetet që lidhem me: mbështetjen e lëvizjes mes vendeve dhe rrjetet e bashkëpunimit; përdorimin e tekonlogjisë së komunikimit dhe informimit; nxitjen e mësimit të gjuhëve dhe njohen e kulturës; mbështetjen e projekteve

pilot novatore; dhe përmirësimin e të dhënave të referimit në fushën e edukimit. Gjithashtu kjo linjë buxheti mbështet edhe programe për shkolla për restaurimin e varreve të luftës dhe monumenteve të luftës së dytë botërore.

**Plotësojnë kriteret:**
Në shumicën e rasteve, individët (studentët, mësuesit etj.) mund të marrin pjesë në program vetëm përmes insitutionit vendas, megjithëse ka përjashtime për këtë (psh.Asistentët e Gjuhës, Comenius)

**Zona e financimit:**
25 Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian, Shtetet Anëtare të Shoqatës së Tregut të Lirë Evropian dhe Zonës Ekonomike Evropiane (EFTA/ EEA): Islanda, Liechtenstein, Norvegjia dhe vendet kandidate.

**Si të aplikoni:**
Ka dy lloje veprimesh bazë; "veprimet e centralizuara" që administrohen nga Komisioni dhe "veprimet e decentralizuara" të cilat administrohen nga agjencitë kombëtare. Formularët e aplikimit për veprimet e centralizuara mund të sigurohen përmes faqes së internetit Socrates dhe formularët e aplikimit për veprimet e decentralizuara sigurohen pranë Agjencive Kombëtare, adresa e të cilave mund të gjendet në faqen e internetit.

**Kontaktoni:** Socrates Programme
Education, Audiovisual and Culture Executive Agency
Bour 3/30, B-1140 Brussels
Tel +32 2 233 0111
Fax +32 2 233 0150
E-mail eacea-info@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://www.europa.eu.int/comm/education/programmes/socrates/socrates_en.html

## **15 05 01** - Rinia

**Buxheti i dhënë:** 107.44 milion
Programi për rininë synon të mbështesë lëvizjen nga shteti në shtet të të rinjve, përdorimin e teknologjive të komunikimit dhe informimit, rrjetet e bashkëpunimit, qytetarinë Evropiane, mësimin e gjuhëve dhe njohjen e kulturës.Qëllime të tjera përfshijnë realizimin e projektve pilot dhe krijimin në nivel Evropian të metodave të analizës, zhvillimin e plotikave për rininë dhe zbatimin e tyre.

Aktivitetet kryesore që mbështeten nga kjo linjë buxheti janë shkëmbime afat-shkurtëra të grupeve, shërbimi vullnetar, iniciativa të drejtuara nga vetë të rinjtë, projekte të lidhura me programe të tjera të Komunitetit dhe punën e rinisë ndërkombëtare.

**Plotësojnë kriteret:**
Grupet e të rinjve, organizatat apo shoqatat jo-qeveritare jo-fitimprurëse, autoritetet publike dhe të tjerë me përvojë në fushën e punës me të rinjtë rinjve dhe edukimin informal.

**Zona e financimit:**
Shtetet Anëtare të BE, Shtetet Anëtare të Shoqatës së Tregut të Lirë Evropian dhe Zonës Ekonomike Evrpiane (EFTA/EEA) dhe vendet para-pranimit në BE. Në bazë të disa kushteve të caktuara është i hapur edhe për partnerë nga shtete të tjera të vendeve të botës.

**Si të aplikoni:**
Për t'u përfshirë në shumicën e llojeve të projekteve, mund të jetë e nevojshme të krijohet një partneritet me një apo më shumë partnerë, në varësi të rregullave për çdo veprimtari dhe vendin e origjinës së partnerëve.

**Kontaktoni:** Mr Philippe COVA (Head of Unit)
Education, Audiovisual & Culture Executive Agency,
Unit YOUTH
Bour 3/30, B-1049 Brussels
Tel +32 2 299 9130
Fax +32 2 292 1330
E-mail youth@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/youth/program/index_en.html

### 3.1.4 PUNËSIMI DHE ÇËSHTJET SOCIALE

## **04 04 02 01** – Analiza dhe studime mbi gjendjen sociale, demografinë dhe familjen

**Buxheti i dhënë:** 3.22 milion

Objektivi i kësaj linje buxheti është të nxisë analizën krahasuese dhe shkëmbimin e opinioneve në nivel evropian lidhur me gjendjen sociale dhe tendencat social-ekonomike në Shtetet Anëtare. Fusha e interesit përfshin mplakjen e popullsisë dhe ndikimin në politikat e ndryshimeve demografike, lidhjet mes familjes dhe tendencave demografike dhe lidhja e tyre me zhvillimin teknologjik, objektivat socialë dhe jetën e familjes si dhe fëmijërinë.

**Plotësojnë kushtet:**
Organizatat jo-fitimprurëse, duke përfshirë rrjetet aktive në nxitjen dhe mbrojtjen e familjes dhe të të drejtave të fëmijëve, në Shtetet Anëtare të BE.

**Kontaktoni:** Mr Constantinos FOTAKIS
European Commission
Directorate-General Employment and Social Affairs,
Social Protection and Integration
Tel +32 2 295 02 06
Fax +32 2 299 38 90
E-mail empl-info@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/employment_social/calls/anualprog_2006_en.cfm

## **04 05 02** – Masat e Komunitetit për të arritur barazinë mes burrit dhe gruas
## **04 05 03** – Organizatat e Grave

**Buxheti i dhënë:**
11.14 milion dhe p.m. (0.35 milion në rezervë)

Objektivi i linjës së buxhetit 04 05 02 është të mbështesë aktivitete të synuara për nxitjen e mundësive dhe trajtimit të barabartë, duke përfshirë aspektet ligjore. Llojet e aktiviteteve të mbështetura lidhen me trainimin dhe përhapjen e praktikave të mira në këtë fushë, të njohurive mbi diskriminimin direct dhe indirekt, vlerësimin e efektivitetit të politikave në vazhdim, dhe mbështetjen e aftësimit të aktorëve kryesore në këtë fushë.

Linja e buxhetit 04 05 03 mbështet me grante organizatat e grave që fokusohen në nxitjen e rolit të grave në shoqëri, trajtimin e barabartë të tyre dhe luftën kundër diskriminimit, të cilat nuk mbulohen nga Lobi i Grave.

**Plotësojnë kushtet:**
autoritetet lokale dhe rajonale, institucionet që nxisin barazinë gjinore; partneret socialë; OJQ-të; universitetet dhe institucionet kërkimore; zyrat kombëtare të statistikave; media.

**Zona e financimit:**
Bashkimin Evropian Union, vendet kandidate të BE dhe Shtetet Anëtare të Shoqatës së Tregut të Lirë Evropian dhe Zonës Ekonomike Evropiane (EFTA/EEA).

**Kontaktoni:**
Miss Fay DEVONIC (Head of Unit)
European Commission
Directorate General for Employment and Social Affairs – G1
Equal Opportunities for Women and Men: Strategy and Programme
B-1049 Bruxelles
Tel +32 2 295 6151
Fax +32 2 296 3562
E-mail empl-info@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/employment_social/gender_equality/index_en.html

## **04 04 08** – Veprimi përgatitor ENEA mbi jetën aktive të të moshuarve dhe integrimin e tyre

**Buxheti i dhënë:** 1.50 milion
Qëllimi kryesor i këtij programi është të financojë iniciativa që nxisin të moshuarit për të bërë jetë aktive, duke përfshirë mundësitë për tregun e punës. Llojet e aktiviteteve të mbështetura përfshijnë programe shkëmbimi me vende të tjera për të moshuarit, të cilat kanë formën e qëndrimeve afat-shkurtëra në një shtet tjetër anëtar të BE-së. Programi duhet të orientohet drejt njerëzve në gjendje ekonomike të pasigurtë apo edhe në rrezik për përjashtim social, ose të synojë në nxitjen e rolit të të moshuarve si pjesëmarrës aktive apo edhe në forcimin e kohezionit mes brezave.
Po ashtu mbështeten programet e shkëmbimit për të moshuarit të organizatave të specializuara mes të tjerave për zhvillimin e burimeve për lëvizjen e tyre.

**Plotësojnë kushtet:**
Të gjitha institucionet në sektorin publik dhe privat të angazhuara në nxitjen e rolit të moshuarve si një përfitim për shoqërinë: autoritetet lokale, kombëtare dhe rajonale, partnered social, ofruesit e shërbimeve sociale, OJQ-të, universitetet dhe institutet kërkimore.

**Kontaktoni:**
Mr Ralf JACOB (Head of Unit)
European Commission
Directorate-General Employment and Social Affairs
Unit E1 - Social and Demography Analysis
Rue Joseph II-27 -1/242, B-1049 Brussels
Tel +32 2 299 0483
Fax +32 2 299 3890
E-mail empl-info@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/employment_social/calls/proposal_2005_en.cfm

## **04 04 03** – Lëvizja e lirë e puntorëve, koordinimi i sistemit të sigurimit shoqëror dhe masave për emigrantët duke përfshirë emigrantët nga vendet e treta

**Buxheti i dhënë:** 3.24 milion

Kjo linjë buxheti mbulon analizën dhe vlerësimin e tendencave kryesore në sistemet e sigurimeve shoqërore kombëtare dhe, sistemet e sigurimeve shoqërore suplementare dhe tendencat kryesore në lëvizjen e lire të popullsisë dhe legjislacionin në Shtetet Anëtare. Po ashtu përfshihen projekte që nënvizojnë tiparet kryesore të sistemeve të mbrojtjes sociale, veprime që synojnë sigurimin e shërbimeve më të mira për emigrantët dhe zhvillimin e informacionit dhe fushatave për të ndërgjegjësuar publikun për sistemin e pensioneve suplementare për punonjësit emigrantë në BE.

**Plotësojnë kushtet:**
Organizatat Publike: ministritë, autoritetet lokale dhe rajonale, universitetet dhe institutet kërkimore, organizatat e punonjëve/puntorëve aktive në fushën sociale, OJQ-të të cilat punojnë në interes të puntorëve emigrantë.

**Zona e financimit:**
Bashkimi Evropian

**Financimi:**
Deri në 80 %

**Kontaktoni:** Mr Robertus CORNELISSEN (Head of Unit)
Directorate-General Employment and Social Affairs
Free movement of workers and coordination of social security schemes–E3
Rue Joseph II-27 -1/242, B-1049 Brussels
Tel +32 2 295 7667
Fax +32 2 295 5066
E-mail empl-freemovement@cec.eu.int, empl-socialsecurity@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://www.europa.eu.int/comm/employment_social/index_en.htm

## **04 03 03 01** — Marrëdhëniet Industriale dhe dialogu civil

**Buxheti i dhënë:** 17.30 milion

Këto fonde përfshijnë inkurajimin e pjesëmarrjes së partnerëve socialë në strategjinë e punësimit evropian.
Po ashtu mbulohen aktivitete që lidhen me nxitjen e dialogut social në nivel jashtë-sektorial ndër-industrial dhe industrial; mbledhje dhe veprimtari të tjera që kanë si qëllim zhvillimin e ekspertizës dhe shkëmbimin e informacionit; projekte pilot për krijimin e kodeve të sjelljes dhe etiketimet sociale, dhe pjesëmarrjen e barabartë të grave në organet vendim-marrëse.

**Plotësojnë kushtet:**
Organizatat Evropiane të cilat marrin pjesë në dialog social dhe që janë pjesë përbërëse e strukturave partnere sociale të Shteteve Anëtare si dhe kanë aftësi për negocijuar për.

**Zona e financimit:**
Bashkimi Evropian, vendet kandidate dhe vendet e Shtetet Anëtare të Shoqatës së Tregut të Lirë Evropian dhe Zonës Ekonomike Evropiane (EFTA/EEA).

**Kontaktoni:**
Mr Jackie MORIN (Head of Unit)
European Commission
Directorate-General for Employment and Social Affairs
D1 - Interprofessional social dialogue - Industrial relations - Adaptation to change
J37 3/21, Rue de Geneve, 1 — 1049 Brussels
Tel +32 2 296 11 45 / 296 89 96
Fax +32 2 296 97 71
E-mail empl-04-03-03-01@cec.eu.int

**Faqja e internetit:**
http://www.europa.eu.int/comm/employment_social/social_dialogue

## **04 04 04** — Masat për të luftuar dhe parandaluar diskriminimin

**Buxheti i dhënë:** 17.57 milion

Qëllimi i kësaj linje buxheti është të mbështesë dhe të plotësojë përpjekjet (në nivel Komuniteti dhe në Shtetet Anëtare) të parandalojë dhe luftojë diskriminimin e bazuar në origjinën racore apo etnike, në fenë dhe besimin, paaftësinë, moshën apo orientimin seksual. Këto veprimtari përfshijnë analizën e faktorëve të lidhur me diskriminimin; vlerësimin e legjislacionit kundër diskriminimit; partneritetet mes vendeve dhe ndërgjegjësimin.
Një pjesë e këtij fondi është synuar për bashkëfinancim për OJQ-të dhe rrjetet përfaqësuese Evropiane që marrin pjesë në luftën dhe parandalimin e diskriminimit në Komunitet dhe Shtetet Anëtare si dhe të nxisë dialogun publik në këtë drejtim.

**Plotësojnë kushtet:**
Organizatat publike dhe private dhe institucionet e angazhuara në luftën kundër diskriminimit.

**Kontaktoni:** Mr Stefan OLSSON (Head of Unit)
Directorate-General Employment and Social Affairs
Anti-Discrimination and Relations with Civil Society - D3
Rue Joseph II 37 -J 37 2/23, B-1049 Brussels
Tel +32 2 295 3569
Fax +32 2 295 1899
E-mail empl-antidiscrimination@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://www.europa.eu.int/comm/employment_social/fundamental_rights/index_en.htm.

## **04 04 02 02** — Masat për të luftuar dhe parandaluar përjashtimin shoqëror

**Buxheti i dhënë:** 23.10 milion

Veprimtaritë e përfshira në këtë linjë buxheti synojnë inkurajimin e bashkëpunimit mes Shteteve Anëtare për të luftuar përjashtimin

shoqëror. Mbështetja jepet për të punuar në drejtim të nxitjes së pjesëmarrjes dhe aksesit për burime për të gjithë, parandalimin e përjashtimit, ndihmën për grupet e prekshme, si dhe mobilizimin dhe përfshirjen e palëve. Programi përfshin tre drejtime:

- Analizën e karakteristikave, proceseve, arsyeve të procesit të përjashtimit social. Projektet e reja për vitin 2006 përfshijnë si studime për varfërinë rurale, përjashtimin financiar, dhe aksesin për shërbime shëndetsore.
- Nxitjen e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit dhe praktikave të mira në nivel vendesh, duke përfsirë veprimtari kombëtare ndërgjegjësuese.
- Nxitjen e pjesëmarrjes së grupeve të ndryshme të interesit dhe mbështetjen e rrjeteve në nivel BE. Kjo përfshin mbështetjen për rrjetet Evropiane dhe partneritetin e OJQve dhe shoqatave vullnetare kundër përjashtimit shoqëror dhe varfërisë.

**Plotësojnë kushtet:**
Autoritetet lokale dhe rajonale; organizatat që punojnë për nxitjen e trajtimit të barabartë, partnerët socialë; OJQtë; universitetet dhe institutet kërkimore; zyrat kombëtare të statistikave; media.

**Zona e financimit:**
Shtetet Anëtare, Shtetet Kandidate dhe, Shtetet Anëtare të Shoqatës së Tregut të Lirë Evropian dhe Zonës Ekonomike Evropiane (EFTA/EEA).

**Kontaktoni:** Mr Adam TYSON (Head of Unit)
European Commission
Directorate-General Employment and Social Affairs
Unit E/2 - J27 01/34
200 Rue de la Loi, B-1049 Brussels
Tel +32 2 296 6056
Fax +32 2 299 0509
E-mail empl-info@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/employment_social/emplweb/tenders/index_en.cfm

## **04 04 12** – Viti Evropian për Mundësitë e Marabarta për të Gjithë në 2007

**Buxheti i dhënë:** p.m. (2.00 milion në rezervë)

Kjo linjë mbulon masat e marra për përgatitjen e Vitit Evropian për Mundësi të Barabarta për të Gjithë në 2007, i cili do të sigurojë platformën për rritjen e ndërgjegjësimit për një shoqëri më të bashkuar që respekton *acquis* (sitemin e ligjeve) Evropiane në barazi dhe mosdiskriminim. Ai gjithashtu synon të nxisë debatin dhe dialogun.

Veprimtaritë që do të realizohen gjatë vitit 2006 përfshijnë:
- Një konference Evropiane për të shpallur fillimin e punës për vitin
- Fushatë informimi për përgatitjen, prodhimin dhe shpërndarjen e mjeteve ndërgjegjësuese për vitin e ardhshëm.
- Anketim në shkallë Bashimi Evropian për të mundësuar matjen e ndikimit
- Vlerësim të aktiviteteve

**Kontaktoni:** Miss C. MAGNANT (Programme Manager)
European Commission, Empl – D3
Anti-discrimination and relations with Civil Society
Tel + 32 2 2965376
Fax +(32) 2 2951899

**Faqja elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/employment_social/emplweb/tenders/index_calls_en.cfm
http://europa.eu.int/comm/employment_social/calls/anualprog_2006_en.cfm

## 3.1.5 ENERGJIA DHE TRANSPORTI

### **06 03 02** – Mbështetje financiare për projekte me interes të përbashkët në rrjetin energjitik ndër- evropian

**Buxheti i dhënë:** 21.55 milion

Objektivi është të forcojë sigurinë e furnizimit me energji përmes krijimit dhe zhvillimit të rrjeteve trans-evropiane të energjisë, si dhe të kontribuojë në procesin e konkurencës për tregun e energjisë. Veprimtaritë e mbuluara përfshijnë studime fizibiliteti, studime përgatitore dhe vlerësimi dhe subvencione me përqindje interesi, garanci huaje dhe subvencionime të drejtpërdrejta për projekte me interes të përbashkët.

**Plotësojnë kushtet:**
Autoritet publike dhe institucionet private të krjuara ligjërisht në Shtetet Anëtare të BE-së.

**Kontaktoni:** Mr Alexandros SOTIRIOU
European Commission, Directorate-General Energy & Transport
B-1049 Brussels
Tel +32 2 295 9003
Fax +32 2 295 6504
E-mail alexandros.sotiriou@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/ten/energy/index_en.htm

### **06 04 01** – Energjia Inteligjente për Programin Evropian (2003 -o 2006)
### **06 04 02** – Energjia Intelligjente për Programin Evropian (2003 to 2006) Linja e jashtme – Coopener

**Buxheti i dhënë:** 55.47 milion

Linja e buxhetit 06 04 01 ka si qëllim nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm, sigurimin e furnizimit, konkurrencën dhe mbrojtjen e

mjedisit në fushën e energjisë. Po ashtu nxitet krijimi dhe zgjerimi i strukturave dhe instrumenteve për zhvillimin e energjisë së qëndrueshme. Llojet e veprimtarive përfshijnë: analiza të përbashkëta; zhvillimin e standarteve, etiketimin dhe sistemet e çertifikimit; dhe monitorimin e zhvillimit të tregjeve dhe tendencave të energjisë.
Masa të tjera që mbështeten nga kjo linjë buxheti janë: zhvillimi i produkteve financiare dhe instrumentave të tregut; nxitja e sistemeve të energjisë së qëndrueshme dhe pajisjeve; zhvillimi i informacionit, strukturat e edukimit dhe trainimit; dhe shpërndarja e përvojës dhe praktikave më të mira.
Linja e buxhetit 06 04 02 financon Coopener, linjën e jashtme të programit. Veprimtaritë do të drejtohen në masat dhe teknikat e zhvillimit në Komunitet të cilat mund të shtrihen në vendet në zhvillim dhe në nxitjen e njohurive praktike dhe trnasmetimin e teknologjive të Komunitetit tek ato vende.

**Plotësojnë kushtet:**
Si institucione publike dhe ato private me iniciativa në fushat e energjisë së ripërtëritshe, efektivitetin e energjisë dhe aspektet e energjisë së transportit. Inkurajohet pjesëmarrja e Biznesit të vogël dhe të mesëm (SMEs).

**Zona e financimit:**
Bashkimi Evropian, Shtetet Anëtare të Shoqatës së Tregut të Lirë Evropian dhe Zonës Ekonomike Evropiane ( EFTA/EEA) dhe vendet kandidate për në BE.

**Kontaktoni:** Mr Patrick Lambert (Director)
European Commission, Directorate-General for Energy and Transport
New and renewable sources of energy, demand management & sustainable development – D
B – 1049 Brussels
Tel +32 2 295 0531
E-mail tren-intelligentenergy@cec.eu.int / patrick.lambert@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/energy/intelligent/index_en.html

## **06 06 03** – Mbështetja e politikave dhe parashikimi i nevojave tekologjike dhe shkencore

**Buxheti i dhënë:** 8.65 milion

Kjo linjë buxheti synon të ndihmojë zhvillimin e aktiviteteve kërkimore për t'iu përgjigjur politikave të tjera të Komunitetit dhe për të filluar zbatimin e tyre kur del një nevojë urgjente. Kështu ajo siguron mbështetjen për potencialin ekonomik dhe kohezionin e Bashkimit Evropian, veçanërisht duke mbështetur vlerësimin e energjisë së qëndrueshme dhe sistemet e transportit dhe analizën e përgjithëshme të sigurisë në sektorin e transportit.

**Plotësojnë kushtet:**
Grupet kërkimore me interes të veçantë dhe kompetencë në aktivitete kërkimore në fushat e përmendura më lart, OJQtë, organizatat ndërkombëtare, autoritetet publike dhe private.

**Kontaktoni:** Mr William CANNELL (Head of Unit)
European Commission, Directorate-General Research
Anticipation of scientific and technological needs: fundamental research
Rue de Genève 1, B-1140 Brussels
Tel +32 2 296 0952, Fax +32 2 299 3173
E-mail rtd-nest@cec.eu.int

**Faqja e internetit:**
http://www.cordis.lu/nest

## **06 06 02 01** – Sisteme energjie të qëndrueshme

**Buxheti i dhënë:** 122.37

Qëllimi i këtij programi është të forcojë kapacitetet teknologjike dhe shkencore të Evropës me qëllim që të realizohet një zhvillim i qëndrueshëm në këtë drejtim. Kështu kjo linjë buxheti synon të mbulojë menaxhimin e kërkesës për energji, furnizimin me energji të përtëritshme të komuniteteve me automjete të fuqishme dhe transport urban të pastër.

**Plotësojnë kushtet:**
Organizatat Evropiane të cilat përfaqësojnë grupe të kërkimeve shkencore përkatëse apo aktorët e tregut. Mund të jenë të pranueshme edhe organizatat ndërkombëtare me aktivitete kërkimore mbi pasojat mjedisore të politikave të energjisë, ndër-varësia e furnizimit me energji dhe energjia ndër-kufitare si dhe çeshtjet mjedisore.

**Kontaktoni:** Mr Karl KELLNER
European Commission, Directorate-General for Energy and Transport
New and Renewable Sources of Energy; Demand Management and Sustainable Development – TREN D
Rue De Mot 24, B-1049 Brussels
Tel +32 2 295 2410
Fax +32 2 296 6017
E-mail karl.kellner@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://www.europa.eu.int/comm/dgs/energy_transport/rtd/wp_revision/index_en.htm

## **08 06 01 01** – Sisteme energjie të qëndrueshme

**Buxheti i dhënë:** 115.10 milion

Duke patur të njëjtin qëllim të përgjithshëm të linjës së buxhetit të mësipërm për energjinë, ky program mbulon gjithashtu menax-himin e kërkesës për furnizim me energji dhe energji të përtëritshme në komunitetet me automjete të fuqishme dhe transport urban të pastër.
Në mënyrë më specifike fushat e interesit përfshijnë: rezervuarë kar-buranti; teknologjitë e reja për vektorë energjie, shpërndarjen dhe ruajtjen e energjisë në shkallë Evrope; konceptet e përparuara për teknologjinë duke shfrytëzuar burimet energjitike të përtëritshme; eliminimin e dioksid karbonit me anën e instalimeve më të pastra për lëndë djegëse fosilesh; dhe mjetet social-ekonomike dhe kon-ceptet për një strategji për energjinë.

**Plotësojnë kushtet:**
Organizatat Evropiane të cilat përfaqësojnë grupe të kërkimeve përkatëse apo aktorët e tregut. Veçanërisht inkurajohen për të aplikuar bizneset e mesme dhe të vogla (SMEs). Po ashtu mund të jenë të pranueshme edhe organizatat ndërkombëtare me aktivitete kërkimore në drejtim të pasojave mjedisore të politikave të energjisë, ndër-varësisë së furnizimit me energji, dhe energjisë ndër-kufitare dhe çeshtjet e mjedisit.

**Kontaktoni:** Mr Michel POIREAU (Head of Unit)
European Commission, Directorate-General
Research — J1
B-1049 Brussels
Tel +32 2 295 1411
Fax +32 2 296 6882
E-mail rtd-energy@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://www.europa.eu.int/comm/dgs/energy_transport/rtd/wp_revision/index_en.htm

## 3.1.6 ZGJERIMI

### **22 03 02** — Aktivitetet e Zyrës së Shkëmbimit të Informacionit dhe Asistencës Teknike (TAIEX) në kuadër të asistencës për tranzicionin

**Buxheti i dhënë:** 4.15 milion

Këto fonde mbulojnë shpenzimet për programe për shumë përfitues për t'iu siguruar Vendeve Anëtare të reja asistencë teknike afatshkurtër lidhur me afrimin e legjislacionit për *acquis communautaire*. TAIEX organizon seminare teorike dhe praktike, studime dhe vizita ekspertësh, trainime, sigurimin e mjeteve, përkthimin dhe interpretimin, dhe ofron asistencë tjetër teknike jo vetëm për zyrtarët qeveritarë por edhe për përfaqësuesit e industrisë.

**Zona e financimit:**
Shtetet Anëtare të reja, Vendet kandidate, Ballkani Perëndimor.

**Kontaktoni:** Mr Alain Servantie (Head of Unit)
European Commission, Directorate-General
Enlargement
Technical Assistance Information Exchange Office,
Enlarg — B3, B-1049 Brussels
Tel +32 2 299 89 33
Fax +32 2 299 17 77
E-mail Elarg-Taiex@cec.eu.int / alain.servantie@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://taiex.cec.eu.int/

## **22 03 01** — Asitenca gjatë tranzicionin për ndërtimin institucional pas pranimit në BE

**Buxheti i dhënë:** 63.10 milion

Qëllimi i këtij programi është të vazhdojë të ofrojë asistencë për Vendet Anëtare të reja në drejtim të forcimit të kapacitetit administrativ për të zbatuar legjislacionin e Komunitetit dhe për të mbështetur shkëmbimin e praktikave më të mira.
Financohen veprimtaritë e asistencës në këto drejtime: drejtësia dhe çeshtjet e brendëshme; kontrolli financiar; mbrojtja e interesave financiare të Komunitetit dhe lufta kundër mashtrimit; tregu i brendshëm; mjedisi; shërbimi veterinar dhe ngritja e kapaciteteve administrative lidhur me sigurinë e ushqimit; strukturat administrative dhe të kontrollit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, duke përfshirë administrimin e integruar dhe sistemin e kontrollit (IAC); sigurinë bërthamore; statistikat dhe forcimin e administrimit publik sipas nevojave të paraqitura në raportet monitoruese gjithpërfshirëse.

**Kontaktoni:** Ms M. MAY (Deputy Head of Unit)
European Commission
Directorate-General Enlargement — D5
Rue de la Loi 200, B-1049 Brussels

Institution Building, Taiex, Twinning
Tel +32 2 296 3824
Fax +32 2 296 4712
E-mail enlargement@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/enlargement/transition_facility.htm

### 3.1.7 NDERMARRJET

**08 08 01 02** – Aktivitetet kërkimore horizontale që përfshijnë biznesin e mesëm dhe të vogël (SMEs)

**Buxheti i dhënë:** 122.66 milion

Kjo linjë buxheti synon të mbështesë bizneset e vogla dhe të mesme (SMEs) në përmirësimin e aftësive teknologjike dhe kapacitetit për të operuar në nivel evropian dhe ndërkombëtar. Aktivitetet realizohen në mbështetje të konkurrencës, politikave të novacionit dhe sipërmarrjes.

**Kontaktoni:** Mr Thomas ARNOLD (Head of Unit)
European Commission, Directorate-General Research
Research and SMEs – M/04
Tel +32 2 299 4062
Fax +32 2 296 3261
E-mail research-sme@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://www.europa.eu.int/comm/enterprise/funding/index.htm
http://www.cordis.lu/fp6/sme.htm

## **02 02 03 01** - Programe për biznese dhe iniciativa biznesi veçanërisht për Biznesin e mesëm dhe të vogël (SMEs)

**Buxheti i dhënë:** 18.70 milion

Ky program synon zbatimin e politikës së Komunitetit në mbështetje të bizneseve (veçanërisht të mesme dhe të vogla), duke përfshirë ato të angazhuar me tregjet e shpërndarjes dhe tregëtimit dhe sektorin e zejtarisë, turizmit, kooperativave, shoqëritë dhe shoqatat e përbashkëta për t'i mundësuar ata të zhvillojnë potencialin e tyre të plotë për punësim, zgjerimin e mëtejshëm dhe konkurrencën. Një theks i vaçantë i vihet përdorimit të Përgjegjësisë Sociale Korporative si bazë zhvillimi.
Programet/projektet duhet: të identifikojnë mjetet më të mira; të motivojnë dhe inkurajojnë firma për të treguar përgjegjësi shoqërore mbi baza vullnetare; të eksplorojnë përfitimet e mundëshme nga konkurrenca; të sigurojnë që bizneset e mesme dhe të vogla (SMEs) ndjekin një metodë efektive dhe koherente, të zhvillojë dhe nxisë aftësitë e menaxhimit sipas Përgjegjësisë Sociale Korporative; të optimizojë shkëmbimin e experiences dhe metodave të sukseshme; dhe të rrisë ndërgjegjësimin tek insititucionet përkatëse .

**Kontaktoni:** Mr Peter Wagner (Head of Unit)
European Commission, Directorate-General
Enterprise and Industry
General Coordination — A1, B-1049 Brussels
Tel +32 2 296 5498
E-mail research-sme@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://www.cordis.lu/fp6/sme.htm
http://www.europa.eu.int/comm/enterprise/funding/index.htm

## **02 02 02 01** — Kërkimi dhe Risi

**Buxheti i dhënë:** 39.94 milion

Kjo linjë buxheti mbështet nxitjen e novacionit teknologjik, shfrytëzimin e rezultateve të kërkimeve, tranferimin e njohurive, dhe ngritjen e bizneseve teknologjike. Aktiviteteve të synuara për nxitjen e

rolit të grave në shkencë dhe kërkime do t'iu kushtohet vemendje e veçantë. Ky financim do të mbulojë kostot e mbledhjeve, konferencave dhe seminareve teorikë dhe praktikë për teknologjinë me interes evropian. Aktivitetet kërkimore duket të respektojnë parimet etike themelore duke përfshirë kërkesat për mirëqënien e kafshëve.

**Kontaktoni:** Mr Jean-Noel DURVY (Head of Unit)
European Commission, Directorate-General Enterprise
Financing SMEs, entrepreneurs and innovators — D3, B-1049 Brussels
Tel +32 2 296 3582
Fax +32 2 296 2684
E-mail innovation@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://www.cordis.lu/fp6/policies.htm

## **02 02 03 02** — Mbështetje për Biznesin e Vogël dhe të Mesëm (SMEs) në Mjedisin e ri Financiar

**Buxheti i dhënë:** 7.00 milion

Kjo linjë buxheti është synuar për të financuar asistencën teknike veçanërisht masat e zhvillimit institucional dhe trainimin. Theks i veçantë i vihet bashkëpunimit ndër-kufitar ndërmjet institucioneve financiare dhe bizneseve të mesme dhe të vogla në Shtetet Anëtare ekzistuese dhe të rejat, vendet kandidate dhe vendet që janë në kufi me Bashkimin Evropian të zgjeruar.
Programet/projektet duhet të mbështesin krijimin e partneriteteve dhe rrjeteve ndërmjet bankave lokale dhe rajonale, dhomave të tregëtisë, agjencive të zhvillimit rajonal dhe autoriteteve të tjera lokale dhe rajonale të angazhuara për financimin e biznesve të mesme dhe të vogla(SMEs) ose të koordinojnë projekte të financuara nga programet e Phare, Tacis, Cards dhe Meda.

**Plotësojnë kushtet:**
Projektet të cilat menaxhohen nga ndonjë prej institucionve financiare ndërkombëtare: Banka e Investimeve Evropiane (EIB); Fondi i Investimit Evropian (EIF); Banka Evropiane për Rikonstruksion

dhe Zhvillim (EBRD); Banka e Zhvillimit e Këshillit të Evropës në bashkëpunim me Kreditanstalt für Wiederaufbau. Prioritet duhet t'i jepet mikrokrediteve për bizneset e mesme dhe të vogla (SMEs) ekzistuese dhe të reja në Shtetet Anëtare të reja.

**Zona e financimit:**
Shtetet Anëtare të BE, vendet kandidate dhe vendet në kufi me Bashkimin Evropian të zgjeruar.

**Kontaktoni:** Mr Jean-Noel DURVY (Head of Unit)
European Commission, Directorate-General
Enterprise
Financing SMEs, entrepreneurs and innovators
— D3, B-1049 Brussels
Tel +32 2 296 3582
Fax +32 2 296 2684
E-mail research-sme@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://www.cordis.lu/fp6/sme.htm
http://www.europa.eu.int/comm/enterprise/ funding/index.htm

## 3.1.8 MJEDISI

### **07 03 06 01** — Programi i veprimit të Komunitetit në fushën e mbrojtjes civile

**Buxheti i dhënë:** 7.01 milion

Kjo linjë mbështet rritjen e aftësive mbrojtëse civile të Shteteve Anëtare, vendeve të Zonës Ekonomike Evropiane (EEA) dhe vendeve kandidate. Ai synon të mbulojë shpenzimet lidhur me zbatimin e bashkëpunimit të Komunitetit në fushën e mbrojtjes civile, duke përfshirë rastet e jashtëzakonshme mjedisore dhe masat përgatitore për t'i përballuar ato, në veçanti:

- Parandalimi, parashikimi, zbulimi, përgatitja për t'iu përgjigjur situatave të jashtëzakonshme dhe kujdesi i menjëhershme për t'u përballur me to, analiza e pasojave social-ekonomike të fatkeqësive natyrore.

- Seminare praktike, kurse, shkëmbimi dhe dërgimi i ekspertëve, dhe ushtrime të synuara për nxitjen e bashkëpunimin.
- Veprimtari dhe projekte pilot për të rritur kapacitetin, shpejtësinë dhe informacionin mbështetës si dhe aktivitete ndërgjegjësuese.
- Mobilizimi i ekspertëve
- Asistencë për transportimin

Po ashtu synohet të ofrohet asistencë për forcimin e bashkëpunimit mes Shteteve Anëtare për ndërhyrje në drejtim të mbrojtjes civile kundër kërcënimit teorrist dhe bioterrorist.

**Plotësojnë kushtet:**
Personat juridikë në Shtetet Anëtare të BE apo Islandës, Liechtenstein dhe Norvegjisë. Vendet kandidate mund të marrin pjesë në aktivitetin e propozuar me shpenzimet e tyre.

**Kontaktoni:** Ms Pia BUCELLA (Head of Unit)
European Commission, Directorate-General Environment
Information Centre – BU9, B-1049 Brussels
Tel +32 2 295 7099
Fax +32 2 299 0314
E-mail pia.bucella@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/environment/civil/index.htm

## **07 03 02** – Programi i veprimit të Komunitetit për nxitjen e organizatave jo-qeveritare aktive kryesisht në fushën e mbrojtjes së mjedisit

**Buxheti i dhënë:** 8.00 milion

Kjo pjesë e buxhetit mbulon grantet për OJQ-të aktive në mbrojtjen e mjedisit. Qëllimi i tij është të kontribuojë për politikën dhe legjislacionin mjedisor të BE dhe të rrisë pjesëmarrjen e shoqërisë civile në debate për mjedisin. Ai po ashtu synon të mbulojë shpenzimet për studime, rishikime analitike dhe mbledhje të ekspertëve në mbështetje të aktiviteteve operacionale.

**Zona e financimit:**
Shtetet Anëtare të BE, vendet kandidate dhe vendet ballkanike.

**Kontaktoni:** Mr Stefan WELIN
European Commission, Directorate-General Environment
Legal Affairs and Governance — A3
Rue de la Loi 200, BU-5 6/148, B-1049 Brussels
Tel +32 2 296 6918
Fax +32 2 299 1068
E-mail env-ngo@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://www.europa.eu.int/comm/environment/funding/intro_en.htm

## **07 02 01** — Kontributi për aktivitete mjedisore ndërkombëtare

**Buxheti i dhënë:** 8.09 milion

Kjo linjë buxheti mbulon zbatimin e programeve për veprimtari mjedisore, nxitjen e masave për trajtimin e problemeve ndër-kufitare dhe globale, dhe integrimin e çeshtjeve mjedisore në marrëdhëniet e jashtme të Komunitetit.

Një pjesë e tij është caktuar për investim për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin në vendet fqinjë. Një pjesë e fondeve menaxhohen përmes instrumentave financiarë si PHARE dhe CARDS por ka edhe një thirrje të përgjithshme për projekt-propozime për programe më specifike.

**Ky program synon:**
krijimin e një mbështetjeje mjedisore të fortë në Partneritetin Evropë-Mesdhe; mbështetjen e adaptimit të vendeve kandidate dhe ballkanike me *acquis për* mjedisin të BE-së; dhe afrimin e vendeve fqinjë me normat mjedisore të Be-së. Po ashtu mbulon programe që nxisin OJQ-të kryesisht aktive në fushën e mbrojtjes së mjedisit, me theks të veçantë tek OJQ-të në vendet kandidate dhe ballkanike.

Megjithatë pjesa më e madhe e OJQ-ve mjedisore në vendet fqinjë nuk kanë përftuar ende gamën e plotë të aftësive isntitucionale dhe organizative të nevojshme. Ndërkohë që kanë arritur të aftësohen për të dhënë sinjalin për shkelje në disa drejtime, ato ende kanë nevojë të zhvillojnë kapacitetin e përgjithshëm dhe të mësojnë si të punojnë si partnerë të plotë dhe plotësues për administrimin e zbatimit të legjislacionit mjedisor. Kështu ky projekt zhvillon kapacitetet e OJQ-ve permes transferimit të përvojës nga OJQ-të mjedisore të suksesshme në 25 vendet e BE-së tek OJQ-të mjedisore në Romani, Bullgari, Turqi, Kroaci, Serbi dhe Malin e Zi, Bosnjë-Herceogovinë, Shqipëri, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (FYROM), Rusi, Ukrainë, Bjellorusi ose Moldavi, përmes binjakëzimit, këshillimit dhe shkëmbimit të informacionit.

**Kontaktoni:** Ms Anne BURRILL (Deputy Head of Unit)
Directorate-General Environment – E3
Tel +32 2 295 4388
Fax +32 2 299 4123
E-mail anne.burrill@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/environment/enlarg/index_en.htm
http://europa.eu.int/comm/environment/funding/intro_en.htm

## **10 02 02** – Mjedisi dhe Qëndrueshmëria

**Buxheti i dhënë:** 10.25 milion

Qëllimi strategjik i këtij programi është të nxisë shkencën dhe teknologjinë mjedisore për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe rritjen, konkurrencën dhe punësimin ndërsa plotëson nevojat për një menaxhim të qëndrueshëm të burimeve dhe mbrojtjen e mjedisit. Këto veprime përfshijnë:

- Menaxhimin e qëndrueshëm dhe cilësinë e ujit
- Ndryshimin Global, klimën dhe biodiversitetin
- Ekosistemet detare të qëndrueshme
- Qytetin e së nesërmes dhe trashëgiminë kulturore

Ju lutemi referojuni faqes së internetit për më shumë detaje për çdo linjë aktiviteti.

**Plotësojnë kushtet:**
OJQ-të Mjedisore, bizneset e mesme dhe të vogla (SMEs) dhe personat e tjerë juridikë në Shtetet Anëtare të BE dhe vendet kandidate.

**Kontaktoni:** EESD InfoDesk
European Commission
Energy, Environment and Sustainable Development
Square Frere Orban, B-1040 Brussels
E-mail eesd@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://www.cordis.lu/eesd/src/overview.htm#1

## **07 03 03** – JETA III (Instrumenti Financiar për Mjedisin 2000 – 2006) Projekte mbi territorin e Komunitit – Pjesa I (mbrojtja e natyrës)

**Buxheti i dhënë:** 71.10 milion

Kjo linjë buxheti mundëson asistencën për masa specifike lidhur me mbrojtjen e natyrës, veçanërisht ruajtjen e mjedisit natyror dhe të specieve të florës dhe faunës. Aktivitetet e synuara përfshijnë ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të rrjetit Natyra 2000. Po ashtu mbulohet edhe përgatitja e projekteve që përfshijnë partnerë në disa Shtete Anëtare dhe shkëmbimin e përvojës mes projekteve.

**Plotësojnë kushtet:**
Persona juridikë në Shtetet Anëtare të BE, vendet kandidate, veçanërisht OJQ-të dhe autoritetet lokale.

**Kontaktoni:** Mr Philip OWEN (Head of Unit)
European Commission, Directorate-General Environment
LIFE - D1, BU-9 02/1, B-1049 Brussels
Tel +32 2 296 5562
Fax +32 2 292 1787
E-mail nature@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://www.europa.eu.int/comm/environment/life/life/nature.htm

## **07 03 04** – JETA III (Instrumenti Financiar për Mjedisin 2000 – 2006) Projekte mbi territorin e Komunitit – Pjesa II (mbrojtja e mjedisit)

**Buxheti i dënë:** 72.10 milion

Objektivi i projektit JETA-Mjedisi është të kontribuojë për zhvillimin e teknikave dhe metodave të reja si dhe për zhvillimin e politikës të Komunitetit për mjedisin.
Programi mbështet projekte të cilat: përfshijnë interesim për mjedisin dhe përparim të qëndrueshëm në zhvillimin dhe planifikimin e përdorimit të tokës; nxisin menaxhimin e ujrave; zhvillojnë teknologji të pastra; krijojnë sisteme menaxhimi të mbeturinave; sigurojnë një metodologji të integruar për produkte që nuk dëmtojnë mejdisin, dhe zhvillojnë politikat mjedisore të Komunitetit.
Po ashtu ai mbulon veprimtari dhe studime që mundësojnë një koordinim më të mirë të ndikimeve ndër-kufitare të kushteve mjedisore në pejsazhe, lumenjtë e lundrueshëm dhe sitemet ujore.

**Plotësojnë kushtet:**
Të gjithë personat juridikë në Shtetet Anëtare të BE dhe disa vende kandidate; Inkurajohet pjesëmarrja e bizneseve të mesme dhe të vogla (SMEs), OJQ-ve dhe autoriteteve publike.

**Kontaktoni:** Mr Philip OWEN (Head of Unit)
European Commission, Directorate-General Environment
LIFE - D1, BU-9 02/1, B-1049 Brussels
Tel +32 2 296 5562
Fax +32 2 292 1787
E-mail nature@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://www.europa.eu.int/comm/environment/life/life/environment.htm

### 3.1.9 SHËNDETI DHE MBROJTJA E KONSUMATORIT

## **08 02 01 01** – Avancimi i studimit të genomes dhe zbatimi i saj për shëndetin

**Buxheti i dhënë:** 355.98 milion

Këto fonde mbështesin shfrytëzimin e arritjeve shkencore në genomen e organizmave të gjalla në dobi të shëndetit, dhe kanë si qëllim rritjen e konkurrencës në industrine bio/teknologjike Evropiane. E një rëndësie të veçantë është të arrihet të zbatohen njohuritë bazë, të mundësohet progresi në mjeksi dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës. Financohen aspektet e mëposhtme:

- Zhvillimi i njohurive bazë, mjeteve dhe burimeve për të siguruar njohuritë themelore dhe mjetet për një strukture genome funksionale në të gjitha organizmat.
- Zbatimi i njohurive dhe teknologjive në fushën e genomes dhe bioteknologjisë për shëndetin.

**Plotësojnë kushtet:**
Organizatat ndërkombëtare, organizatat nga vendet në zhvillim, grupet kërkimore, dhe grupt që punojnë në këtë fushë. Inkurajohen të marrin pjesë edhe bizneset e mesme dhe të vogla (SMEs).

**Zona e financimit:**
Bashkimi Evropian, vendet kandidate të Bashkimit Evropian, vendet e EFTA/EEA dhe vendet në zhvillim.

**Kontaktoni:**
Mr Stephane HOGAN (Head of Unit)
European Commission, Directorate-General Research
Biotechnology and applied genomics – F5
Rue de Genève 1, B-1049 Brussels
Tel +32 2 296 2965
Fax +32 2 299 8846
E-mail rtd-genomics-biotec@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://www.cordis.lu/lifescihealth/workprogramme.htm

## **08 02 01 02** — Lufta kundër sëmundjeve kryesore

**Buxheti i dhënë:** 291.31 milion

Kjo linjë buxheti mbulon aktivitetet kërkimore të cilat: përmirësojnë strategjitë për parandalimin dhe menaxhimin e sëmundjeve të njeriut; përmirësojnë dhe përdorin teknologjitë për një jetë dhe mplakje të shëndetshme, diagnistikojnë sëmundjet dhe përcaktuesit e shëndetit; luftojnë kundër kancerit; zbatojnë njohuritë në praktikën klinike; përballojnë sëmundjet e rënda të shoqëruara me varfëri —veçanërisht HIV/AIDS, malaria dhe tuberkulozi — dhe realizojnë ndërhyrje efektive për sëmundjet veçanërisht në vendet në zhvillim.

**Plotësojnë kushtet:**
OJQ-të dhe institucionet kërkimore që punojnë në këtë fushë nga Shtetet Anëtare të BE-së; grupet dhe organizatat nga vendet në zhvillim, Bizneset e vogla dhe të mesme ( SMEs).

**Zona e financimit:**
Përfitojnë veçanërisht vendet në zhvillim të cilat pritet të jenë partnerë të rëndësishëm në fazën zbatuese.

**Kontaktoni:** Catherine Berens (Combating cardiovascular disease, diabetes and rare diseases): catherine.berens@cec.eu.int

Anna Lonnroth (Combating resistance to antibiotics and other drugs): anna.lonnroth@cec.eu.int

Philippe Cupers (Studying the brain and combating diseases of the nervous system): philippe.cupers@cec.eu.int

Christian Wimmer (Studying human development and the ageing process): christian.wimmer@cec.eu.int

E-mail rtd-diseases@cec.eu.int (general enquiries)

**Faqja elektronike:**
http://www.cordis.lu/lifescihealth/major/home.htm

## 17 02 01 – Aktivitetet e Komunitetit në interes të konsumatorit

**Buxheti i dhënë:** 19.19 milion

Kjo linjë financon strategjinë shumëvjeçare të mbrojtjes së konsumatorit (2002-2006) me tre objektiva:

- Nivel të lartë të harmonizuar të mbrojtjes së konsumatorit në tërë BE-në dmth harmonizimin jo vetëm të sigurisë së prodhimeve dhe shërbimeve por edhe të interesave ekonomike dhe ligjore që lidhen me konsumatorët.
- Zbatimi i efektshëm i rregullave të mbrojtjes së konsumatorit, duke nënkuptuar që konsumatorët duhen të kenë të njëjtën mbrojtje në tërë BE-në. Veprimtaritë prioritare në këtë fushë përfshijnë mekanizmat e zhdëmtimit për konsumatorët dhe bashkëpunimin administrativ.
- Përfshirja e organizatave të konsumatorëve në politikat e BE-së me anën e pjesëmarrjes aktive dhe zbatimi i projekteve për ngritje kapacitetesh dhe pjesëmarrje aktive.

**Plotësojnë kushtet:**
Organizatat joqeveritare të pavarura të konsumatorit të nivelit evropian që përfaqësojnë organizatat kombëtare të konsumatorit.

**Kontaktoni:** Ms Veronique ARNAULT (Head of Unit)
European Commission, Directorate-General Health and Consumer Protection
SANCO B1/B, 232 6/79, B-1049 Brussels
Tel +32 2 299 0006
Fax +32 2 298 1223
E-mail veronique.arnault@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/consumers/index_en.htm

## **07 03 01 01** – Shëndeti Publik (2003 – 2008)

**Buxheti i dhënë:** 51.69 milion

Ky program kontribuon në sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit, përmirësimin e shëndetit publik, dhe parandalimin e sëmundjeve. Prioritetet janë:

- Përmirësimi i informacionit dhe njohurive duke zbatuar një sistem për mbledhjen, analizën, vlerësimin dhe paraqitjen e informacionit shëndetësor tek autoritetet kompetente, profesionistët e shëndetit dhe publiku.
- Rritja e aftësisë për t'iu përgjigjur shpejt dhe në mënyrë të koordinuar rrezikut për shëndetin.
- Drejtimi i vëmendjes tek përcaktuesit e shëndetit përmes nxitjes së masave për parandalimin e sëmundjeve.

**Plotësojnë kushtet:**
OJQ-të, shoqatat, institucionet e sektorit publik, universitetet dhe institucionet e larta të edukimit, firmat tregëtare (nëse nuk gjenerohen fitime nga projekti).

**Zona e financimit:**
Bashkimi Evropian, Shtetet e Shoqatës së Tregut të Lirë Evropian (EFTA), vendet kandidate të Bashkimit Evropian.

**Kontaktoni:**

Mr Michael HUEBEL (Head of Unit)
Directorate-General Health, Consumer Protection – C4
Health Determinants
LUX – 2920 Luxembourg
Tel +352 430 134 023
Fax +352 430 134 975

**Faqja elektronike:**
http://www.europa.eu.int/comm/health/index_en.html

## 3.1.10 DREJTËSIA DHE TREGËTIA VËNDASE

### **18 05 01 02** - AGIS: Programi mbështetës për bashkëpunimin e policisë dhe organeve gjyqsore të krimeve

**Buxheti i dhënë:** 15.78 milion

Ky program mbulon projekte në drejtimet e mëposhtme: bashkëpunimin e organeve gjyqsore për çështje të përgjithshme dhe kriminale, duke përfshirë trainimin; bashkëpunimin mes autoriteteve zbatuese të ligjeve apo organizatave të tjera publike dhe private në Shtetet Anëtare të angazhuara në parandalimin dhe luftën ndaj krimit (të organizuar ose jo); dhe bashkëpunimin mes Shteteve Anëtare për të arritur një mbrojte të efektshme të interesave të viktimave në proceset gjyqsore të krimeve.
Po ashtu mbështeten të drejtat e garancive proceduriale për të ndihmuar individë të përfshirë në procese gjykimi të krimive në kuadër të bashkëpunimit të organeve të drejtësisë të vendeve të ndryshme.

Llojet e aktiviteteve të përfshira: trainime, skema shkëmbimi dhe detyrash; studime dhe kërkime; krijim rrjetesh, konferenca dhe seminare.

**Plotësojnë kushtet:**
Institucionet dhe organizatat publike dhe private, duke përfshirë organizatat profesionale, organizatat jo-qeveritare, shoqatat, organizatat përfaqësuese të biznesit, institutet kërkimore dhe ato të trainimit bazë dhe të avancuar.

**Financimi:**
Komisioni bashkë-financon deri në 70% të të gjithë kostos totale të pranueshme të projektit. Për veprimtari specifike dhe masa plotësuese bashkëfinancimi mund të arrijë deri në 100%.

**Kontaktoni:** Mr Roberto SEGRE
European Commission, Directorate-General Justice and Home Affairs
AGIS programme — D4

B-1049 Brussels
Tel +32 2 295 1327
Fax +32 2 299 8215
E-mail JAI-AGIS@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/justice_home/funding/agis/funding_agis_en.htm

## **08 06 01 02** – Programi i bashkëpunimit për çeshjte civile

**Buxheti i dhënë:** 3.75 milion

Kjo strukturë programi synon:

- Nxitjen e bashkëpunimit të organeve gjyqsore për çështje civile, dhe në veçanti besimin tek ligji dhe përmirësimin e aksesit në drejtësi.
- Nxitjen e njohjes reciproke të vendimeve gjyqsore dhe afrimit të legjislacionit.
- Eliminimin e pengesave të krijuara nga mospërputhjet në legjislacionin dhe proçedurat civile .
- Përmirësimi i njohurive reciproke të sitemeve ligjore dhe gjyqsore të Vendeve Anëtare për çështje civile dhe i informacionit për publikun mbi aksesin në drejtësi.
- Sigurimi i zbatimit të instrumentave të Komunitetit.

Masat që mbështeten janë: veprimtari specifike të ndërmarra me iniciativën e Komisionit; projekte specifike në interes të Komunitetit; dhe aktivitete të organizatave jo-qeveritare (OJQ-ve).

**Plotësojnë kushtet:**
Institucionet dhe organizatat publike dhe private, duke përfshirë organizatat profesionale, insitutet kërkimore dhe si dhe institutet e trainimit të organeve gjyqsore dhe ligjore, dhe të profesionistëve në fushën e ligjit.

**Zona e financimit:**
Të gjithë Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian përveç Danimarkës.

**Kontaktoni:** Mr Michel VERSCHRAEGEN
European Commission, Directorate-General Justice and Home Affairs - C/4
46 Rue du Luxembourg, B-1049 Bruxelles
Tel +32 2 296 2014
Fax +32 2 299 6457
E-mail jai-framework-civil@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/justice_home/funding/civil_cooperation/funding_civil_cooperation_en.htm

## **18 03 06** – Integrimi i shtetasve të vendeve jo-anëtare.

**Buxheti i dhënë:** 5.00 milion

Kjo linjë buxheti mbulon masat për: nxitjen e integrimit të shteteve jo-anëtare përmes projekteve specifike (psh kurse gjuhe, informacione për karakteristikat shoqërore, politike dhe kulturore të vendeve përkatëse duke përfshirë qytetarinë dhe vlerat Evropiane); zhvillimin e dialogut me shoqërinë civile; studime dhe vlerësime të praktikave më të mira për integrimin e refugjatëve dhe azil-kërkuesve; zhvillimin e modeleve të integrimit; dhe ngritjen e rrjeteve. Projektet duhet të përfshijnë partnerë nga të paktën pesë Shtete Anëtare për të arritur një dimension të fortë ndër-kombësh.

**Plotësojnë kushtet:**
Personat juridikë, kompanitë, organizatat jo-qeveritare, autoritetet lokale dhe rajonale, të regjistruara në një nga Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian, si dhe organizatat ndërkombëtare që punojnë mbi baza krejtësisht jo-fitimprurëse.

**Zona e financimit:**
Bashkimi Evropian. Vende të treta mund të marrin pjesë në aktivitete të ndërmarra nga Shtetet Anëtare megjithëse ato nuk mund të përfshihen dhe mbështeten financiarisht nga ky projekt.

**Kontaktoni:** Miss Muriel GUIN
European Commission, Directorate-General Justice and Home Affairs – B4

LX 46-5/166, B-1049 Brussels
Tel +32 2 296 0013
Fax +32 2 298 0306
E-mail JLS-INTI@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/justice_home/funding/inti/funding_inti_en.htm

## **18 04 01 02** – Masat për luftën kundër dhunës ndaj fëmijëve, adoleshentëve dhe grave– Daphne II

**Buxheti i dhënë:** 9.68 milion

Kjo linjë buxheti përfshin fazën e dytë të Programit DAPHNE (2004-8) dhe, ashtu si programi para-ardhës, synon ngritjen e rrjeteve në nivel Evrope për të nxitur informacionin dhe veprimtaritë apo masat për mbrojtjen dhe parandalimin e dhunës ndaj fëmijëve, të rinjve dhe grave, dhe për të luftuar trafikimin e grave për shfrytëzim prostitucioni apo gjymtimin e organve gjenitale të femrave si dhe martesat e detyruara.
Programi gjithashtu përfshin mbrojtjen e fëmijëve, adoleshentëve dhe grave nga dhuna dhe ndihmon viktimat.

**Plotësojnë kushtet:**
Institucionet publike dhe private aktive në fushën e parandalimit dhe mbrojtjes nga dhuna kundër fëmijëve, të rinjve dhe grave, veçanërisht OJQ-të dhe organizatat vullnetare. Partnerët e projekteve duhet të jenë nga Shtete Anëtare të Bashkimit Evropian.

**Kontaktoni:** Mr Patrick TROUSSON
European Commission, Directorate-General Justice and Home Affairs
Financial support for Justice, rights and citizenship – C4
LX46 0/151, B-1049 Brussels
Tel +32 2 296 5803
E-mail daphne-helpdesk@transtec.be

**Faqja elektronike:**
http://www.europa.eu.int/comm/justice_home/funding/daphne/funding_daphne_en.htm

## **18 04 03** – Programe Kërkimore dhe Vlerësimi lidhur me respektimin e të Drejtave themelore të Njeriut

**Buxheti i dhënë:** 0.50 milion

Kjo linjë buxheti financon ngritjen e rrjeteve të ekspertëve ligjorë, të cilët janë kompetent në fushën e të drejtave të njeriut dhe juristë nga çdo Shtet Anëtar. Kjo përfshin vlerësimin e zbatimit të të drejtave të përcaktuara në Kartën e të Drejtave Thelore të Bashkmit Evropian.
Po ashtu financon krijimin e mjeteve si (bazën e të dhënave, linjat telefonike të ndihmës, ndihmën ligjore) në marrëveshje me institucionet përkatëse të Shteteve Anëtare dhe OJQ-të që punonë në fushën e të drejtave themelore, duke ndihmuar individët të sigurojnë hyrje në informacionin e kërkuar.

**Plotësojnë kushtet:**
Autoritetet administrative dhe gjyqsore, ekspertët ligjorë, të cilët janë kompetent në fushën e të drejtave të njeriut dhe juristë nga çdo Shtet Anëtar. Po ashtu konsiderohen të pranueshëm edhe OJQ-të që punojnë në fushën e të drejtave themelore të njeriut.

**Kontaktoni:** Ms D. CORREIA (Head of Section)
European Commission, Directorate-General Justice and Home Affairs
Programming Monitoring and Reporting – A1
Rue de la Loi 200, B-1049 Brussels
Tel +32 2 295 0101

**Faqja elektronike:**
http://www.europa.eu.int/comm/justice_home/funding/rights/funding_rights_en.htm#

**19 04 02** – Mbështetje për viktimat nga abuzimi i të drejtave të njeriut
**19 04 03** – Zhvillimi dhe konsolidimi i demokracisë dhe sundimit të ligjit – Respektimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore
**19 04 04** – Mbështetje për aktivitete të Gjykatave Ndërkombëtare të Krimeve (respective) dhe Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve
**19 04 05** – Mbështetja e një rrjeti për parandalimin e Konflikteve

**Buxheti i dhënë:** përkatësisht 7.00 / 105.41 / 7.00 / 1.50 milion

Siç përcaktohet në Regulloren e Këshillit (KE) 975/99 dhe (KE) 976/99 objektivi i programit të Iniciativës Evropiane për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (EIDHR) është inkurajimi i zbatimit të të drejtave të njeriut, i demokracisë dhe parandalimi i konflikteve në vendet e treta. Programi për 2005-6 ndjek një metodologji më specifike se më parë dhe respektivisht fondet tani drejtohen tek zona gjeografike më të gjera me përqëndrim më të madh tematik.
Përgjithësisht,qëllimi i Iniciativës Evropiane për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut (EIDHR) është : forcimi i demokratizimit, mirë-qevirisja dhe sundimi i ligjit; mbështetja e heqjes së dënimit me vdekje si dhe lufta kundër torturave dhe mosndëshkimit; mbështetja e Gjykatave ndërkombëtare dhe Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve; lufta kundër racizimit, dhe ksenofobisë dhe diskriminimit të minoriteteve etnike dhe banorëve autoktonë.
Për t'i bërë më të qarta dhe më të kuptueshme objektivat janë përcaktuar katër fushata tematike të cilat janë:

- Fushata 1: Inkurajimi i zbatimit të drejtësisë dhe vënia në zbatim të ligjit
- Fushata 2: Nxitja e kulturës së të drejtave të njeriut
- Fushata 3: Nxitja e proçesit demokratik
- Fushata 4: Përmirësim i barazisë, tolerancës dhe paqës

Të gjitha fushatat do të realizohen në nivel global, në nivel rajonesh të përzgjedhura dhe nivel vendesh të caktuara brenda këtyre rajoneve. Më poshtë është bërë një përmbledhje e kontekstit politik dhe fokusimit të secilës fushatë:

- **Vendet kandidate dhe ato të Ballkanit perëndimor:** Programi 2000-6 i Ndihmës së Komunitetit për Rindërtim, Zhvllim dhe Stabilitet (CARDS) me shumën prej  4.65 miliard Eurosh është dhënë për të mbuluar burime të rëndësishme për forcimin e institucioneve dhe ndërtimin e kapaciteteve administrative, veçanërisht në fushën e drejtësisë dhe çeshtjeve të brendëshme . Fushata 2 dhe 4 kanë janë kryesisht të fokusuara në këtë rajon.

- **Evropa Lindore dhe Kaukazi Jugor:** BE ka Marrëveshje Bashkëpunimi dhe partneriteti me të gjitha vendet e këtij rajoni përveç Bjellorusisë.  Instrumenti kryesor i financimit përfshihet në programin TACIS .  BE i kushton shumë vëmendje nxitjes së zbatimit të të drejtave të njeriut dhe demokracisë në këtë rajon, edhe përmes vëzhgimit të zgjedhjeve dhe ndihmesës.  Në kuadër të Programit të EIDHR 2004-2006, rajoni përfshihet në fushatën 2 dhe 3 në nivel vendi dhe rajoni.  Duke patur parasysh situatën në Çeçeni, Rusia po ashtu është e përzgjedhur për t'u mbështetur brenda kuadrit të Fushatës 4.

- **Mesdheu dhe Lindja e Mesme:** Programi MEDA përbën instrumentin financiar bazë që zbatohen për zona të mëdha të këtij rajoni.  EIDHR do të plotësojë këto aktivitete përmes mbështetjes së shoqërisë civile në këtë rajon duke u fokusuar tek fushatat 2 dhe 3 në nivel vendi dhe rajoni. Konsiderohen veçanarisht të përshtatshme aktivitetet të cilat nxisin lirinë e organizimit dhe të të shprehurit dhe rritjen e aftësive të shoqërisë civile për t'u angazhuar në dialog politik me autoritetet.  Po ashtu janë parashikuar edhe aktivitete që kanë si qëllim luftën kundër torturave, dhe aktivitetet e shoqërisë civile në mbështetje të të drejtave të grave dhe përmirësimin e realitetit lidhur me mbrojtësit e të drejtave të njeriut. Fushata 1 do të aplikohet në nivel rajonal veçanërisht lidhur me epërsinë që ka dënimi me vdekje në legjislacionet e vendeve të Medheut dhe Lindjes së Mesme. Në Irak, mbështetja përfshihet në të gjitha Fushatat në varësi të nevojave të identifikuara ndërsa për Iranin aplikohen fushatat 1 dhe 2.

Programi është i ndarë në **miniprojekte** dhe **makroprojekte**. **Makroprojektet** përfshijnë projektet me një mbështetje minimale prej 300,000 eurosh për kandidatët nga BE-ja dhe prej 150,000 eurosh për organizatat e shoqërisë civile në zonat apo vendet përkatëse të

përzgjedhura sipas destinancionit të këtij projekti. Projektet rajonale dhe globale do të jenë makroprojekte dhe aplikuesit do të trajtohen mbi baza të barabarta, si nga vendet e BE-së apo edhe nga rajonet e caktuara sipas Fushatës përkatëse. Nga ana tjetër **mikroprojektet**, janë projekte me një sasi fondi nga €10,000 deri and €100,000, të dispoueshme ekskluzivisht për kandidatët nga shoqëria civile brenda vendeve të përzgjedhura në kuadër të Fushatës përkatëse. Sidoqoftë këta kandidatë lokalë mund të punojnë në bashkëpunim me OJQ -të dhe BE.

Duke patur parasysh të gjithë projektet do të kenë prioritet, nëse është e mundur, ato projekte të cilat përfshijnë organizatat që përfaqësojnë popullsinë autoktone apo të cilat kanë në fokus popullsitë autoktone, projektet që kanë si objektiva parandalimin e konflikteve dhe zgjidhjen e tyre. Vemendje e veçantë do t'i kushtohet reflektimit në aktivitete të barazisë gjinore dhe të të drejtave të fëmijëve.

Përfituesit e aktiviteteve të realizuara duhet të jenë organizatat jo-qeveritare jo-përfituese apo institucionet e edukimit të lartë dhe që normalisht kanë zyrat qëndrore në vendet e Bashkimit Evropian ose në një vend përfitues. Këtu mund të përfshihen organizata rajonale dhe ndërkombëtare, organizata jo-qeveritare, autoritetet lokale, kombëtare dhe agjencitë zyrtare, organizata me bazë komuniteti dhe institute e operatorë të sektorit publik dhe privat, si dhe ofrues të shërbimeve. Kriteret e përzgjedhjeve do të paraqiten qartë në thirrjet për projekt-propozime.

**Kontaktoni:** Ms Malin STAWE (Head of Section)
European Commission, AIDCO Europe Aid
Cooperation Office – 04
Central management of thematic budget lines
Tel +32 2 298 7017
Fax +32 2 295 7482
E-mail malin.stawe@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/europeaid/projects/eidhr/index_en.htm (e përgjithëshme)
http://europa.eu.int/comm/europeaid/cgi/frame12.pl (thirrje për projekt-propozime)

## 3.1.11 KËRKIMI, ZHVILLIMI TEKNOLOGJIK

### **08 07 01** – Shtetasit dhe qeverisja në një shoqëri të bazuar në informacion

**Buxheti i dhënë:** 61.50 milion

Kjo linjë buxheti synon të mbulojë mobilizimin e kapaciteteve kërkimore në shkencat humane dhe shoqërore, politike dhe ekonomike. Qëllimi i saj është trajtimi i çeshtjeve që lidhen me domosdoshmërinë e një shoqërie të bazuar në informacion dhe formave të reja të bashkëpunimit mes shtetasve dhe institucioneve. Projektet duhet të lidhen me : përmirësimin e nivelit të brezit, shpërndarjen dhe përdorimin e informacionit, mundësitë dhe zgjedhjet për zhvillimin e një shoqërie të bazuar në informacion; zbatimi i tyre për integrimin dhe zgjerimin evropian, format e qeverisjes, zgjiidhjen e konflikteve dhe format e reja të qytetarisë dhe identiteteve kulturore.

**Plotësojnë kushtet:**
Personat juridikë të Shteteve Anëtare të BE. Inkurajohet pjesëmarrje e bizneseve të mesme dhe të vogla (SMEs).

**Kontaktoni:** Ms Silvia DURMEIER
European Commission, Directorate-General Research – K3
Citizens and Governance in the Knowledge Based Society
Tel +32 2 295 7097
Fax +32 2 296 2137
E-mail rtd-citizens@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://www.cordis.lu/citizens/home.html

## **08 10 01 04** – Shkenca dhe Shoqëria

**Buxheti i dhënë:** 27.84 milion

Kjo linjë buxheti përfshin inkurajimin e zhvillimit në Evropë të lidhjeve të harmonizuara ndërmjet shkencës dhe shoqërisë, hapjen ndaj risive si rezultat i vendosjes së marrëdhënieve mes kërkuesve shkencorë, industrialistëve, politikë-bërësve dhe shtetasve.
Ideja është të krijohet një mjedis ku publiku i gjerë veçanërisht të rinjtë të jenë më të vetëdijshëm dhe të informuar mbi shkencën, ku publiku të mund të informohet për provat shkencore, ku si politikë-bërësit ashtu edhe shtetasit mund të bëjnë përzgjedhjen brënda gamës së mundësive të paraqitura nga progresi teknologjik.

**Plotësojnë kushtet:**
Organizatat, roli kryesor i të cilave është ofrimi i këshillimit shkencor për politikë-bërësit, departamentet e ndihmës shkencore, këshillat e etikës kombëtare dhe organizatat kombëtare dhe rajonale që punojnë në fushën shkencore dhe kanë përvojë në mundësimin e pjesëmarrjes së publikut.

**Kontaktoni:** Ms Viviane VANDERHOUDELINGEN
European Commission, Directorate-General
Research
Unit 5 (Information and communication)
Tel + 32 2 298 7323
Fax + 32 2 295 8220
E-mail rtd-sciencesociety@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://www.cordis.lu/science-society/home.html

## **08 08 01 03** – Masat specifike në mbështetje të bashkëpunimit ndërkombëtar

**Buxheti i dhënë:** 96.29 milion

Qëllimi i këtyre masave i drejtohet Fushës së Kërkimeve Evropiane për botën në kuadër të katër drejtimeve parësore tematike. Projektet duhet të kontribuojnë në krijimin e njohurive dhe ekspertizës

mbi bazën e përmirësimit të bashkëpunimit rajonal; trajtimin e koncepteve për një zhvillim të qëndrueshëm; dhe përmirësimin e novacionit shoqeror .

**Plotësojnë kushtet:**
Kërkuesit shkencorë, grupet dhe institucionet nga vendet e treta të përfshira në projekte të shtatë prioriteteve të Fushave Tematike të Kërkimit (për të parë se cilat janë ju lutemi referojuni faqes së internetit), dhe pjesëmarrësit nga organizatat ndërkombëtare.

**Zona e financimit:**
Vendet e Mesdheut dhe jo-anëtare të BE-së, vendet në Ballkanin perëndimor, Rusi dhe Shtetet e CIS si dhe vendet në zhvillim.

**Kontaktoni:** Ms Nicole RIVEILL
European Commission, Directorate-General
Research – N2
Rue de Gèneve 1, B – 1140 Brussels
Tel +32 2 299 4204
Fax +32 2 296 6252
E-mail inco@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://cordis.europa.eu.int/inco/home_en.html

## **08 08 01 01** – Mbështetja e politikave dhe parashikimi i nevojave tekonlogjike dhe shkencore

**Buxheti i dhënë:** 117.29 milion

Kjo linjë buxheti synon zhvillimin e aktiviteteve shkencore në mbështetje të politikave të Komunitetit dhe ngritjen e kapaciteteve për fillimin e aktiviteteve kërkimore sa më shpejt, për t'iu përgjigjur nevojave të paparashikuara. Një pjesë e tij mbështet: politikat e përbashkëta bujqësore dhe politikat e përbashkëta të zonave të peshkimit; zhvillimin e qëndrueshëm, veçanërisht të mjedisit, transportit dhe energjisë; politika të tjera të Komunitetit si shëndeti, tregëtia, zhvillimi, ndihma, edukimi, kultura etj; dhe objektivat e politikës në fusha si ajo ekonomike, informimi i shoqërisë, Evropa elektronike dhe e e biznesit

**Plotësojnë kushtet:**
Kërkuesit shkencorë, institutet e ngritura në Shtetet Anëtare dhe vendet kandidate të Bashkimit Evropian, organizatat ndërkombëtare dhe pjesëmarrësit nga vendet e treta. Megjithatë thirrjet për projekte mund të specifikojnë rregullat për pjesëmarrësit.

**Zona e financimit:**
Shtetet Anëtare dhe vendet kandidate të Bashkimit Evropian.

**Kontaktoni:**
Mr William CANNEL (Head of Unit)
European Commission, Directorate-General
Research – B1
Anticipation of scientific and technological needs
Tel +32 2 296 0952
Fax +32 2 299 3173
E-mail rtd-nest@cec.eu.int

# Fondet Strukturore dhe Fondi i Kohezionit

Qëllimi kryesor i këtij kapitulli është t'ju jap OJQ-ve informacionin e duhur në lidhje me fondet e ndryshme Evropiane nga të dy pikëpamjet, teorike dhe praktike. Në fakt të dy aspektet janë thelbësore për OJQ-të, fillimisht për të gjetur rrugën e tyre në labirintin e mundësive të financimit nga BE (si të zgjedhësh ato më të mirat dhe më të përshtatshmet) dhe së dyti të përgatisë një zbatim frytdhënës dhe të suksesshëm. Nga ana tjetër në momentin që flasim shumë faktorë ekonomik dhe politikë po ushtrojnë trysni të madhe në zhvillimet e lidhura me politikat e rajonale të BE-së. Një vështirësi e veçantë që lidhet me përpilimin e këtij udhëzuesi është periudha e tij kohore. Në fakt periudha e re kohore (.2007-2013) po vjen së shpejti dhe rregulla të reja po paraqiten, periudha e tanishme kohore ( 2000-2006) është ende në vazhdim. Kështu që, ky kapitull do të përpiqet të kapë tiparet më të rëndësishme të faktorëve aktual dhe gjithashtu të zhvillimeve të së ardhmes, në mënyrë që të ofrojë ndihmë praktike për OJQ-të me dëshirën për tu përfshirë në programet e financuara nga BE. Megjithatë duhet të theksohet që periudha prej 2006-ës duhet të shihet si fazë tranzitare dhe më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet tashmë perjudhës së re kohore (2007-13) dhe zhvillimeve në të ardhmen dhe OJQ-ët që kërkojnë financime nga Fondet Strukturore duhet të shqyrtojnë programet nën fondet e reja. Megjithëse programet e vjetra janë ende duke vazhduar, Vendet Anëtare kanë shumë mundësi të kenë ide të qarta se

si t'i shpenzojnë fondet e vlefshme nën roundin tjetër dhe pavarësisht nga mungesa e marrëveshjes zyrtare për objektivat e fondeve të reja, propozimet aktuale shërbejnë më mirë se treguesit e mirë të politikës të 2007-13.

Së pari ky kapitull do të shqyrtojë shkurtimisht evolimin e politikës rajonale të BE-së dhe do të nënvizojë zhvillimet më të rëndësishme të cilat , siç u theksua më parë po ushtrojnë trysni në politikat Evropiane të kohezionit. Pas këtij paragrafi hyrës parimet e përgjithshme kryesore te përpilimit të politikës në fushën e Fondeve Strukturore do te jenë skicuar, të ndjekura nga më shumë parime fuksionuese të detajuara. Së dyti Fondet Strukturore dhe Fondet e Kohezionit do të shqyrtohen të ndara në fonde të vjetra (2000-6) dhe të reja (2007-13). Këtu përqëndrimi është në vetë instrumentet e politikës së Kohezionit dhe objektivat që drejtojnë fuksionimin e këtyre instrumentëve. Gjithashtu janë të paraqitura Programe Iniciuese të Komunitetit dhe veprimet Novatore. Së fundmi jepet një përmbledhje (në formën e nje pasqyre krahasuese) e ndryshimeve përsa u përket objektivave dhe mjeteve midis të dy periudhave të programimit, e ndjekur nga burimet e mëtejshme të informacionit dhe pikat e kontaktit.

## 4.1 POLITIKA E BE PËR KOHEZIONIN SHOQEROR, EKONOMIK DHE TERRITORIAL

### 4.1.1 TË PËRGJITHSHME

Hyrja e Marrëveshjes së themelimit të Komunitetit Evropian ( e njohur gjithashtu si Traktati i Romës dhe e nënshkruar më 1957 nga të gjashtët Francë, Gjerman, Itali, Belgjikë, Norvegji Luksemburgu) bëri thirrje për fuqizimin e ekonomisë evropiane dhe sigurimit të zhvillimt të tyre harmonik duke zvogëluar ndryshimet egzistuese ndërmjet rajoneve të ndryshme dhe prapambetjen e rajoneve më pak të privilegjuara. Kështu që zhvillimi ekonomik i rajoneve më pak të privilegjuara të Bashkimit ka qenë gjithmonë një çështje e rëndësishme në planin e punës së Komunitetit edhe pse me qëllime dhe fokus të ndryshëm në kohë të ndryshme. Me fjalë të përgjithshme mund të jetë e diskutueshme që politika Evropiane rajonale duke ju nënshtruar një numri të madh ndryshimesh nëpër vite (të cilat ristrukturuan thelbësisht dhënien dhe administrimin e fondeve) ka ev-

oluar nga një politikë e rishpërndarë dhe e pagesës së një anëshme në një lloj të poltikës më aktive dhe dinamike që synon përforcimin e kapitalit njerëzor dhe fizik në rajonet më të varfra të Bashkimit.

Megjithatë, duket se po ndodhin më shumë transformime. Në fakt shumë zhvillime brenda Bashkimit po u japin formë pjesës më të madhe të politkave të tij dhe politika rajonale është njëra prej tyre. Dy proçeset më të rëndësishëm që ndikojnë aktualisht politikën rajonale janë Zgjerimi dhe zbatimi i strategjisë së Lisbonës.

## Zgjerimi

Siç është theksuar në Raportin e Tretë të Kohezionit të Komisionit, zgjerimi e ka rritur GDP-në e BE-së me 5% ndërsa ka shtuar popullësinë e Bashkimit me pothuajse 20%. Si rrjedhojë GDP-ja mesatare për frymë ne BE 25 është 12.5% më e ulët se GDP-ja mesatare për BE15. Kështu që zgjerimi jo vetëm që ka shtuar më tej mosbarazinë rajonale brenda BE-së, por ka bërë gjthashtu si të papërshtatshme rajonet e dobëta që më parë merrnin fonde nga BE. Sidoqoftë mbështetja tranzicionale për rajone të tilla është deri në fund të vitit 2006

## Strategjia e Lisbonës

Strategjia e Lisbonës, arritur në Mars të vitit 2000 nga Kryetarët e Shteteve dhe Qeverive të BE-së është plani i arritjes deri ne 2010 të një ekonomie evropiane të suksesshme dhe konkuruese të bazuar në njohuri.
Sipas Komisionit, njohuritë dhe përdorimi i tyre përfaqësojnë forcën shtyse të rritjes së ekonomive të zhvilluara. Veç kësaj në Shkurt të vitit 2005 Komisioni paraqiti një startegji të shqyrtuar për BE-në për të krijuar më shumë rritje ekonomike dhe vende pune, për të përkrahur qëllimet e Lisbonës dhe të Gothenburgut (zhvillimi i qëndrueshëm). Kështu që të gjitha dimesionet e politikës evropiane të kohezionit duhet të konsiderohen si një pjesë përbërëse e strategjisë së Lisbonës. Për më tepër që politika e kohezionit të jetë efektive dhe të maksimizoj vlerat e saj duhet që të përqëndrojë investimet në vetëm disa prioritete[19] të Komunitetit, dhë është e qartë se këto

19 Shiko në faqet xxvii dhe 50 të Raportit të Tretë Të Kohezionit, Komisioni Evropian, "Një Partneritet i Ri për Kohezionin: konveregjencë, konkurencë dhe bashkëpunim", shkurt 2004. Raporti mund të shkarkohet nga faqja elektronike

prioritete rrjedhin drejtëpërsëdrejti nga propozimet e programeve të reja të qëllimeve të Lisbonës. Prioriteti dhënë këtyre qëllimeve që janë qartësisht të dëshirueshme duhet të kihet parasysh, që niveli i kohezionit dhe mbrojtjes mjedisore që Bashkimi po përpiqet të sigurojë nëpërmjet fondeve strukturore nuk duhet të bëhen thjesht qëllime dytësore të politikës së kohezionit.

## Ridhënia formë e politikës së Kohezionit të BE-së

Zhvillimi i këtyre dy proçeseve thelbësore po ushtrojnë një ristrukturim të rëndësishëm dhe riformim të politikës evropiane të kohezionit, e cila në të ardhme do të duhet të bëjë ndryshimin midis sfidave të reja të ndryshimit dhe rënies së fondeve në të njëjtën kohë. Siç është përmendur në kapitullin 1, pavarësisht nga nevojat për rritje dhe zgjerim të BE-së, propozimi i Komisionit për Prespektivat Financiare 2007-2013 mbajti shpenzimet e Komunitetit poshtë kufirit maksimal 1.24% GDP. Në shumë raste zyrtarë të Komisioneve ( dhe veçanërisht vetë Komisionerët) kanë theksuar rëndësinë e ruajtjes së atij kufiri maksimal,që Evropa të jetë në gjendje të arrijë shumë prej objektivave të saj, ku një Evropë më kohezive është vetëm një prej tyre. Sidoqoftë Këshilli i Dhjetorit të vitit 2005 ra dakort për Prespektivat Financiare 2007-13 (siç u vendos në Dokumentin 15915/05) dhe kështu zvogëloi kufirin maksimal vetëm në 1.045%. Parlamenti evropian nga ana tjetër donte të shtonte 12 billion 862.4 bilionëve të rëna dakort nga Këshilli por negociatat ndërmjet ekipit negociues Parlamentar dhe përfaqësuesve të Komisionit e Këshillit (4.4.2006) çuan drejt marrëveshjes për një rritje prej vetëm 4 bilion eurosh nga ana e Parlamentit. Këto 4 bilionë do t'iu akordohen kryesisht politikave që lidhen me strategjinë e Lisbonës, siç janë kërkimi, përtëritja dhe rrjetet trans-Europiane. Në përputhje me rrethanat, akordimet për fondet strukturore dhe Fondi i Bashkimit për periudhën 2007-13 arrijnë shumën prej 307.6 bilion (Marrëveshje e Këshillit) plus një shtesë prej 0.3 bilioni siç është negociuar me Parlamentin, pra 307.9 bilionë euro nga i gjithë buxheti prej 866.4, një numër më i vogël se sa 336.1 bilionët e propozuar fillimisht nga Komisioni.

Rregullatoret për Fondet Strukturore do të zbatojnë me përpikmëri dhe do t'iu përshtaten rezultateve të negocimeve mbi Perspektivën

e mëposhtëme: http://europa.eu.int/comm/regional_policy/sources/docoffic/official/reports/cohesion3/cohesion3_en.htm

Financiare. (COM(2004) 487 versioni përfundimtar).Megjithatë, përfundimet e këtyre negociatave nuk janë ende të qarta. Nga një këndvështrim praktik, kufiri maksimal i ri financiar në çdo rast do të përkthehet si reduktim i burimeve në dispozicion të çdo vendi dhe rajoni, meqenëse jo vetëm ka më pak para në dispozicion, por gjithashtu, me zgjerimin, ka pasur një rritje të numrit të rajoneve në nevojë të ndërhyrjeve strukturore dhe një rritje të shumëllojshmërisë së problemeve sociale dhe ekonomike. Pra edhe nevojë për një zbatim më të decentralizuar, transparent dhe efikas.

### 4.1.2 PROGRAMIMI DHE PARIMET KRYESORE

Aktualisht, arkitektura e Fondeve Strukturore është e bazuar në një set parimesh kryesore të formuluara nga Rregullorja e Këshillit Nr. 1260/1999. Në shkurt 2004, Komisioni miratoi Raportin e Tretë të Bashkimit [COM(2004)107], që është një dokument politikash i dalë nga eksperienca e kaluar dhe propozimet për të ardhmen. Në lidhje me këtë raport dhe komunikimin e tij në perspektivën e ardhshme financiare (2007-13) Komisioni nxorri një propozim për një Rregullore të re për Fondet Strukturore (COM(2004) 492 versioni final), i cili paraqet një numër ndryshimesh dhe thjeshtimesh. Sapo të miratohet nga Komisioni dhe Parlamenti, Rregullatori do të bëhet ligj. Ndryshe nga më përpara, draft-Rregullorja për periudhën 2007-13 u ndoq nga drafti i Udhezimeve për Komunitetin [COM(2005)0299], që ekspozonte objektivat e përgjithshme të programimit të Fondeve Strukturore për periudhën e re.
Shpenzimi i Fondit Strukturor nga Vendet Anëtare funksionon brenda kuadrit të politikave dhe objektivave të parashikuara në këto dokumenta. Për periudhën 2000-6 çdo vend anëtar hartoi një Plan Kombëtar Zhvillimi ose një dokument ekuivalent ku tregonin qëllimet e tyre për mënyrën se si do t'i përdornin fondet që u ishin akorduar. Pas kësaj u bënë negociatat ndërmjet Vendit Anëtar dhe Komisionit, që çuan drejt një dokumenti zyrtar dhe të detajuar me udhëzime specifike për mënyrën se si duhet të përdoreshin fondet. (Kuadri i Mbështetjes së Komunitetit ose Dokumenti i Programimit më Vete) Sidoqoftë, për periudhën 2000-3, procesi u bë më i drejtpërdrejtë bazuar në nevojën për të thjeshtuar aspekte të ndryshme të fazave menaxhuese dhe planifikuese. Tani, çdo Vend Anëtar do të përcaktojë strategjinë e vet për zbatimin e Fondeve Strukturore në një dokument politik (Kuadri i Referencave te Strategjive Kombëtare). Kuadre të

tilla do të përgatiten nga secili Vend Anëtar në bazë të Udhëzimeve Strategjike për Komunitetin, sipas strukturës së vet institucionale dhe në bashkëpunim të ngushtë me partnerët (siç përcaktohet në parimin e partneritetit). Për të zbatuar objektivat strategjike të përcaktuara në Kuadrin e Referencave Strategjike Kombëtare, vendet anëtare do t'i prezantojnë Komisionit për miratim programe fuksionale kombëtare dhe rajonale dhe plotësuesit e programimit do të zhduken. Prandaj, numri i hapave të programimit do të reduktohet dhe përjegjësitë do të jenë më të decentralizuara për shkak se do të ketë më përfshirje të drejtpërdrejtë të vetë Komisionit në fazat e zbatimit.

Duhet të theksohet gjithashtu, në këtë fazë, se marrdhëniet ndërmjet Komisionit dhe Vendeve Anëtare në vënien në zbatim të politikës së Bashkimit jane të nënshtruara nga **parimi i vartësisë**. Ky parim u prezantua në Traktatin e Maastricht-it dhe nënkupton se: "Në zonat të cilat nuk janë brënda kompetencës së vet ekskluzive, Komuniteti do të veprojë, në përputhje me parimin e vartësisë, vetëm nëse dhe për aq sa objektivat e veprimit të propozuar nuk mund të arrihen mjaftueshëm nga Vendet Anëtare dhe si pasojë, për shkak të përshkallëzimit ose të veprimit të propozuar mund të arrihen më mirë nga Komuniteti." Një rrjedhojë e menjëhershme e kësaj është se është në dorë të autoriteteve menaxhuese të caktuara nga vendet anëtare, të përzgjedhin projektet që do të financohen e monitorohen dhe vlerësuar zbatimin e tyre.

**Autoritet Menaxhues** është çdo organizëm publik apo privat në nivel vendor, rajonal apo kombëtar i caktuar nga Vendi Anëtar për të menaxhuar ndihmën e dhënë nëpërmjer Fondit Strukturuor. Përgjegjësitë e tij përfshijnë informimin për përfitime të mundshme, monitorimin, sigurimin e sigurtë dhe në kohë të zbatimit financiar, drejtimin e vlerësimeve dhe pajtimin me të gjitha detyrimet e aplikueshme përsa i përket publicitetit dhe ligjit të komunitetit. Në këtë mënyrë, programet zbatohen nga autoritetet kombëtare/rajonale/lokale dhe mbikqyren rregullisht nga Komisione Monitoruese. S'është e nevojshme të thuhet që këto autoritete sigurojnë një burim të rëndësishëm informacioni mbi programe të detajuara rajonale apo për një vend të caktuar dhe ndihmojnë OJQ-të e interesuara në përfshirje. Ju lutemi kontrolloni: http://europa.eu.int/comm/regional_policy/manage/authority/authority_en.cfm për hollesi mbi kontaktimin e të gjitha Autoriteteve Menaxhuese.

**Komisionet Monitoruese** duhet të ngrihen nga çdo Vend Anëtar, në marrëveshje me Autoritetet Menaxhuese pas konsultimit me partnerët. Ato përbëhen nga përfaqësues rajonesh, Vende Anëtare, trupa të tjerë përgjegjës dhe Komisioni, ky i fundit me kompetenca këshilluese. Komisionet mbikqyrin zbatimin, konfirmimin apo rregullimin e strategjive të programeve, në qoftë se lind nevoja, marrin në konsideratë dhe miratojnë kriteret për zgjedhjen e operacioneve të bashkë-financuara dhe ekzaminojnë rezultatet dhe arritjet e zbatimit.[20]

## Parimet Bazë 2007-13

Këto rrjedhin nga parimet bazë të 2000-6 por, ashtu siç edhe parashikohet për një numër modifikimesh në Rregulloren e propozuar për periudhën e ardhshme të programimit, do të ketë ndryshime edhe në parimet e vjetra bazë. Megjithëse nuk duhet harruar që për këto rregulla të reja është ende duke u negociuar, është interesante t'u kushtohet vëmendje të paktën ndryshimeve më domethënëse të propozuara.

- **Përqendrimi:** Kjo nënkupton përqendrimin e masave në objektivat parësore, e cila sjell një përqëndrim gjeografik sipas pranueshmërisë së secilës masë dhe të cilat llogaritin si nevojat kombëtare e rajonale, ashtu dhe prioritetet e Komunitetit. Kjo duhet të inkurajojë një përqasje të integruar për zhvillimin në vend të thjesht një copëzimi operacionesh. Megjithëse thelbi i këtij parimi do të ndryshojë në parim i pandryshuar (pra, përqendrimi gjeografik i rajoneve më të varfëra të Vendeve Anëtare), Komisioni parashikon një theks të veçantë në Vendet e reja Anëtare dhe gjithashtu parashikon se Fondet duhet më tej të përqendrohen në prioritetet e Lisbonës dhe Gothenburgut, në "rajonet konvergjente" (pra, objektivi 1 rajonet)dhe në ndërtimin e kapacitetit institucional. Për më tepër, braktisja e mikro-zonave në favor të përcaktimit të formave gjeografike dhe të tjera forma përqendrimi gjatë hartimit të programeve rajonale, do të lejojnë fleksibilitetin dhe përshtatshmërinë kuptimplotë të Fondeve.

20 Rezoluta e Këshillit .Nr. 1260/1999, neni 34 — Shikoni gjithashtu: Rregullatori i Komisionit (EC) Nr 438/2001 i 2 Marsit 2001 formulon rregulla të detajuara për zbatimin e Rregullatorit të Këshillitl (EC) No 1260/1999 për sa i përket sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit për asistencë të akorduar nga Fondet Strukturore , I mundshëm në: http://europa.eu.int/eur-lex/pri/en/oj/dat/2001/l_063/l_06320010303en00210043.pdf

- **Programimi:** Organizimi, vendim-marrja dhe procesi financiar kryhen në një numër etapash zbatimi të veprimit të përbashkët të Komunitetit me Vendet Anëtare (me përfshirjen e nivelit gjeografik nën-kombëtar parë nga Vendi Anëtar i interesuar si më i përshtatshmi). Për këtë qëllim të caktuar, Komisioni parashikon një thjeshtim domethënës si në nivelin politik dhe në atë operacional me më pak përfshirje të nivelit të BE-së në hollësitë e menaxhimit aktual.

- **Partneriteti:** Ky parim ka si synim arritjen e bashkëpunimit më të afërt të mundshëm në çdo shtet ndërmjet Komisionit dhe autoritetit të përshtatshëm në nivel kombëtar, rajonal apo lokal, përfshirë partnerët ekonomikë sdhe socialë të caktuar nga secili Vend Anëtar nga faza përgatitore deri në atë zbatuese. Metoda e partneritetit është pjesë vitale e Fondit Strukturor. Një zgjerim progresiv i partneritetit filloi në 1989 kur u zgjerua për të përfshirë autoritetet rajonale dhe lokale. Progres i mëtejshëm është bërë gjatë periudhës së programimit 1994-1999, kur partnerët socialë u ftuan hapur për të marrë pjesë. Përfundimisht, në 1999, partneriteti u zgjerua me organizata të tjera të përshtatshme, përfshirë këtu edhe ato që punonin për mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e barazisë ndërmjet burrave dhe grave. Ky ndryshim u hap dyert Sektorit te Tretë dhe në veçanti OJQ-ve të marrin pjesë në programimin dhe zbatimit e Fondeve Strukturore në Vendet aktuale Anëtare, dhe ka rëndësi të veçantë gjithashtu edhe për organizata brenda Vendeve Anëtare.

    » Për arsyen pse Komisioni Europian mbështet metodën e partneritetit mund të jepen disa shpjegime. Së pari, Komisioni synon të përtërijë qeverisjen shumë-nivelëshe me qëllim që të arrijë një përfshirje më të gjerë në formimin e politikave dhe hapje e transparencë më të madhe në të gjitha nivelet. Një dialog më i gjerë ndërmjet Komisionit, Vendeve Anëtare dhe autoriteteve rajonale/lokale gjithashtu do të siguronte një koherencë të përgjithshme politikash e legjislacioni , p.sh. energjetikë, transport, mjedis, etj në të gjitha nivelet. Një partneritet i fortë dhe i përkushtuar lokal apo rajonal ndihmon në mobilizimin e burimeve materiale dhe jomateriale, dhe përshtatjen e politikave dhe veprimeve për t'iu përgjigjur me mirë nevojave territoriale.Si rrjedhojë, puna në partneritete do të kontribuonte për një bërje politikash demokratike

dhe zbatim programi. Prandaj parimi i partneritetit është i një vlere qëndrore për nocionin e qeverisjes shumë-nivelëshe në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e programeve. Nga ana tjetër, duhet theksuar se sipas parimit të varësisë, secili nga Vendet Anëtare është përgjegjës për vënien në jetë të parimit të partneritetit në nivel kombëtar. Kështu, niveli i hapjes drejt shoqërisë civile dhe niveli rezultues i pjesëmarrjes së OJQ-ve variojnë në mënyrë të konsiderueshme nga shteti në shtet dhe gjithashtu edhe në varësi të temës së projektit, për shembull parimi i partneritetit është në përgjithësi më i zhvilluar për programet e zhvillimit rural se sa për projektet urbane.

» Ndryshimet e propozuara për Parimin e Partneritetit janë sigurisht risija më e rëndësishme, të pakten përsa u përket OJQ-ve. Raporti i Tretë i Bashkimit kërkon më shumë përfshirje të shoqërisë civile në skicimin, zbatimin dhe ndjekjen e operacioneve të Fondit Strukturor. Për më tepër, Udhezimet Strategjike theksojnë rolin e partneritetit në formulimin e zbatimin e startegjive të zhvillimit, dhe qartësisht përmendin rolin e OJQ-ve brenda partneriteteve. Më e rëndësishmja, OJQ-të janë gjithashtu të përfshira në përcaktimin e partnerëve në Draftin e Rregullatorit të Përgjithshëm (Neni 10). Në fakt, kjo është hera e parë që OJQ-të do të njiheshin zyrtarisht si partnerë në lidhje me Fondet Strukturore, një lëvizje që sigurisht u mirëprit nga OJQ-të dhe shoqëria civile më gjerë. Megjithatë, Neni 10 i draft-Rregullatorit po has tashmë vështirësi në Këshill, i cili në tekstin e kompromisit të 21.12.2005 e dobëson nenin në mënyrë të konsiderueshme duke e bërë partneritetin fakultativ në vend të të detyrueshëm, siç është tani, dhe redukton mundësitë e pjesëmarrjes së vërtetë të OJQ-ve duke hequr listën e partnerëve (përfshirë këtu dhe referencën për OJQ-të) siç është përcaktuar në propozimin origjinal të Komisionit. Parimi i partneritetit nuk është çelësi i vetëm i shpërndarjes së sukseshme të politikës bashkuese (siç është theksuar nga Komisioni në vlerësimin e parimit të 2005-ës) por gjithashtu shpesh është edhe mënyra e vetme që kanë OJQ-të për të marrë pjësë në këto projekte, çka është ndër arsyet pse SHAQ i është bashkuar OJQ-ve të tjera të ndryshme sociale dhe mjedisore në një koalicion të gjerë për të parashtruar një deklaratë të përbashkët të OJQ-ve mbi Rregulloren e Përgjithshme

të Fondeve Strukturore dhe Kohezive në mbështetje të propozimit origjinal të Komisionit.

» Parimi i partneritetit është sidoqoftë i një vlere thelbësore për OJQ-të që dëshirojnë të përfshihen në projekte të financuara nga Fondet Strukturore, veçanërisht projekte ndërkombëtare. Është e rëndësishme të mësohet të bashkepunohet me partnerë nga sektorë të ndryshëm të niveleve të ndryshme. Aktualisht shumë projekte të këtyre fondeve janë shpesh të një dimensioni të tillë teknik e financiar saqë është e vështirë për një OJQ të vetme ta vëjë në zbatim atë e vetme falë mungesës së burimeve dhe mbështëtjës institucionale. Shihni Kapitullin 1 për këshilla të përgjithshme mbi ndërtimin e partneritetit.

- **Për më tëpër:** Që të arrihet një ndikim i pastër ekonomik, Fondet nuk mund të zëvendësojnë shpenzimet publike apo shpenzimet të tjera strukturore ekuivalente nga Vendi Anëtar. Për këtë arsye, si rregull i pergjithshem, Vendet Anëtare duhet të mirëmbajnë nivelin e shpenzimit për çdo objektiv në jo më pak se sa niveli i përfituar gjatë periudhës së mëparshme të programimit dhe ky nivel do të përcaktohet në dritën e rrethanave të përgjithshme makroekonomike gjatë së cilave ndodh financimi. Ky parim nuk është modifikuar.

## 4.2 FONDET STRUKTURORE DHE FONDI I KOHEZIONIT

### 4.2.1 FONDET STRUKTURORE DHE FONDI I KOHEZIONIT 2000-2006

Fondet strukturore akordohen nëpërmjet instrumentave të ndryshme, sipas objektivave të ndryshëm. Aktualisht ka katër Fonde Strukturore:

- Fondi Evropian për Zhvillim Rajonal (ERDF)
- Fondi Evropian Social (ESF)
- Instrumentat Financiarë për Udhëzim Peshkimi (FIFG)
- Fondi i Sektorit të Drejtimit të Udhëzimit dhe Grancisë Evropiane Bujqësore (EAGGF-Guidance section).

Instrumenti i pestë i politikave të bashkimit të BE-së është Fondi i Kohezionit.

Në përcaktimin e zonave të përshtatshme për ndërhyrje nga ana e Komunitetit, përdoret Nomenklatura e Njësive Statistikore Territoriale (NUTS). Për të parë cilës zonë të përshtatshme i përket territori yt, si dhe për më tepër informacion mbi fondet në dispozicion të siguruara nga Komuniteti në kuadër të Fondeve Strukturore dhe (nqs aplikohet) Fondit të Kohezionit, mund të konsultoheni me faqen e mëposhtme:
http://europa.eu.int/comm/regional_policy/index_en.htm

### 4.2.1.1 Instrumentat

*Fondi Evropian për Zhvillim Rajonal (ERDF)*[21]

ERDF administrohet nga DG Drejtoria e Përgjithshme e Politikës Rajonale dhe kontribuon në promovimin e kohezionit ekonomik e social duke korrigjuar mosbalancimet kryesore rajonale dhe pjesëmarrjen në zhvillimin dhe shndërrimin e rajoneve. Në këtë aspekt, ERDF gjithashtu kontribuon në promovimin e zhvillimit e pandërprerë dhe krijimin e punëve mbështetëse. ERDF mbështet në veçanti:

- Investime produktive për të krijuar punë të përhershme të mbrojtura,
- Investimet në infrastrukturë,
- Zhvillim endogjen(zhvillim lokal, iniciativa punësimi dhe aktivitete të SME-ve)
- Investime të lidhura me krijimin e një ambienti konkurues dhe mbështetës për SME-të),
- Kërkim dhe zhvillim teknologjik,
- Zhvillim të shoqërisë së informacionit
- Zhvillim të turizmit dhe investimeve kulturore
- Asistencë teknike në mbështetje të objektivave 1 dhe 2

*Fondi europian social (ESF)*[22]

ESF administrohet nga Punësimi dhe Çështjet Sociale të Drejtorisë së Përgjithshme (DG)dhe mbështet masat për parandalimin dhe luftimin e papunësisë dhe zhvillimin e burimeve njerëzore dhe integrimin shoqëror në tregun e punës me qëllim të promovojë një

21 Reg. Nr.1783/1999 I Parlamentit Europian dhe Këshillit

22 Reg. Nr.1784/1999 i Parlamentit Europian dhe Këshillit

nivel të lartë punësimi, barazi ndërmjet burrave dhe grave, zhvilli mbështetës dhe kohezioni ekonomik e shoqëror. ESF në veçanti kontrinuon në veprimet e ndërmarra në ndjekje të Strategjisë Europiane të Punësimit dhe Udhëzimet Vjetore për Punësimin. Masat e financuara nga ESF plotësojne politikat kombëtare të punesimit dhe vetë Shtetet Anëtare identifikojnë mënyrat më të mira në të cilat financimi i ESF përdoret për të përmirësuar punësimin kombëtar dhe politikat e burimeve njerëzore në një linjë me strategjitë Evropiane të Punësimit..[23]

Shtetet Anëtare mund të vendosin për prioritetet e tyre, i vetmi kufizim është se duhet të promovojnë aktivitete brenda këtyre 5 fushave të politikave:

- Zhvillimi dhe promovimi i politikave të tregut aktiv të punës për të luftuar dhe parandaluar papunësinë dhe për të mbështetur integrimin e të rinjve dhe personave që i kthehen tregut të punës pas një periudhe mungese;
- Promovimi i përfshirjes shoqërore dhe mundësive të barabarta për të gjithë në mundësitë për hyrje në tregun e punës;24
- Zhvillimi i sistemeve të arsimimit, trajnimit dhe këshillimit si pjesë e një politike të të mësuarit gjatë gjithë jetës për të shtuar dhe mbështetur punësimin, lëvizshmërinë dhe integrimin;
- Përmirësimi i sistemeve për të promovuar një forcë punëtore të aftë, të trajnuar dhe të adoptueshme, për të edukuar risitë dhe përshtatshmërinë në organizimin e punës, për të mbështetur sipërmarrjen dhe krijimin e punësimit dhe për të përkrahur potencialin njerëzor në kërkim, shkencë dhe teknologji;
- Promovimi i arritjes më të gjerë dhe pjesëmarrja e grave në tregun e punës.

### *Fondi i sektorit të drejtimit të udhëzimit dhe garancisë evropiane bujqësore (EAGGF- sektori i udhëzimeve)*

EAGGF- Sektori I Udhëzimeve administrohet nga Politika Bujqësore e Drejtorisë së Përgjithshme (DG) dhe promovon rregullimin e strukturave bujqësore dhe masave të zhvillimit rural. EAGGF promovon masa:

- Mbështetje të të ardhurave të fërmave dhe mirëmbajtjen e komu-

23 Vendet Anëtare vazhdojnë të mbajnë përgjegjësi të plotë për papunësinë

24 Zhvillimi lokal i punësimit përforcohet nëpërmjet programeve të ndryshme në nivel Komuniteti dhe Shteti Anëtar

niteteve fermere të shëndetshme
- Mbështetje fillestare për fermerë të rinj
- Përmirësimin e efikasitetit strukturor të pronave
- Inkurajimin e themelimit të shoqatave të prodhuesve
- Shndërrim, shumëfishim, riorientim dhe përmirësim të cilësisë së prodhimit bujqësor
- Zhvillimin e infrastrukturës rurale
- Inkurajimin e investimeve në turizëm
- Masa të tjera, siç janë: parandalimi i fatkeqësive natyrore, ripërtëritje e fshatit, mbrojtje e trashëgimnisë rurale, zhvillim dhe përdorim i zonave pyjore, mbrojtje e mjedisit dhe e fshatit, si dhe financimi i inxhinierisë.

*Instrumentat Financiarë për Udhëzim Peshkimi (FIFG)[25]*

FIFG administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme (DG) e Politikës së Peshkimit dhe masat e saj strukturore i janë dedikuar sektorit të peshkimit dhe kulturës ujore dhe përpunimit e tregtimit të produkteve të tyre. Masa të përshtatshme janë kryesisht ato të përqëndruara në:

- Promovimin e përtëritjes dhe modernizimit të enëve të peshkimit,
- Rregullimin e përpjekjes së peshkimit,
- Masa sociale-ekonomike,
- Mbrojtjen e burimeve detare në ujëra bregdetarë,
- Kultura ujore
- Përpunimi dhe tregtimi i peshkut dhe prodhimeve të kulturës ujore,
- Ndërprerje të përkohshme të aktiviteteve dhe kompensime të tjera financiare.

*Fondi i Kohezionit*

Fondi i Kohezionitt është i ndarë nga Fondi Strukturor, pavarësisht nga objektivat e përbashkëta.[26] Financon projekte në lidhje me mjedisin dhe rrjetet e transportit trans-Europiane në Vëndet Anëtare, Prodhimi i Përgjithshëm Bruto i të cilave për frymë është nën 90% të mesatares së Komunitetit. Deri më 1.1.2000 Spanja, Greqia, Portu-

25 Reg e Këshillit. Nr.1263/1999c.

26 | Reg Kèshillit. Nr. 1264/1999.

galia dhe Irlanda ishin të përshtatshmë për Fondin e Bashkimit por Irlanda (me një GDP 101%) u mendua të ishte e papërshtatshme nga 1.1.2004. Megjithatë, pas zgjerimit të 2004-ës, të gjitha Shtetet e reja Anëtare u bënë përfituese të Fondit. Për zonat e prioritetit të veçantë dhe objektivat për 2004-6 u ra dakort nga Komisioni Evropian me secilin nga Shtetet e reja Anëtare se është e rëndësishme që OJQ-të të kenë dijeni të qartë të këtyre prioriteteve kur të aplikojnë për fonde. Në të njëjtën kohë, ky informacion do të jetë i vlefshëm për ato OJQ të Vendeve të Vjetra Anëtare që duan të futen në partneritet me OJQ të Vendeve të reja Anëtare brënda atyre zonave ku ka financim. 15.9 bilion euro janë akorduar për periudhën e programimit, nga të cilat më shumë se gjysma është e rezervuar për Vendet e reja Anëtare.

### 4.2.1.2 Objektivat

Për perjudhën e programimit 2000-2006, 195 billion € janë shpenzuar nëpërmjet Fondeve Strukturore të shpjeguara më lart për të arritur tre objektivat parësore të mëposhtëme:[27]

- Objektivi 1: Promovimi i zhvillimit dhe rregullimeve strukturore të rajoneve zhvillimi i të cilave është i prapambetur. Objektivi 1 zë 69.7% të Fondeve Strukturore (EUR 135.9 billion) dhe financon zhvillimin dhe rregullimet strukturore të rajoneve NUTS II ku mesatarja e GDP-së për kokë është më pak se 75% e mesatares së BE-së. Megjithkëtë mbulohen gjithashtu edhe zona me dendësi shumë të ulët popullësie dhe rajone periferike. Pas zgjerimit të gjithë ato rajone të cilat, për shkak të efekteve statistikore nuk do të pregatiten më për financime strukturore do të marrin mbështetje të përkohshme, "sinkronizohen " gjatë perjudhës tjetër programuese. ERDF është kontrbuesi kryesor i këtij objektivi.

- Objektivi 2: Mbështetja e shkëmbimeve ekonomike dhe sociale në zonat që përballen me vështirësi struktrurore. Objektivi 2 zë 11.5% të burimeve të Fondeve Strukturore (EUR 22.5 billion) dhe financohet nëpërmjet ERDF, ESF, dhe sektori i Garancisë EAGGF. Zonat e përshtatëshme janë ato me probleme strukturore, shkëmbimi so-

27 Reg. e Këshillit Nr.1260/1999, neni 1 – Shiko gjithashtu: Rregullorja e Komisionit (EC) Nr 438/2001 e 2 Mars 2001 parashtron rregullat e hollësishme për zbatimin e Rregullores së Komisionit (EC) Nr 1260/1999 në lidhje me administrimin dhe sistemet e kontrollit për ndihmesën e dhënë nën Fondet e Mundëshme Strukturore gjendet në: http://europa.eu.int/eur-lex/pri/en/oj/dat/2001/l_063/l_06320010303en00210043.pdf

cialo-ekonomik i të cilave ( sektorët industrial dhe të shërbimit, zonat rurale dhe ato urbane në vështirësi dhe zonat e shtypura të varura nga peshkimi) dhe popullata ose zona është mjaft i rëndësishëm. Pjesa më e madhe e Vendeve Anëtare,përfshi edhe më të pasurat kanë të drejtën e Objektivit 2.28 Zona të cilat nuk janë më të përshtatëshme për ndihmën e Komunitetit në këtë Objektiv, do të futen gradualisht në një perjudhë katër vjeçare. ERDF është kontribuesi kryesor i këtij objektivi.

- Objektivi 3: Mbështetja për përshtatjen dhe modernizimin e politikave dhe sistemeve të arsimimit, kualifikimt dhe punësimit. Objektivi 3 zë 12.3% të burimeve të Fondeve Strukturore (EUR 24.05 billion). Ky objektiv përfshin të gjtha zonat e pambuluara nga Objecktivat 1 or 2 dhe financohet vetëm nga ESF. Jep një kuadër politik të referencës për të siguruar kosistencë me të gjitha operacionet për burimet njerëzore, në një Vend Anëtarë të caktuar dhe identifikon marrëdhënien me përparësitë e vendosura në Planin Kombëtarë të Punësimit29. Duhet të thekësohet këtu se duke patur parsysh llojet e çështjeve të mbuluara, ky objektiv lidhet veçanërisht me OJQ-të. ESF është kontribuesi i vetëm i programeve të Objektivit 3.

### 4.2.1.3 Veprimtari të ndërmarra nga Komuniteti dhe Veprimtari Novatore

- INTERREG : qëllimi i përgjithshëm i këtij programi është të rrisë bashkëpunimin ndërmjet kombeve, kufijëve dhe rajoneve për të kontribuar në zhvillimin harmonik, të balancuar dhe të qëndrueshëm të të gjithë zonës së Komunitetit. Veprimet e promovuara përfshijnë: startegjitë e zhvillimt në një shkallë ndërkombëtare duke parë për promovim të zhvillimit policentrik dhe të qëndrueshëm; duke promovuar sisteme transporti efektive dhe të qëndrueshëme dhe duke promovuar ruajtjen e mjedisit dhe

28 Reg e Këshillit. Nr.1260/1999, neni 4 — Shiko gjithashtu: Reg e Komissionit (EC) Nr.438/2001 e 2 Mars 2001 parashtron rregulla të hollësishme të zbatimit të Rregullores së Këshillit(EC) Nr 1260/1999 në lidhje me administrimin dhe sistemet e kontrollit për ndihmesën e dhënë nën Fondet e Mundëshme Strukturore gjendet në : http://europa.eu.int/eur-lex/pri/en/oj/dat/2001/l_063/l_06320010303en00210043.pdf

29 Plani i pregatitur prej çdo Anëtari,çdo vit në kuadër të Strategjisë Evropiane të Punësimit, ku vendosen objektivat sasiore dhe cilësore të politikës së punësimit.

manaxhimin e mirë të burimeve natyrore ; Në këtë program ka tre shkallë:

**Shkalla A:** ( bashkëpunim përtej kufijëve) : Promovimi i zhvillimt rajonal të integruar ndërjet rajoneve fqinj kufitare-përfshirë kufijtë e jashtëm dhe disa kufijë detar – duke promovuar strategji të përbashkëta për zhvillim territorial të qëndrueshëm (duke inkurajuar shpirtin e bisnesit dhe zhvillimin e SMEs, duke promovuar integrimin e tregut të punës, mbrojtje të mjedisit, zhvillim të burimeve njerëzore, përmirësimin e transportit, etj).

**Shkalla B:** (bashkëpunim ndërmjet kombeve) : arritja e bashkëpunimt ndërmjet kombeve dhe kontribuimi për integrimin territorial përmes BE-së duke promovuar grupime të gjera të rajoneve evropiane të cilat mund të përfshihen në zhvillimin harmonik, të qëndrueshëm e të balancuar të Bashkimit Evropian.

**Shkalla C:** Përmirësimi i zhvillimit rajonal dhe politikave të kohezionit dhe teknikave, nëpërmjet bashkëpunimit ndërajonal në zona të tilla si hulumtimi, zhvillimi teknologjik, sipërmarrja, shoqëri informacioni, shkëmbime eksperiencash në fushën e turizmit, kulturës dhe ambjentit dhe si një vënie të mirë në praktikë.

- LEADER: Promovon zhvillimin rural nëpërmjet iniciativave të grupeve veprues vendase dhe synon të stimulojë masa novatore nëpërmjet tyre, qofshin këto publike ose private, të përfshira në nivel vendor në të gjithë sektorët e veprimtarisë vedase. Një theks i fuqishëm është vënë mbi bashkëpunimin ndërterritorial dhe ndërmjet kombeve dhe lidhja në rrjet të zonave rurale. Çështjet parësore janë : bërja më konkuruese e produkteve dhe shërbimeve rurale duke përdorur teknologjinë dhe duke ditur si të përmirësosh cilësinë e jetesës në zonat rurale; duke zhfrytëzuar më së miri burimet natyrore dhe kulturore; dhe duke krijuar shanse të barabarta për gratë dhe të rinjtë në zonat rurale. LEADER promovon veprime të tilla si strategjtë e integruara të zhvillimit dhe futjes në rrjet të zonave rurale.

- EQUAL: synon të provojë metoda të reja për plotësimin e nevojave në tregun e punës të atyre që janë të diskriminuar dhe përjashtuar nga përkatësia gjinore, origjina e racës dhe përkatësia etnike, besimi, mosha ose sjellja seksuale. Synon të rris një treg pune të hapur për të gjithë, dhe përpiqet të zgjedhë prkatka të mira dhe prapagandim të rezultateve. EQUAL kërkon gjithashtu të përfshijë bizneset në një shkallë më të gjerë pasi projektet e mira

të së shkuarës nuk kanë sjellë mundësira reale punësimi. Veprime të veçanta dhe rrjedha e njëjtë gjinore do të përdoret për të promovuar barazinë gjinore dhe të zhduk diskriminimin e bazuar në racë, besim dhe sjellje seksuale. Mbështëten llojete mëposhtëme të aktiviteteve: vendosja e partneriteteve të zhvillimit dhe bashkëpunimi ndërmjet kombeve; vënia në jetë e programeve të partneritetit të zhvillimit; rrjetëzimi tematikë, propagandim i praktikave të mira dhe të paturit ndikim në politikën kombëtare; dhe mështetje teknike. Për më shumë informacion të hollësishëm mbi EQUAL shiko: http://europa.eu.int/comm/employment_social/equal/index.cfm.

- URBAN: iniciativa URBAN për 2000-2006 ka të bëjë me ripërtëritjen sociale dhe ekonomike të qyteteve dhe të qarqeve urbane të prapambetura dhe këkron të formulojë dhe vëjë në jetë veçanërisht strategji novatore për ripërtëritje sociale, ekonomike të qëndrueshme duke promovuar kërkime dhe ndryshim të dukshëm në një numër të kufizuar të zonave urbane në të gjithë Evropën. Ka dy objektiva të përgjithshme:
  1. Të inkurajojë ngritjen dhe vënien në jëtë të startegjive tejet novatore të ripërtëritjes sociale dhe ekonomike në qytete të vogla dhe të mesme dhe zona të prapambetura të bashkimeve më të mëdha
  2. Të riforcojë dhe shkëmbejë njohuri dhe eksperiencë mbi ripërtëritjen dhe zhvillimin urban të qëndrueshëm në Bashkimin Evropian.

Aksionet duhet të jenë të lidhura me zona të tilla të ripërtëritjes të favorëshme për mjedisin, pakteve të punësimit dhe sipërmarrjes, përmirësimit të arsimimit dhe rrugëve, kualifikimit për personat e përjashtruar, sistemet e transportit publik, minimizimit të shpërdorimit, trajtimit dhe zhvillimt të potencialit të teknologjive të informacionit të shoqërisë

- Veprimtari Novatore: Këto i dedikohen masave novatore të financimit, të cilat përfshijnë studime, projekte pilot dhe shkëmbim experience, qëllimi i të cilave është të kontribuojnë për metodat novatore dhe praktikat të ndërtuara për të përmirësuar cilësinë e ndihmës nën 3 objektivat parësore. Financimi i dhënë nëpërmjet ERDF synon rritjen e konkurencës rajonale duke rritur nivelet e kompetencës së teknologjisë rajonale dhe duke krijuar punë

shumë të kualifikuara. ESF mbështet veprimtari që synojnë vënien në jetë të Strategjisë Evropiane të Punësimit për të parandaluar dhe luftuar papunësinë, duke zhvilluar burimet njerëzore dhe duke mbështetur integrimin social në tregun e punës. Sektori EAGGF-i Garancive financon studime të lidhura me programimin e zhvillimit rural dhe FIFG kontribuon në veprimtarinë novatore duke përfshirë operacione ndërmjet kombeve dhe ngritjen e rrjeteve për ata që punojnë në sektorin dhe zonat e mbështetura tek peshkimi dhe kultura ujore.

Si pjesë e proçesit të thjeshtimit dhe përqëndrimit në planin e punës së Lisbonës, Komisioni propozoi në Raportin e tij të Tretë të Kohezionit që probleme të ndryshme territoriale duhet të trajtohen nëpërmjet zgjidhjeve tërësore dhe të integruara, në vend të një sërë programesh dhe instrumentash. Kështu që zgjidhje për probleme të tilla duhet të gjenden në kuadër të instrumentave kryesorë të Fondeve Strukturore, dhe si pas kësaj nuk do të ketë Programe të Iniciatiave të Komunitetit për 2007-13. Çështjet e trajtuara më parë nën këto iniciativa do të trajtohen në mënyrën e mëposhtëme:

- INTERREG do të bëhet objektivi i tretë i ri p.sh Bashkëpunimi Territorial Evropian (shiko më lart) dhe është forcuar një prioritet i tërë strategjik në perjudhën e ardhëshme të programit, me burime të rritura nga ERDF dhe përgjegjësinë për të integruar fondet e tij në Instrumentin e ri të Partneritetit dhe Fqinjësisë Evropiane (ENPI) për projekte të jashtëme të përtej kufijve
- Veprimtari nën URBAN do të integrohen tërësisht në programet rajonale. Në veçanti regullorja e ERDF do të përfshijë dispozita të veçanta për dimensione urbane dhe po ashtu si EQUAL, fushtat aktuale të veprimit të URBAN do të pasqyrohet në prioritetet e programeve të reja fuksionale, kombëtare dhe rajonale. Vendet Anëtare mund të propozojnë në këto programe veprimatri në zonat e caktuara
- LEADER si i tillë do të integrohet gjithashtu në rrjedhën e programimit. Megjithatë po ashtu si EAGGF, do të vazhdojë gjithashtu të fuksionojë veçmas nga Fondet Strukturore nën Fondin e ri Bujqësor Evropian për Zhvillimin Rural.
- EQUAL do të hiqet gjithashtu, por parimet e tij do të ndërfuten në programet e tre objektivave të reja
- Fusha e veprimtarisë nën Veprimatrinë Novatore do të figurojë midis prioriteteve të programeve funksionale kombëtare dhe rajonale

### 4.2.2 FONDET STRUKTURORE DHE FONDI I KOHEZIONIT 2007-2013

Si rrjedhojë e ristrukturimit të fondeve do të ulet numri i instrumentave nga pesë në tre për 2007-ën, ndërsa do të ndryshohet gjithashtu edhe themelimi i objektivave. Kështu që Fondet Strukturore për periudhën e re të programimit janë:

- Fondi i Zhvillimt Rajonal Evropian (ERDF)
- Fondi Social Evropian (ESF)

Instrumenti i tretë financiar për politikën e kohezionit të BE-së është Fondi i Kohezionit.

#### 4.2.2.1 Instrumentat

*Fondi i Zhvillimt Rajonal Evropian (ERDF)*[30]

Duke ndjekur strategjitë e Lisbonës dhe Gothenburgut për konkurencën dhe zhvillimin e qëndrueshëm, dhënien e arsyetimit imponues dhe ristrukturimin e kërkuar të politikës së kohezionit, Komisioni konsideron në Raportin e Tretë të Kohezionit veprimtaritë kryesore të mëposhtëme të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me objektivat (poshtë), për tu zbatuar nëpërmjet mbështetjes së ERDF në periudhën 2007-13:

- Modernizimi dhe diversifikimi i strukturave ekonomike të rajoneve dhe Vendeve Anëtare. Kjo tërheq vëmendje të veçantë për risi, njohuri ekonomike dhe sipërmarrjeje, thekson rëndësinë e krijimit të lidhjeve ndërmjet instituteve kërkimore dhe industrisë, duke favorizuar marrjen dhe përdorimin e ICT-ve, dhe duke rritur përdorimin e financave dhe të diturit se- si
- Shtrirja dhe përmirësimi i infrastrukturës bazë (transport, telekomunikacion , rrjete energjitike, etj)
- Ruajtja e mjedisit, veçanërisht duke ndihmuar Vendet Anëtare të pajtohen me ligjin e BE-së, duke mbështetur zhvillimin e eko-industrive, duke rehabilituar qytetet industriale, duke parandaluar rreziqet, duke investuar në infrastrukturë,duke kontribuar për zhvillimn ekonomik të qëndrueshëm dhe duke përkrahur metoda më të pastra të transportit dhe riciklimit të energjisë
- Riforcimi i kapacitetit institucional rajonal dhe kombëtar në lidhje me administrimin e Fondeve.

30 Reg. Nr.1783/1999 e Kwshillit dhe Parlamentit Evropian

### *Fondi Social Evropian (ESF)*[31]

Raporti i Tretë i Kohezionit pranon gjithashtu një rol të ri të ESF,i cili duhet të bëhet instrumeti financiar kryesor i Strategjisë Evropiane te Punësimit dhe të ofrojë mbështetje për:

- Përmirësimin e cilësisë dhe përgjegjshmërisë së institucioneve të tregut të punës, sitemeve të arsimimit, kualifikimit si dhe shërbimeve sociale dhe të kujdesit
- Shtimin e investimit të kapitalit njerëzor, duke përmirësuar nivelet e arsimimit, duke përshtatur aftësitë e fuqisë puntore dhe duke përmirësuar mundësit e barabarta të tregut të punës
- Promovimin e kapcitetit ndërtues të administratës publike duke inkurajuar kështu përqasjen dhe ndryshimin
- Është e rëndësishme gjithashtu të theksohet se programet e ESF duhet të marrin parasysh aspektet e çështjeve të punësimit të mbuluara aktualisht nga EQUAL (p.sh risi, sipërmarrje, partneritet dhe bashkëpunim ndërkombëtar).

### *Fondi i Garantimit dhe Udhëzimit Bujqësor Evropian (EAGGF-Guidance section)32 dhe Instrumentat Financiar për Udhëzuesin e Peshkimit (FIFG)*[33]

Është e rëndësishme të theksohet këtu se këto dy instrumenta nuk do të financojnë më drejtpërdrejt programet. EAGGF do të bëhët Fondi Bujqësor Evropian për Zhvillimin Rural (EAFRD), një instrument tërësisht i veçuar nga Fondet Strukturore

### *Fondi i Kohezionit*

Në propozimet e tij për rregulloren e re për përiudhën 2007-13 Komisioni planifikon integrimin e Fondit të Kohezionit më shumë në Fondet Strukturore duke ruajtur kriteret e pranueshmërisë (p.sh 90% GNP). Kështu që mbështetja do të jetë e bazuar më shumë në program duke lëne më shumë përgjegjësi për autoritetet administruese dhe do të mbulohen më shume zona të ndryshme interesi

---

31 Reg. Nr.1784/1999 I Kwshillit dhe Parlamentit Evropian

32 Reg e Këshillit. Nr.1257/1999.

33 Reg.e Këshillit Nr.1263/1999c.

Përgjithësisht më shumë theksimet janë bazuar në prioritetet e Gothenburgut përsa i përket zhvillimt të qëndrueshëm. Rrjetet Trans-Evropiane do të mbeten një proritet, veçanërisht përsa u përket projekteve të interesit Evropian dhe infrastrukturës mjedisore. Projekte të tjera të mbështetura përfshijnë: programe transporti në zonat hekurudhore, detare, rrugëve ujore në tokë; transport urban i qëndrueshëm; dhe ivestime në fushat kyçe të riciklimit dhe prodhimtarisë së energjive.

### 4.2.2.2 Objektivat

Duke marrë në konsideratë nevojën për më shumë ndërhyrje dhe një angazhim për përparësitë e Lisbonës dhe Gotenburgut, Komisioni propozoi ndryshime të objektivave të Fondit Strukturor në Raportin e tij të Tretë të Kohezionit me qëllim që të thjeshtojë sistemin, ta bëjë atë më transparent dhe të efektshëm. Ndryshe nga më parë, objektivat tani bazohen në tema prioritare dhe grupohen në tre tituj: konvergjenca, konkurenca rajonale dhe bashkëpunimi territorial.

- Konvergjenca — Mbështetja e rritjes dhe krijimi i vendeve të punës në shtetet anëtare dhe rajonet më pak të zhvilluara: Sipas këtij objektivi, politika e kohezionit do të synojë nxitjen e kushteve që forcojnë rritjen dhe faktorëve që të çojnë në konvergjencë reale. Strategjitë duhet të kenë si qëllim në veçanti konkurencën afatgjatë dhe punësimin. Në përgjithësi, ky objektiv do të korrespondojë me Objektivin aktual 1 dhe Objektivin e Kohezionit dhe do të ruajë të gjitha veçoritë kryesore të tyre, duke përfshirë kriteret e përshtatshmërisë. Kështu, shtetet anëtare dhe zonat më pak të zhvilluara do të jenë të përshtatshme, dhe objektivi i Konvergjencës përfshin shumë vende të reja anëtare dhe disa zona të tjera nën objektivin e vjetër 1. Megjithatë, ky objektiv i ri do të financohet vetëm përmes ERDF, ESF dhe Fondit të Kohezionit ndërsa Udhëzuesi-EAGGF dhe FIFG nuk do të jenë më në veprim. Lidhur me burimet e akurduara për këtë objektiv, Komisioni propozon dhënien e 78.54% të burimeve të përgjithshme të vëna mënjanë për Fondin Strukturor.

  Këtu, ERDF financon operacione të lidhura me risitë dhe ekonominë e njohurive. Kjo përfshin investimet produktive dhe zhvillimin e potencialeve në fusha të tilla si shërbimet ndaj ndërmarrjeve, novacionet dhe rindërtim & zhvillim (R&ZH), iniciativat e biznesit, infrastruktura lokale, shoqëria e informacionit dhe turizmi. Ofrimi

i aksesit dhe shërbimet me interes të përgjithshëm mbështeten gjithashtu përmes ERDF përsa i përket transportit, rrjeteve të komunikacioneve dhe të energjisë, si dhe rrjetet shoqërore. Përveç kësaj, mjedisi dhe parandalimi i rrezikut janë gjithashtu tema parësore lidhur me çështje që kanë të bëjnë me me ligjet e BE-së, zhvillimin, rehabilitimin, parandalimin e rrezikut, transportin e pastër dhe energjinë efektive.

ESF, nga ana tjetër, financon veprime që lidhen me arsimin, punësimin dhe sistemet e mbështetjes sociale, për shembull, forcimin e institucioneve të tregut të punës dhe zhvillimi i sistemeve arsimore e shërbimet sociale. Një fushë tjetër prioritare për ESF sipas këtij objektiviv, është kapitali njerëzor dhe sigurimi i punës. Fokusi vihet tek masat për trajnim, futjen në tregun e punës dhe përfshirja sociale.

Së fundi, mbështetja për ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe administrative jepet nga të dy instrumentet.

- Konkurenca rajonale dhe punësimi- Parashikimi dhe nxitja e ndryshimit: Ky objektiv i ri do të integrojë Objektivat aktualë 2 dhe 3 por, ai akoma do të financohet përmes të dyjave ESF dhe ERDF (Sipas propozimit të Komisionit, burimet e përgjithshme për këtë objektiv do të arrijnë 17.22% të shumës totale). Të gjitha fushat që nuk përfshihen në objektivin e konvergjencës janë të përshtatshme në sajë të faktit se , megjithëse ato mund të jenë fusha më të pasura, çështje të tilla si ndryshimi ekonomik dhe social, globalizimi dhe lëvizja drejt një shoqërie me bazë njohurish, do të kenë ndikimin e tyre mbi to. Kjo përsëri pasqyron angazhimin e Komisionit për objektivat e Lisbonës. Ky objektiv i ri do të bazohet në dy lloje programesh:
  - Programet rajonale (të financuara përmes ERDF) të cilët do të ndihmojnë autoritetet rajonale të parashikojnë dhe nxisin ndryshimin ekonomik në në zonat industriale, urbane dhe rurale duke forcuar konkurencën. NVM (ndërmarrjet e vogla dhe të mesme) mbështeten veçanërisht nga ky program, ashtu si dhe iniciativat e biznesit. Në fushën e ofrimit të aksesit ERDF mbështet rrjetet dytësore, si dhe hyrjen në shoqërinë e informacionit. Nxiten, gjithashtu, çështjet e mjedisit dhe parandalimit të rrezikut, në të njëjtën mënyrë si nga objektivi i parë.

» Programet operacionale (të financuara nga ESF) të cilat do të ndihmojnë njerëzit të parashikojnë dhe të adaptojnë ndryshimin ekonomik, në përputhje me përparësitë e politikave të SEP (Strategjia Europiane e Punësimit) duke mbështetur politika që kanë për qëllim punësimin me orar të plotë, cilësinë dhe produktiviteti në punë dhe përjashtimi social. Kështu, një përparësi kryesore është përshtatja e punëtorëve e cila nxitet përmes strategjive të tilla si mësimi gjatë gjithë jetës dhe trajnimi gjatë punës. Përveç kësaj, sigurimi i punës dhe njerëzit e pafavorizuar mbështeten përmes masave për të krijuar strategjinë e mplakjes aktive, për të rritur pjesëmarrjen e grave dhe për të rritur mundësitë e punësimit, përfshirja e invalidëve, migrantëëve dhe minoriteteve etnike.

- Bashkëpunimi evropian territorial — Nxitja e një zhvillimi harmonik dhe të ekuilibruar në territorin e Bashkimit: Ky objektiv do të mbështetet kryesisht në eksperiencën e iniciativave të tanishme të INTERREG për të mbështetur integrimin harmonik dhe të ekuilibruar të territorit të Bashkimit përmes bashkëpunimit për çështjet e rëndësisë së Komunitetit në nivelin ndërmjet shtetesh dhe ndërrajonal. Ky objektiv do të financohet në mënyrë ekskluzive përmes ERDF. Veprimet brenda këtij objektivi do të fokusohen në programet e integruara që synojnë zbatimin e e përparësive kyç të Komunitetit lidhur me planet e punës së Lisbonës dhe Gotenburgut. Burimet për këtë objektiv do të arrijnë 3.94% të shumës totale. Fushat e përshtatshme janë në parim të gjitha rajonet gjatë kufijve të jashtëm dhe të brendshëm (tokësore dhe detare) dhe qëllimi i tyre është të gjejnë zgjidhje të përbashkëta për problemet ndërmjet autoriteteve fqinje në fusha të tilla si zhvillimi urban, rural dhe bregdetar, marrëdhëniet ekonomike dhe rrjetet e NVM.

Duhet përmendur që Objektivi i vjetër 3 si i tillë nuk ekziston më, por disa nga parimet e tij do të reflektojnë objektivat e reja përmes veprimit të ESF.

Për më tepër, për periudhën e programimit 2007-13 Direktivat Strategjike të Komunitetit duhet të merren parasysh kur hartohen strategjitë kombëtare. Këto janë gjithashtu një tregues i dobishëm për OJQ-të që kërkojnë të identifikojnë fusha prioritare më specifike gjatë periudhës së programimit. Në projekt-dokumentin [COM(2005)0299] Komisioni identifikon direktiva e mëposhtme:

- Kthimi i Evropës dhe rajoneve të saj në vende tërheqëse për të investuar dhe punuar (infrastrukturë transporti; mbrojtje e mjedisit dhe rritje; përdorimi I burimeve tradicionale të energjisë).
- Përmirësimi i njohurive dhe risitë për rritjen (investimet në RTD; risitë dhe iniciativat e biznesit; shoqëria e informacionit; aksesi për financim
- Vende pune më të shumta dhe më të mira (më shumë njerëz të punësuar; sistemet e mbrojtjes sociale; përshtatshmëria e punëtorëve dhe tregut të punës; kapitali njerëzor; kapacitetet administrative; forca e shëndetshme e punës).

### 4.2.3 EVOLUIMI I INSTRUMENTAVE DHE OBJEKTIVAVE

Tabela e mëposhtme bën përmbledhjen e evoluimit të instrumenteve dhe objektivave të ndryshme të shqyrtuara nga Komisioni

| EVOLUIMI I INSTRUMENTEVE DHE OBJEKTIVAVE | | | |
|---|---|---|---|
| 2000 - 2006 | | 2007-2013 | |
| OBJEKTIVAT | INSTRUMENTAT FINACIARE | OBJEKTIVAT | INSTRUMENTAT FINANCIARE |
| Fondi i Kohezionit | Fondi i Kohezionit | Konvergjenca dhe Konkurrenca | Fondi i Kohezionit ERDF |
| Objektivi 1 | ERDF, ESF, EAGGF-Drejtim. FIFG | Konkurrenca Rajonale dhe punësimi | ERDF, ESF |
| Objektivi 2 | ERDF, ESF | Kooperimi Evropian Territorial | ERDF |
| Objektivi 3 | ESF | | |
| INTERREG | ERDF | | |
| URBAN | ERDF | | |
| EQUAL | ESF | | |
| LEADER + | EAGGF-Drejtim | | |
| Zhvillimi rural dhe rikonstruksioni i sektorit të peshkimit jashtë objektivit 1 | EAGGF-Drejtim FIFG | | |
| 9 objektiva | 6 instrumenta | 3 objektiva | 3 instrumenta |

# Zërat e Buxhetit të Jashtëm

Komiteti Evropian shpërndan fonde në zona të ndryshme të linjës së veprimit dhe jep për çdo zë linjë të veçantë buxheti. Në çdo linjë buxheti do të ketë kushte dhe kërkesa të veçanta për kantidatët e pranueshëm. Këto janë të paraqitura në çdo thirrje për propozim. Informacioni për thirrjet për propozim mund të sigurohet nga faqja elektronike Europa dhe nga delegacionet e Komitetit Evropian në vendin apo rajonin tuaj. Për të marr një list të delegacioneve ju lutemi referohuni faqes elektronike –
http://europa.eu.int/comm/external_relations/delegations/intro/web.htm
Për të dhënë një pamje të përgjithshme të financimit të disponueshëm në secilën zonë të linjës së veprimit poshtë jepet një listë e linjave të buxhetit të financimit të jashtëm, ku tregohen dhe shumat e shpërndara për linjë buxheti.

## 5.1 LISTË E ZERAVE TË BUXHETIT

### LIDHJET E JASHTME (Zona e linjës së veprimit 19)

| | |
|---|---|
| Program i ndihmës teknike dhe financiare për vendet e treta në zonat e migrimit dhe azilit. (19 02 03) | 44.35 m € |
| Pjesëmarrja e komunitetit në veprimtari për minat anti-njeri (19 02 04) | 16.80 m € |

| | |
|---|---|
| Mekanizmi i reagimit të shpejtë (19 02 05) | 32.06 m € |
| Ndihmë për viktimat e dhunimeve të të drejtave njerëzore.(19 04 02) | 7.00 m € |
| | |
| Zhvillimi dhe forcimi i demokracisë dhe vënies në zbatim të ligjit — Respektimi i të drejtave njerëzore dhe Të Drejtat E Njeriut dhe lirive themelore (19 04 03) | 105.41 m € |
| Mbështetje për aktivitetet e gjyqeve ndërkombëtare kriminale dhe Gjyqet Ndërkombëtare Kriminale. (19 04 04) | 7.00 m € |
| Veprime përgatitore për ngritjen e një rrjeti të parandalimit të konflikteve.(19 04 05) | 1.50 m € |
| Ndihmesë për reabilitimin dhe rikonstruktimin e Irakut (19 08 07) | 200.00 m € |
| Operacione rehabilitimi dhe rikonstruktimi në Mesdhe dhe Lindjen e Mesme. (19 08 05) | p.m. |
| Bashkëpunim teknik dhe financiar me vendet në zhvillim të Amerikës Latine. (19 09 01) | 213.11 m € |
| Bashkëpunim politik, ekonomik dhe kulturor me vendet në zhvillim të Amerikës Latine(19 09 02) | 84.00 m € |
| Ndihmesë për njerëzit e shpërngulur të vendeve të Amerikës Latine.(19 09 03) | 21.00 m € |
| Operacione rehabilitimi dhe rikonstruktimi për vendet në zhvillim në Amerikën Latine (19 09 04) | p.m. |
| Bashkëpunim financiar dhe teknik me vëndet aziatike në zhvillim. (19 10 01) | 331.87 m € |
| Bashkëpunim politik, ekonomik dhe kultruror me vendet aziatike në zhvillim. (19 10 02) | 91.00 m € |
| Ndihmesë për njerëzit e shpërngulur të vendeve aziatike. (19 10 03) | 28.00 m € |
| Operacione rehabilitimi dhe rikonstruktimi në vendet në zhvillim në Azi. (19 10 04) | 180.00 m € |
| Ndihmesë për rehabilitimin dhe rikonstruktimin e Afganistanit. (19 10 06) | 183.00 m € |
| Dhënie kontributi për aktivitetet ambjentaliste në vendet në zhvillim, UNFCCC dhe Protokolli i Kyoto (07 02 01) | 8.09 m € |

## ZHVILLIMI DHE MARRËDHËNIET ME VENDET ACP
## ( Zona e Linjës së Veprimit. 21)

| | |
|---|---|
| Dhënie e kontributit të komunitetit për skemat që kanë të bëjnë me vendet në zhvillim , të zbatuara nga OJQ-të (21 02 03) | 210.00 m € |
| Mjedisi në vendet në zhvillim (21 02 05) | 56.61 m € |
| Promovimi i barazisë gjinore në zhvillimin e bashkëpunimit(21 02 06) | 2.83 m € |
| Bahkëpunim i decentralizuar (21 02 13) | p.m. |
| Ndihmesë për sëmundjet e lidhura me varfërinë (HIV/SIDA, malaria and tuberkulozi) në vendet në zhvillimin(21 02 07 02) | 76.06 m € |
| Ndihmesë për popullatën dhe kujdesin ndaj shëndetit rriprodhues(21 02 07 03) | 19.49 m € |
| Veprim përgatitor ndihmese për sëmundjet e lidhura me varfërinë( përveç HIV/SIDA, malaria and tuberkulozi) në vendet në zhvillim (21 02 07 04) | 10.00 m € |
| Ndihmë në rast emergjence – Vendet ACP (21 03 07) | p.m. |
| Ndihmë për refugjatët – Vendet ACP (21 03 08) | p.m. |
| Program evropian për rikonstruktimin dhe zhvillimin (EPRD) në Afrikën e Jugut(21 03 17) | 132.76 m € |
| Pregatitja e produkteve sipas Konventës së Ndihmës Ushqimore (21 02 01) | 128.47 m € |
| Ndihmë tjetër në formë produktesh, operacione mbështetëse dhe transport, shpërndarje, masa mbështetëse dhe masa për të monitoruar vënien në zbatim (21 02 02) | 285.35 m € |
| Veprim rehabilitues dhe rikonstruktues në vendet në zhvillim, veçanërisht vendet ACP (21 03 20) | p.m. |

## NDIHMA HUMANITARE
## (Zona e Linjës së Veprimit 23)

| | |
|---|---|
| Ndihmë ,duke përfshirë ushqim në rast emergjence, për të ndihmuar popullatën e vendeve në zhvillim dhe vende të tjera të botës së tretë të goditura nga fatkeqësi natyrore ose kriza të rënda (23 02 01) | 470.42 m € |

| | |
|---|---|
| Ndihmë fuksionale dhe gatishmëri në rast fatkeqësie natyrore (23 02 02) | 19.00 m € |

## 5.2 PROGRAMET FINANCUES

### 5.2.1 INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI PROGRAMET FINANCUES

Për tu përfshirë në programet e financuara nga Komiteti Evropian është e nevojshme të monitorosh thirrjet për propozime që jepen nga Komiteti. Thirrjet për propozime janë ftesa nga Komiteti Evropian për palët e interesuara, të pranueshme për të bërë projekt-propozime që janë në linjë me kërkesat dhe kushtet të paraqitura në këto ftesa.

Kërkesa për propozime për ndihmë financiare dhe tendera për projekte me ndihmë nga jashtë mund të gjenden në faqen elektronike
EuropeAid:
http://www.europa.eu.int/comm/europeaid/cgi/frame12.pl

Ato janë gjithashtu të publikuara në Revistën Zyrtare të Komunitetit Evropian (RZ), e cila gjendet online në: http://www.europa.eu.int/eur-lex/en/index.html

E dobishme është gjithashtu edhe udhëzuesi praktik për proçeduart kontraktuese të financuara nga Buxheti i Përgjithshëm i Komunitetit Evropian në kontekstin e veprimeve të jashtëme, i cili gjendet në:
http://europa.eu.int/comm/europeaid/tender/gestion/pg/npg_en.doc (paragrafi i ndihmave financiare fillon në faqen 155).

Ju lutem vini re se pjesa më e madhe e linjave të jashtëme të buxhetit përfshijnë vetëm pika kontakti nga EuropeAid. Sidoqoftë nëse doni informacion mbi programimin në tërësi kontaktet do ti gjeni në DG Zhvillim ose Marrëdhëniet e Jashtme. Njerëzit e EuropeAid do të mund t'ju orientojnë ju tek kontaktet e duhura

## 5.2.2 PROGRAMET SIPAS KATEGORIVE TEMATIKE

### 5.2.2.1 Operacione mbështetje dhe ndihmë në ushqim

EuronAid, një rrjet OJQ-ësh dhe një partner i përbashkët i Komisionit administron shpërndarjen e ndihmave ushqimore me karakter dhurues nga Komisioni për OJQ-të sipas Programit të tij të Ndihmës Ushqimore dhe Sigurisë së Ushqimit. Kjo jo vetëm që ndihmon vënien në zbatim të projekteve të OJQ-ve por gjithashtu promovon dialog mbi ndihmën ushqimore dhe politikat mbështetëse me të interesuarit përkatës. Shërbimet e EuronAid janë të mundshëm si për anëtarët dhe joanëtarët e OJQ-ve. Veç kësaj një lëvrim financiar prej rreth 60 million euro i jepet në vit projekteve të OJQ-ve që u referohen problemeve strukturore të pasigurisë së ushqimit.

Programi i sigurisë së ushqimit dhe ndihmës ushqimore ka për qëllim krijimin e niveleve të përmirësuara dhe të qëndrueshme të sigurisë së ushqimit kombëtar dhe rajonal, duke i kushtuar vëmendje të veçantë grupeve të cënueshme.Të tjera qëllime kryesore janë të përmirësohet furnizimet me ushqim në situatat e mungesës kronike dhe emergjencës, përgjithësisht për të mbështetur zhvillimin e balancuar social dhe ekonomik në këtë fushë.

Fondi është i disponueshëm për projekte ne zonat e mëposhtëme:
- Produkte ushqimore
    - » Drithëra ose produkte me bazë drithërash, në formë farërash kur është e përshatëshme
    - » Qumësht pluhur ose zvendësues; vaj vegjetal dhe sheqer
    - » Produkte të tjera p.sh perime bishtajore, peshk, biskota të pasuruara me proteina, farëra etj.
- Veprime në mbështetje të sigurisë së ushqimit
- Sisteme paralajmëruese dhe programe magazinimi

Fleksibiliteti në proçesin përzgjedhës vjetor është i madh. Përpara se të paraqisni një propozim ju këshillohet të kontaktoni delegacionin vendas, të KE-së dhe të diskutoni projektin tuaj me këshillëtarin e çështjeve të sigurisë së ushqimit, për të gjetur nëse projekti juaj është i qendrueshëm për financim. Delegacioni vendas do të përfshihet në proçesin përzgjedhës kështu që kjo do t'ju shpëtonte nga paraqitja e një prpozimi të paqendrueshëm. Për detaje të kontaktit të delegacioneve vendase ju lutem referohuni:

http://www.europa.eu.int/comm/external_relations/delegations/intro/web.htm.

**Kontaktoni:** EuronAid
P.O. Box 12
NL – 2501 CA, Hague, Netherlands
Tel +31 70 330 5757
Fax +31 70 364 1701
E-mail euronaid@euronaid.nl

**Faqja elektronike:**
http://www.euronaid.net

### 5.2.2.2 Ndihmë humanitare në rast emergjence

**19 02 05** – Mekanizmi i Reagimit të Shpejt

**Buxheti i dhënë:** 32.06 milion

Financimi nëpërmjet Mekanizmit të Reagimit të Shpejt (RRM) synon veprim urgjent në situatata krizash ose kriza emergjente, situata që parashtrojnë kundërvënie me ligjin ose kërcënim të sigurisë së njerzëve dhe situtata që mund të degjenerojnë në konflikt të armatosur, ose të destabilizojnë vendin. Qëllimi është të mbrohet ose të ristabilizohen rrethana në të cilat ndihma dhe politikat bashkëpunuese dhe programet të mund të vihen në zbatim dhe të arrijnë siç duhet qëllimet e tyre.

Kjo linjë buxheti ka për qëllim të mbulojë në veçanti financimin e veprimeve me natyrë civile që synojnë të kundërveprojnë ose zgjidhin situata të krizave emergjente dhe kërcënimeve serioze ose shpërthime konfliktesh. Mekanizmi i Reagimit të Shpejtë nuk financon ndihmën humanitare ose operacione ku elementë të tjerë të KE-së janë të disponueshëm në kohën e afatit kohor të nevojshëm. Kohëzgjatja e projekteve nuk duhet t'i kalojë gjashtë muaj.

Si Partnerë plotësues mund të përfshihen autoritetet e Vendeve Anëtare ose vendeve përfituese dhe agjencitë e tyre, organizma rajonal dhe ndërkombëtar dhe agjencitë e tyre, OJQ, operatorë të sektorit publik dhe privat, organizata individuale ose operatorë

(përfshirë personel tjetër nga administrata e Vendeve Anëtare) me ekspertizen e duhur, të specializuar dhe eksperiencë.

**Kontaktoni:** Ms Christine GRAU (Finance and Contracts Officer / Project Manager)
Directorate-General External Relations
CFSP and RRM: Programme Management — A3
B-1049 Brussels
Tel +32 2 295 5716
Fax +32 2 295 0580
E-mail christine.grau@cec.eu.int

**Faqe elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/external_relations/cpcm/rrm/index.htm

## **23 02 01** — Ndihmë, përfshirë ndihmën ushqimore, për të ndihmuar popujt e vendeve në zhvillim dhe vënde të tjera të botës së tretë të goditura nga fatkeqësitë natyrore ose kriza të rënda.

**Buxheti i dhënë:** 470.42 milion

Kjo linjë buxheti administrohet nga Drejtoria e Përgjithëshme e Ndihmës Humanitare (ECHO). Financon operacione të zbutjes, mbrojtjes dhe ushqimit në rast emergjence për njerëzit e vendeve në zhvillim. Uji është një prioritet i ri në planin horizontal, zona të tjera prioritare varijojnë në varësi të zonës gjeografike (për këtë ju lutemi shikoni ECHO Aid Strategy 2006, gjendet në http://europa.eu.int/comm/echo/pdf_files/strategy/2006/strat_2006_en.pdf).

Vendet në zhvillim përfshijnë vendet ACP (Afrikë, Karaibe, Paqësor), Azia, Amerika Latine dhe vënde të tjera të botës së tretë që përballen me fatkeqësi natyrore ose të shkaktura nga njeriu. Ndihma do të ofrohet për sa kohë vazhdon situata e emergjencës dhe ECHO do të vazhdojë t'i kushtojë vëmendje të veçantë krizave dhe nevojave të harruara. Financimi nën këtë linjë është gjithashtu i disponeushëm për paisje ose produkte që mund të japin një ndihmë të tillë. P.sh konstruksion shtëpish ose strehëve për grupet e prekura dhe ndërtim i infrastrukturës dhe ambjenteve. Mund të mbulojë gjithashtu çdo

kosto tjetër të lidhur drejtëpërdrejt me zbatimin e operacioneve të ndihmës humanitare.

Një opearcion i ndihmës emergjente mund të ofrohet në disa mënyra: nga një OJQ që ka një marrëveshje partneriteti me ECHO, nga një vend Anëtarë ose jo, ose nga vetë ECHO. Përpara paraqitjes së një propozimi një OJQ duhet të nënshkruaj një Marrëveshje në Kuadër të Partneritetit me ECHO (shiko http://europa.eu.int/comm/echo/partners/fpa_ngos_en.htmderi) Për shkak të natyrës së punëve të financuara vënia në zbatim e projektit që nga paraqitja e një propozimi deri në përfundim të projektit mund të jetë shumë e shkurtër. Përgjithësisht projektet nuk duhet të zgjasin më shumë se gjashtë muaj. Zakonisht ECHO jep 100% të financimit.

**Kontaktoni:** Ju lutemi mbani lidhje me personin kontaktues përgjegjes për shtetin/rajonin. Të dhëna lidhur me kontaktin mund ti gjeni në: http://europa.eu.int/comm/echo/presentation/staff_echo1_en.htm

**Faqe elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/echo/ (e përgjithëshme)
http://europa.eu.int/comm/echo/partners/index_en.htm (udhëzues)

## **21 03 07** – Ndihmë emergjente - Vendet ACP (Ndihmë Emergjente në Marrëveshjen Cotonou – neni 72)

**Buxheti i dhënë:** p.m.

Kjo linjë buxheti mbulon ndihmën emergjente të Shteteve ACP të përballura me vështirësi ekonomike dhe sociale si rrjedhojë e fatkeqësive natyrore ose faktorëve të jashtëzakonshëm me efekt të krahasueshëm. Kjo ndihmë duhet të jetë fleksibël (p.sh. dhënien e të mirave të ndryshme dhe shërbimeve në varësi të rrethanave) dhe mëqe qëllimi i ndihmës së emergjencës është të plotësojë nevojat imediate shpejt dhe lehtësisht. Gjithashtu mund të përdoret për të përdorur me sukses strukturat dhe paisjet fuksionale.

Neni 72 në Marrëveshjen e Cotonou është nën përgjegjësinë e ECHO, përgjegjës për të gjithë ndihmën emergjente të Komisionit Evropian në vendet në zhvillim. Propozimet shqyrtohen konform strategjisë vjetore të ECHO dhe në përgjigje të çdo ndihme të dhënë.

Për tu siguruar që veprimet janë zbatuar pa shtyrje afati, Komisioni ka vendosur rregullat e mëposhtëme : (i) fondet e dhëna për ndihmën emergjente duhet të lëvrohen dhe paguhen tërësisht dhe veprimi të përfundoj brenda 180 ditëve të vendosjes së së vënies në zbatim (përjashto marrëveshje të përbashkët); (ii) nëse pagesa e plotë nuk është kryer brenda limitit të afatit kohor të caktuar nga një marrëveshje e përbashkët, balancimi do ti kthehet një linje buxheti të veçantë; (iii) regullat e hollësishëm për vënien në zbatim dhe dhënien e fondeve janë në varësi të emergjencës dhe proçedurave fleksibël; (iv) fondet mund të përdoren për financim të ndërsjelltë të veprimeve të emergjencës të ndërmarra nga Shtetet ACP.

**Kontaktoni:** Mr Simon HORNER (Head of Unit)
Directorate-General Humanitarian Aid
Information and Communication – Unit 7
B-1049 Brussels
Tel +32 2 299 2996
E-mail ECHO-ONG@cec.eu.int , simon.horner@cec.eu.int

**Faqe elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/echo/index_en.htm (e përgjithshme)
http://europa.eu.int/comm/echo/partners/index_en.htm (udhëzues)

## **23 02 02** – Mbështetje operacionale dhe Gadishmëri në rast fatkeqësish natyrore

**Buxheti i dhënë:** 19.00 milion

Programi DIPECHO (Gatishmëria e ECHO për raste Fatkeqësish) bazohet në idenë se ,për sa u përket e pasojave të fatkeqësive natyrore në vendet në zhvillim në lidhje me ekonominë dhe humbjen e jetëve njerëzore, gadishmëria për përballimin dhe parandalimin e fatkeqësive janë pjesë përbërëse e ndihmës humanitare.

Masa të tilla si, ngritja e sistemeve paralajmëruese, organizimi i përpjekjeve të shpëtimit nëpërmjet kualifikimit të instruktorëve dhe forcimi i institucioneve dhe organizmave financohen nga DIPECHO. Qëllimi kryesor është krijimi i kapacitetit vendas të reagimit për comunitetet e prekura për tu pregatitur për fatkeqësitë në të ardhme. Përsa i përket parandalimit, ECHO financon projekte me shkallë të ulët infrastrukture, me qëllimin që këto të ndiqen nga komunitetet dhe pushtetet vendore me projekte me shkallë më të madhe.
Në lidhje me vendndodhjen gjeografike, ECHO mbështet projekte në zonat më të prirura për fatkeqësi të botës në zhvillim: Azia Jugore dhe Juglindore, Azia Qëndrore, Amerika Qëndrore, Rajonin Alpin dhe Karaibet. Çdo rajon nën programet e DIPECHO ka kërkesën e vetë për propozime. OJQ-të evropiane, organizma ndërkombëtar dhe agjensi të specializuara të Vendeve Anëtare mund të paraqesin propozime nën këtë linjë buxheti.

**Kontaktoni:** Mr Hermann SPITZ (Depute Head of Unit and Desk)
ECHO 1 — African, Caribbean and Pacific, DIPECHO
Tel +32 2 295 9932
E-mail echo-info@cec.eu.int (kërkesa të përgjithshme), hermann.spitz@cec.eu.int

Miss Beatrice MIEGE
ECHO 3 — Asia, Central and South America (Team Leader), DIPECHO
Tel +32 2 296 2241
E-mail echo-info@cec.eu.int (kërkesa të përgjithshme), beatrice.miege@cec.eu.int

**Faqe elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/echo/field/dipecho/index_en.htm (e përgjithshme)
http://europa.eu.int/comm/echo/whatsnew/calls_en.htm (thirrje për tender)

### 5.2.2.3 Refugjatët

**19 10 03** – Ndihmë për njerëzit e shvendosur të vendeve aziatike
**19 09 03** – Ndihmë për njerëzit e shvendosur të vendeve të Amerikës Latine

**Buxheti i dhënë:** 28.00 dhe 21.00 milion

Qëllimi kryesor i Këshillit të Rregullores 2130/2001 (shtrirë deri më 31.12.2006 nga Rregullorja 107/2005) është tu jap ndihmë personave të shpërngulur, refugjatëve dhe njerëzve të tjerë të zhvendosur për ti bërë ata të zotë të vetes dhe të pavarur. Ndihma për njerëzit e shpërngulur (AUP) ndihmon njerëzit të ristabilizohen ose ri-integrohen nëpërmjet marrjes me bujqësi, peshkim, kujdesit për familjen, ngritjes së një sistemi krediti dhe ofrimit të arsimimit minimal dhe infrastrukturave të përshtatëshme të higjenës dhe shëndetit.

Përfituesit e kësaj linje buxheti janë:

- Refugjatët, personat e shpërngulur, të rikthyerit dhe ushtarët e çmobilizuar dhe grupe të tjera njerëzish të cilët kanë lënë vendbanimin ose vendin e tyre të origjinës për shkak të luftës, mungesës së sigurisë ose konflikte dhe kriza të tjera të shakaktuara nga njerëzit.
- Popullata vendase në vendin pritës nëse burimet e vendit pritës përdoren për të ndihmuar dhe pritur njerëzit e shvendosur.

Linja mbulon gjithashtu masat e marra për mbijetesën e mundëshme, riatdhesimin, dhe ristabilizimin e refugjatëve dhe arsimimin e fëmijëve të prekur nga lufta ose fatkeqësitë natryrore. Për më gjerë mund të përdoret për parandalimin e zhvendosjes së popullësisë.

Partnerët e përshtatëshëm në këtë rregullore për financim janë organizma ndërkombëtar dhe rajonal të tille si; agjencitë e KB, OJQ-të, autoritetet lokalë dhe organizma zyrtarë, institucione dhe operatorë privat dhe publik. Ndërhyrjet duhet të financohen së bashku me OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare. Kontributi i dhënë nga organizata varijon në përputhje me mundësitë e saja financiare, dhe natyrën e projektit. Në disa rrethana për shembul nëse partneri është një OJQ ose organizatë e mbështetur në komunitet bashkë-fi-

nancimi mund të bëhet në të mira dhe shërbime. Financimi jepet në formë granti. Mesatarisht kontributi i KE-së varijon midis 75% dhe 100%.

Perjudha kohore maksimale për një operacion është 24 muaj. Kërkesat për tender janë të hapura në kushte të barabarta për të gjithë personat ligjor dhe të zakonshëm të Vendeve Anëtare dhe vendeve marrëse.

**Kontaktoni:** Miss Valerie RAMET (International Aid / Cooperation Assistant)
Geographical coordination and supervision — Asia; Central Asia
AIDCO Unit D1 — Desk Uprooted People
Tel +32 2 298 7517
Fax +32 2 299 8184
E-mail valerie.ramet@cec.eu.int

Miss M. SANCHEZ GIL-CEPEDA (Programme Manager)
Geographical coordination and supervision — Latin America
AIDCO Unit B1
Tel +32 2 298 6712
Fax +32 2 299 9837
E-mail maria.sanchez-gil-cepeda@cec.eu.int

**Faqe elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/external_relations/upp/intro/index.htm

## **21 03 08** —Ndihmë për refugjatët , shtetet ACP (neni 72 Marrëveshja Cotonou)

**Buxheti i dhënë:** p.m.

Neni 72 ofron ndihmesë vendeve ACP kur ato duhet të plotësojnë nevoja urgjente për refugjatë, ose të kthyer dhe kjo nuk bmulohet nga ndihma e emergjencës. Kështu që kërkohet për ndihmë në rast të ri-integrimit pas konfliktit apo fatkeqësisë. Ndihma e dhënë përfshinë vënien në zbatim të projekteve afatgjatë dhe programeve që

promovojnë ri-integrimin e refugjatëve dhe personave të shpërngulur. Sidoqoftë, përpara zbatimit është e nevojshme të merren parasysh të gjithë faktorëtr që çojnë në shvendosjen e njerëzve dhe është veçanërisht e rëndësishme të paturit parasysh dëshirat e popullatës së prekur dhe përgjegjësitë e qeverisë në plotësimin e nevojave të popullit të vet.

Nëse projekti thekson natyrën e zhvillimit, është e mundur të përdoret kjo ndihmë së bashku me programet treguese kombëtare të vendit të prekur. Kjo llojë ndihme duhet të administrohet dhe zbatohet në proçedurat të cilat lenë hapësirë për fleksibilitet dhe reagim të shpejtë kur duhet. Duhet kushtuar vëmendje mënyrave më efektive të dhënies së ndihmës popullatës së prekur. Kushtet për pagesë dhe zbatimi varijon nga rasti në rast. Për më tepër ka një mundësi të zbatimit të ndihmës së bashku me organizatat e specializuar të tilla si Kombet e Bashkuara ose vetë Komisioni.

**Kontaktoni:** Mr Jose Luis TRIMINO PEREZ
Geographical coordination and supervision for ACPs
AIDCO – C1
Tel +32 2 299 0823
Fax +32 2 299 6191

**Faqe elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/external_relations/delegations/intro/wwb.htm

### 5.2.2.4 Migrimi

## **19 02 03** – Program i ndihmës teknike dhe financiare për vendet e botës së tretë në zonat e migrimit dhe azilit

**Buxheti i dhënë:** 44.35 milion

Ky program financon projekte të lidhura me migrimin dhe azilin, në partneritet me vendet e origjinës dhe tranzit, me qëllim mbështetjen e përpjekjeve të këtyre vendeve për të manaxhuar më me efikasitet prurjet e migrimit. Financim prioritar do tu jepet atyre vendeve dhe rajoneve për të cilat Këshilli ka miratuar plane veprimi të pë-

priluara nga Grupi i Punës për Azilin dhe Migrimin, në kushtet që këto vende dhe rajone të kenë një nivel stabiliteti garant. Në këtë program ka masa të veçanta për të kufizuar imigrimin ( duke luftuar emigrantët e paligjshëm, kontrabandistët, fushtata informuese mbi pasojat e hyrjes dhe punësimit të paligjshëm në BE), të cilat do të kombinohen me masat e fuqizimit të demokracisë dhe zbatimt të ligjit.

**Kontaktoni:** Ms Nicola ANNECCHINO (Head of Unit)
Directorate-General Justice and Home Affairs
Immigration and Asylum – B2
Tel +32 2 296 1870
Fax +32 2 299 8053
E-mail nicola.annecchino@cec.eu.int

**Faqe elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/europeaid/projects/migrations/index_en.htm

### 5.2.2.5 Rehabilitimi dhe rikonstruktimi

*Përgjithësisht vende/rajone të mëposhtëme mund të përfitojnë nga rehabilitimi dhe rikonstruktimi nga Këshilli iI Rregullores 2258/96: Afrikë, Karaibe dhe vendet e Paqësorit, vendet e Mesdheut, vendet e Amerikës latine dhe Azisëdhe vendet në zhvillim të Kaukazit dhe Azisë Qëndrore.*

**19 09 04** – Operacione rehabilitimi dhe rikonstruktimi në vendet në zhvillim të Amerikës Latine
**19 10 04** – Operacione rehabilitimi dhe rikonstruktimi në vendet në zhvillim të Azisë

**Buxheti i dhënë:** p.m. dhe180.00 milion

Këto linja buxheti kanë për qëllim operacionet e rehabilitimit dhe të rikonstruktimit në vendet në zhvillim të Amerikës Latine dhe Azisë, të cilat kanë pësuar dëmtime të rënda nga lufta, konflikte civile ose fatkeqësi. Ndihma për rikonstruktim Pas-Tsunami është përfshirë në një shumë të caktuar dhe i është dhënë një status i veçant. Përgjithë-

sisht operacionet kanë për qellim rivendosjen e ekonomisë punëtore dhe kapaciteteve institucionale dhe plotësimin e nevojave të popullatës së prekur në tërësi. Operacionet duhet të kenë maksimalisht një kohëzgjatje prej 24 muaj, por preferohen projektet afatshkurtër. Operacionet që mbulohen janë:

- Rihedhja e produkteve afatgjatë dhe rehabilitimi i infrastrukturës bazë
- Restaurimi i kapaciteteve institucionale të nevojshëme në perjudhën e rehabilitimit.
- Ri-integrimi social, veçanërisht i refugjatëve personave të shpërngulur dhe trupave të çmobilizuara.
- Furnizimi i invalidve dhe fëmijëve, veçanërisht rehabilitimi i fëmijëve të prekur nga lufta, përfshi fëmijët ushtar
- Mbështetjë për gratë dhe organizatat e grave për të zvogëluar mosbarazinë gjinore në shoqëri

Partnerët bashkëveprues të përshtatëshëm për mbështetje financiare në këtë linjë buxheti janë organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, OJQ-të, departamentet e pushteteve vendore dhe agjencitë, organizatat e mbështetura në komunitet, institute dhe operatorë privat dhe publik. Operacionet duhet të favorizojnë pjesëmarrjen e popullatës përfituese vendase në çdo nivel të vendimmarrjes dhe gjatë fazës zbatuese.

Vlerësimi i projekteve do të marrë parasysh: efektivitetin e operacioneve; aspektet kulturore, sociale, gjinore, dhe mjedisore; zhvillimin institucional të nevojshëm për të arritur qëllimet e projektit; dhe eksperiencën e fituar nga operacione të ngjashme. Sipas Këshillit të Regullores 2258/96, kontributi i partnerëve varet nga gjendja e tyre financiare dhe natyra e projektit.

**Kontaktoni:** Mr Fernando CARDESA GARCIA (Director)
EuropeAid — Directorate B, Latin America
Tel +32 2 299 2329
Fax +32 2 296 1868

Mr Erich Ëilhelm MULLER (Director)
EuropeAid — Directorate D, Asia and Central Asia
Tel +32 2 299 0775
Fax +32 2 296 1430

## **19 08 05** —Operacionet e rehabilitimit dhe rikonstruktimit në Mesdhe dhe Lindjen e Mesme

**Buxheti i dhënë:** p.m.

Këto projekte mbulojnë operacione të ngjashme me ato të Amerikës Latine dhe Azisë dhe ka të bëj me masat për të iniciuar kthimin e jetës normale të njerëzve në vendet mesdhetare jo anëtare dhe në vendet partnere të Evropës Lindore dhe Azisë Qëndrore në situatet që lindin si pasojë e krizave të luftës, konfliktit civil ose fatkeqësive natyrore.

**Kontaktoni:** Mr Angelo BAGLIO
Geographical coordination and supervision for the Mediterranean and Middle East
EuropeAid — A2
Tel +32 2 295 7276
Fax +32 2 296 5336
E-mail angelo.baglio@cec.eu.int

## **21 03 20** —Plan rehabilitimi dhe veprimi në vendet në zhvillim, veçanërisht vendet ACP

**Buxheti i dhënë:** p.m.

Kjo linjë buxheti synon fillimin e kthimit të jetesës normale të njerëzve në vendet në zhvillim, veçanërisht vendet ACP, në krizat e shkaktuara si rrjedhojë e fatkeqësive natyrore, konflikteve të dhunshme ose kriza të tjera. Operacionet që mbulohen janë:

- Rihedhja e produkteve afatgjatë
- Rehabilitimi i infrastrukturës bazë përsfshi çminimin
- Pajtimin qytetar në shoqëri ku ka patur konlikt të dhunshëm
- Ri-integrimin social, në veçanti të refugjatëve, personave të shpërngulur dhe trupave të çmobilizuara
- Restaurimin e kapaciteteve institucionale të nevojëshme në perjudhën e rehabilitimit
- Furnizimi për nevojat e fëmijëve, veçanërisht rehabilitimi i fëmijëve të prekur nga lufta, përfshi fëmijët ushtar (mbulon gjithashtu arsimimin e fëmijëve të prekur nga lufta ose fatkeqësitë natyrore)

- Ndërgjegjësimi ndaj rrezikut që kanoset nga fatkeqësitë natyrore
- Ndihmë për organizatat e invalidve

Në veçanti këto operacione mbulojnë programme dhe projekte të zbatuara nga organizata joqeveritare dhe faktorë të shoqërisë civile dhe pjesëmarrja e popullatës përfituese në çdo nivel të vendimarrjes inkurajohet në çdo fazë të vënies në zbatim.

**Kontaktoni:** Ms Luana CATTARUZZA
Geographical coordination and supervision for ACPs
EuropeAid – C2
Tel +32 2 295 9075
Fax +32 2 298 7200
E-mail luana.cattaruzzza@cec.eu.int

## **19 08 07** –Ndihmë për rehabilitimin dhe rikonstruktimin e Irakut

**Buxheti i dhënë:** 200.00 milion

Këto fonde shkojnë për proçesin e ndihmës së rikonstruktimit të Irakut në zona të tilla si ndërtim i kapaciteteve institucionale, krijimi i një rrjeti të sigurt civil, shëndetësi, uji dhe higjenë publike, arsimim, punësim si dhe forcimin e shoqërisë civile dhe mbrojtje dhe promovim i të drejtave të njeriut dhe demokracisë. Projektet mund të plotësohen me shpenzime nga tituj te tjerë si 23 02 (ndihmë humanitare), 21 02 01 dhe 21 02 02 (operacione të mbështetjes dhe ndihmë në ushqim), 19 04 (të drejtat e njeriut dhe demokracia) dhe 19 02 05 (mekanizmi I reagimit të shpëjt). Paratë shpërndahen kryhesisht nga Fondi Ndërkombëtar i Rikonstruktimit të Mjediseve për Irakun, të administuara nga Kombet e Bashkuara dhe Banka Botërore.

**Kontaktoni:** Ms Patricia LLOMBART CUSSAC (Deputy Head of Unit)
Directorate-General External Relations – F2
Gulf countries, Iran, Iraq and Yemen
Tel +32 2 299 0964
Fax +32 2 296 6611

## **19 10 06** – Ndihmë për rehabilitimin dhe rikonstruktimin e Afganistanit

**Buxheti i dhënë:** 183.00 milion

Këto fonde i jepen proçesit të rikonstruksionit të Afganistanit për operacionetë ngjashme me me ato të linjës së buxhetit më lart. Plotësohet gjithashtu nga shpenzime të titujve të tjerë, përfshirë 23 02 (ndihmë humanitare), 21 02.01 and 21 02 02 (operacione të mbështetjes dhe ndihmës ushqimore) dhe 19 02 05 (mekanizmi i reagimit të shpejt).

Për më tepër mbështet, kthimin e refugjatëve Afgan në vendin dhe rajonin e tyre të origjinës si dhe strategjinë kombëtare për kontrollin e drogave

**Kontaktoni:** Mr Eric Wilhem MULLER (Director)
EuropeAid – Directorate D
Asia and Central Asia
Tel +32 2 299 0775
Fax +32 2 296 3912

## **21 03 17** –Programi evropian për rindërtim dhe zhvillim (EPRD) në Afrikën Jugore

**Buxheti i dhënë:** 132.76 milion

EPRD-ja programi i bashkëpunimit për zhvillim ndërmjet BE-së dhe Afrikës së Jugut, u krijua në vitin 1995 për të zbutur varfërinë, për të stimuluar ekonominë, për të krijuar mundësi punësimi dhe për të nxitur rritjen dhe shoqërinë demokratike. Projektet dhe programet e financuara nga kjo linjë buxheti duhet të mbështesin Strategjinë e Qeverisjes së Afrikës së Jugut dhe në veçanti, programin e Rritjes, Punësimit dhe Rishpërndarjes (GEAR), bazuar në reformat ekonomike, mbështetjen e sektorit privat dhe dhënien e shërbimeve shoqërore bazë. Përparësi do t'i jepet operacioneve që mbështesin pjesët më të varfra të popullsisë dhe të drejtat e fëmijëve dhe vëmendje e veçantë dot'i kushtohet forcimit të kapaciteteve institucionale. Për më tepër, programi do të kontribuojë për konsolidimin e dialogut dhe partneriteteve ndërmjet autoriteteve publike dhe partnerëve e

aktorëve joqeveritarë të zhvillimit.
Megjithatë, kjo linjë buxheti nuk është e hapur drejtpërdrejtë për OJQ-të evropiane, vetëm OJQ afrikanojugore mund t'i marrin këto fonde. Partnerët e pranueshëm për asistencë financiare janë: autoritetet kombëtare, provinciale dhe lokale, organet publike, OJQ-të dhe organizatat në bazë komuniteti, organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, institucionet dhe operatorët publikë dhe privatë. Të paktën 25% e ndihmës së përgjithshme do të akordohet përmes organizatave joqeveritare. Financimi për një projekt që zbatohet nga OJQ-të mund të jetë 100%. Kohëzgjatja e projekteve varet nga natyra e tyre, por normalisht është ndërmjet 3 dhe 5 vjetëve. Zonat aktuale objektiv për projektet përfshijnë shërbimet shoqërore bazë, zhvillimin e sektorit privat, integrimin rajonal dhe qeverisjen e mirë dhe demokratizimin.

Projekt-propozimet duhet të përputhen me përparësitë e Programit Tregues Shumvjeçar, të cilat mund t'i gjeni në:
http://europa.eu.int/comm/development/body/csp_rsp/csp_en.cfm.

**Kontaktoni:** Ms S. WILLEMS (Geographical Coordinator)
Geographical coordination and supervision for ACPs
South Africa, AIDCO – C1
Tel 32 2 299 4658
Fax 32 2 299 6191

EU Delegation in South Africa
1-2 Green Park Estate, 27 George Storrer Drive,
Groenkloof 0181, Pretoria, Republic of South Africa
E-mail delegation-s-africa@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://europa.eu.int/scadplus/leg/en/lvb/r12202.htm
http://www.eusa.org.za/development/Recon&Dev.htm

### 5.2.2.6 Bashkëpunimi me OJQ-të

**21 02 03** — Kontributi i komunitetit në drejtim të skemave që kanë të bëjnë me vendet në zhvillim të kryera nga organizatat joqeveritare

**Buxheti i dhënë:** 210.00 milion

Kjo linjë buxheti bashkëfinancon OJQ-të evropiane për si më poshtë, siç është përcaktuar në Regulloren e Këshillit (KE) 1658/98 të 17 korrikut 1998:

- Operacionet e zhvillimt ekonomik e social nga të cilët përfitojnë njerëzit më të varfër në vendet në zhvillim, veçanërisht grupet më të prekshme
- Skema për të rritur ndërgjegjësimin e publikut evropian për çështjet e zhvillimit në vendet në zhvillim, veçanërisht për marrëdhëniet ndërmjet vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim
- Masat për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet OJQ-ve evropiane dhe partnerëve të tyre në vendet në zhvillim

Theksi kryesor vihet në zbutjen e varfërisë nëpërmjet mbështetjes së njerëzve të pafavorizuar në vendet në zhvillim, me qëllim që të plotësohen nevojat bazë të tyre, të përmirësohet cilësia e jetës dhe të përforcohen kapacitetet e e zhvillimit. Vëmendje e veçantë i kushtohet: operacioneve lidhur me forcimin e shoqërisë civile dhe çuarjen përpara të të drejtave të njeriut dhe demokracisë; rolit të grave në zhvillim; zhvillimit të qëndrueshëm; mbrojtjes së kulturave të kërcënuara; dhe të drejtave të fëmijëve.

OJQ-të evropiane të pranueshme duhet të plotësojnë kërkesat e përshtatshme të transparencës dhe përgjegjshmërisë dhe të kufizojnë shpenzimet e tyre administrative në përqindje minimale të kostove të përgjithshme. Përparësi do t'u jepen aksioneve të kryera bashkërisht nga OJQ-të nga BE-15 dhe nga OJQ-të nga shtetet e reja anëtare.

**Kontaktoni:** Mr Arisotelis BOURATSIS (Head of Unit)
EuropeAid/F2 - Co-financing ëith NGOs
Tel 32 2 299 9244
Fax 32 2 299 2914

E-mail aristotelis.bouratsis@cec.eu.int

Mr Carlos CARDAO (ACP)
E-mail carlos.cardao@cec.eu.int

Ms Ilse TEUFEL (Asia, Middle East & Mediterranean, Neëly Independent States)
E-mail ilse.teufel@cec.eu.int

Mr Paulo CAMPILHO (South and Central America)
E-mail paulo.campilho@cec.eu.int

Vendet në zhvillim dhe edukimi i zhvillimit (kontaktet e shteteve anëtare për OJQ-të)

- Ms Marie-Claire Brenard (Belgium, Italy, Portugal, the Netherlands), marie-claire.brenard@cec.eu.int
- Mr Sandro D'angelo (Greece, Spain and United Kingdom), sandro.dangelo@cec.eu.int
- Ms Simone-Michèle Pierrard (Austria, Denmark, Finland, France, Germany, Ireland, Sëeden), simone-michele.pierrard@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/europeaid/projects/ong_cd/ed_page_en.htm

### 5.2.2.7 Rritja e ndërgjegjësimit

**21 02 06** —Nxitja e barazisë gjinore në bashkëpunimin për zhvillim

**Buxheti i dhënë:** 2.83 milion

Objektivat që duhen ndjekur sipas këtij përcaktimi, në përputhje me qëllimin për nxitjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave siç specifikohet në Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara, janë si më poshtë:

- Të mbështetet perspektiva gjinore në të gjitha fushat e bashkëpunimit për zhvillim, të kombinuar me të gjitha masat në favor të

grave, me synimin për të nxitur barazinë gjinore si një kontribut i rëndësishëm drejt reduktimit të varfërisë.
- Të mbështeten kapacitetet publike dhe private vendase në vendet në zhvillim të cilët mund të marrin përgjegjësinë dhe iniciativën për përkrahjen e barazisë gjinore.

Veprimtaritë e përshtatshme për financim përfshijnë, në veçanti:

- Mbështetja e masave specifike lidhur me futjen në dhe kontrollin e burimeve dhe shërbimeve për gratë p.sh., në fushat e arsimimit, mundësive të punësimit dhe në vendimmarrjen politike;
- Mbështetja e analizës dhe përmirësimit të statistikave të ndara sipas seksit dhe moshës, e zhvillimit dhe shpërndarjes së metodologjive, direktivave, vlerësimet e ndikimit të gjinisë, studimet tematike, treguesit dhe instrumente të tjera operacionale;
- Mbështetja e ngritjes së ndërgjegjësimit dhe të punës së avokatisë.
- Mbështetja e kapaciteteve të aktorëve kyç në procesin e zhvillimit, si sigurimi i specialistit për problemet gjinore, trajnimi dhe asistenca teknike.

Organizatat dhe përfituesit e pranueshëm janë: autoritetet dhe agjencitë administrative në nivel kombëtar, rajonal e lokal të qeverisjes; autoritetet lokale dhe organet e tjera të decentralizuara; komunitetet lokale; OJQ-të, organizatat në bazë-komuniteti, sindikatat, dhe persona të tjerë jopërfitues fizikë dhe juridikë; organizatat rajonale; organizatat ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara dhe agjencitë, fondet dhe programet e tyre, si dhe bankat e zhvillimit, institucionet financiare, iniciativat globale, partneritetet ndërkombëtare publike/private, institutet e studimeve, kërkimeve e zhvillimit dhe universitetet.
Para dorëzimit të projekt-propozimit është mirë të kontaktoni me Delegacionin lokal të BE-së (http://www.europa.eu.int/comm/external_relations/repdel/) dhe të diskutoni projektin. Delegacioni lokal do të përfshihet në proçesin e përzgjedhjes, dhe mund të bëjë të mundur mosdorëzimin e ndonjë projekt-propozimi të papërshtatshëm.

**Kontaktoni:** Ms Daniela ROFI (Coordinator)
Governance, human rights, democracy and gender
EuropeAid – E4

Tel : 32 2 299 4081
Fax : 32 2 295 8051
E-mail daniela.rofi@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/development/body/theme/human_social/pol_gender2_en.htm

### 5.2.2.8 Mjedisi

#### **21 02 05** – Mjedisi në vendet në zhvillim

**Buxheti i dhënë:** 56.61 milion

Së pari, kjo linjë buxheti financon punën që kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm nëpërmjet integrimit të një aspekti mjedisor në procesin e zhvillimit. Veprimtaritë e mbështetura lidhen kështu me çështje të tilla si: ndryshimi i klimës, diversiteti biologjik; çështjet mjedisore ndërkufitare; konservimi; ekositemet detare dhe rajonet bregdetare; burimet ujore; modelet e prodhimit, konsumimit dhe përdorimit të burimeve; produktet energjitike dhe kimike; problemet e mjediseve urbane; ndikimet mjedisore që lidhen me integrimin e vendeve në zhvillim në ekonominë botërore.
Së dyti, konservimi i pyjeve tropikale dhe pyjeve të tjera në vendet në zhvillim në mënyrë që të plotësohen kërkesat ekonomike, sociale dhe mjedisore të përcaktuara për pyjet mbështeten, gjithashtu, nga kjo linjë buxheti. Veprimtaritë që nxiten këtu përfshijnë: zhvillimin e kuadrit të politikave pyjore; konservimin dhe restaurimin e pyjeve me vlera të mëdha ekonomike; përdorimin e qëndrueshëm të pyjeve; mundësia ekonomike e manaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve nëpërmjet përdorimit më të efektshëm të produkteve pyjore dhe përmirësimeve teknike të veprimtarive që lidhen me sektorin pyjor; dhe përmirësimi i njohurive dhe informacionit, si dhe manaxhimi i shërbimeve pyjore.

Lloji i projektit të mundshëm për t'u financuar është i veçantë për çdo kërkesë për projekt-propozime. Kontributi maksimal i BE-së është 80%.

Një pikë kontakti e dobishme për organizatat që punojnë në këtë

fushë është Instituti i Zhvillimit Përtej detit (ODI). Ky institut siguron informacionin për projektet e pyjeve tropikale nga Komisioni dhe shtetet anëtare nëpërmjet Sistemit të tij të Informacionit për Projektet e Pyjeve Tropikale (TROPICS).
Ju lutemi shih Faqen elektronike: http://www.odi.org.uk/tropics/ ose kontaktoni ODI, Tel: 44 (0) 20 7922 0300 për më shumë informacion.

**Kontaktoni:** Mr Frank JACOBS (Programme Manager)
Central management of thematic budget lines
Directorate-General Environment – DGA 04
Tel: 32 2 296 5050
Fax: 32 2 295 7482
E-mail frank.jacobs@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/europeaid/projects/forests/index_en.htm

## **07 02 01** – Kontributi në aktivitetet mjedisore ndërkombëtare, Vendet në zhvillim, Protokolli i UNFCCC dhe i Kyoto-s

**Buxheti i dhënë:** 8.09 milion

Pjesë e linjës së buxhetit 07 02 01 i jepet forcimit të kapacitetit të vendeve kyçe në zhvillim për t'u përgatitur dhe për të marrë pjesë në bisedimet mbi veprimet e ardhshme sipas UNFCCC -së dhe protokollit të saj të Kyoto-s.

Qëllimi është të forcohet kapaciteti analitik në vendet në zhvillim, në veçanti aftësia për të kuptuar aksionet ekzistuese dhe për të zhvilluar projekt-propozime të tjera për aksione të ardhshme sipas Konventës së Kuadrit të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimin e Klimës (UNFCCC) dhe protokollit të saj të Kyoto-s dhe të analizojnë ndryshimin e klimës së tyre dhe ndikimet e zhvillimit të qëndrueshëm, gjithashtu, përmes përdorimit të modeleve ekonomike. Për më tepër, projekti duhet të kontribuojë në forcimin e kapacitetit negociues të vendeve në zhvillim, veçanërisht nëpërmjet rritjes së nivelit të kuptimit të proceseve negociuese, të aftësisë për të reaguar ndaj

projekt-propozimeve të paraqitura nga palë të tjera dhe të aftësisë për të paraqitur dhe mbrojtur projekt-propozimet e tyre. Projekti duhet për më tepër të kontribuojë në ndërtimin e besimit nëpërmjet krijimit të platformave jozyrtare për shkëmbimin e ideve midis vetë vendeve në zhvillim dhe ndërmjet vendeve të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim. Projektet duhet të lidhen me iniciativat dhe proceset ekzistuese dhe preferencë do t'u jepet projekt-propozimeve që përfshijnë disa nga vendet e mëposhtme: Kina, Brazili India, Afrika e Jugut, Korea e Jugut dhe Meksika.

Përfituesi i caktuar është një rrjet institutesh dhe organizatash me të dhëna të shumta në ndërtimin e kapaciteteve në vendet në zhvillim. Rrjeti duhet të demonstrojë se ka një prezencë të fortë në organizata ose se ka lidhje të vendosura me organizatat në vendet në zhvillim. Kontributi maksimal i BE është 80%.

**Kontaktoni:** Mr Jürgen LEFEVERE (Policy Officer)
Climate, Ozone and Energy
Directorate-General Environment — C2
Tel 32 2 296 6525
Fax 32 2 296 9970
E-mail juergen.lefevere@cec.eu.int

**Faqja elektronike:** http://europa.eu.int/comm/environment/funding/intro_en.htm

### 5.2.2.9 Shëndeti dhe arsimimi

#### **21 02 07 02** — Ndihmë për sëmundjet që kanë lidhje me varfërinë (HIV/SIDA, malaria dhe tuberkulozi) në vendet në zhvillim

**Buxheti i dhënë:** 76.06 milion

Kjo shumë e caktuar synohet të përdoret për tri sëmundjet kryesore të transmetueshme, HIV/SIDA, malaria dhe tuberkulozi, në vendet në zhvillim, siç përcaktohet në Rregulloren e Këshillit (KE) 550/97 dhe (KE) 1568/2003. Përparësi u jepet vendeve më të varfra dhe më pak të zhvilluara dhe pjesëve më të prekshme të popullsisë, veçanërisht , grave dhe vajzave. Në veçanti, mbështeten aksionet që plotësojnë

politikat dhe kapacitetet e vendëve në zhvillim dhe asistenca e dhënë përmes instrumenteve të bashkëpunimit për zhvillim.

Qëllimi i veprimtarive të kryera është: të bëhet më efektiv ndikimi i ndërhyrjeve, shërbimeve dhe mallrave ekzistuese që synojnë parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve kryesore të transmetueshme që ndikojnë te popullsia më e varfër; të rritet mundësia për të përballuar medikamentet farmaceutike kryesore dhe diagnostikimin; të rritet puna kërkimore dhe zhvillimi; të shtohen veprimtaritë në fushën e parandalimit të sëmundjes, duke përfshirë testin VCCT, fushatat informative dhe këshillimet midis grupeve meë rrezikshmëri të lartë; të përkrahë fushtatat përr rritjen e ndërgjegjësimit, arsimimit, përpjekjet për informacion dhe komunikim; të integrojë ndjeshmërinë gjinore në programimin e HIV/SIDA; dhe të përkrahë trajnimin për ndërgjegjësimin e udhëheqjes.

Financimi do t'u jepet projekteve të veçantë që çojnë më tej objektivat e mësipërm dhe gjithashtu për iniciativat globale, si Fondi Global. Partnerët e mundshëm për asistencë financiare përfshijnë: autoritetet dhe agjencitë administrative në nivel kombëtar, rajonal e lokal të qeverisjes; autoritetet lokale dhe organet e tjera të decentralizuara; komunitetet lokale; OJQ-të, organizatat në bazë-komuniteti dhe persona të tjerë jopërfitues fizikë dhe juridik nga sektori privat; organizatat rajonale; organizatat ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara dhe agjencitë, fondet dhe programet e tyre, si dhe bankat e zhvillimit, institucionet financiare, iniciativat globale, partneritetet ndërkombëtare publike/private, institutet dhe universitetet kërkimore. Kontributi maksimal i KE është 90%.

**Kontaktoni:** Mr Martyn PENNINGTON (Head of Unit)
Relations with EU institutions, international organisations and donors
EuropeAid – F4
Tel 32 2 299 2597
Fax 32 2 296 7368
E-mail martyn.pennington@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/europeaid/projects/health/index_en.htm

**21 02 07 03** – Ndihmë për popullsinë dhe kujdesi për shëndetitn riprodhues

**Buxheti i dhënë:** 19.49 milion

Kjo linjë buxheti synon nxitjen e njohjes së të drejtës seksuale dhe riprodhuese, mëmësi të sigurtë dhe akses universal në shërbimet shëndetësore të seksit dhe riprodhimit të sigurtë dhe të besueshëm në vendet në zhvillim, mbi bazën e Rregulloreve të Këshillit (KE) 1484/97 dhe (KE) 1567/2003. Përparësi u jepet projekteve për vendet më të varfra dhe më pak të zhvilluara, si dhe pjesës më të pafavorizuar të popullsisë në ato vende.

Mbështetje financiare do të jepet për një gamë të gjerë veprimtarish, veçanërisht, për ato që kërkojnë: të sigurojnë të drejtën e grave, burrave dhe adoleshentëve për shëndetin seksual dhe riprodhues; të bëjnë të mundur përdorimin e një game të gjithanëshme të shërbimeve dhe produkteve të sigurta dhe të besueshme për shëndetin seksual dhe riprodhues; të reduktojnë shkallën e vdekshmërisë së nënës gjatë lindjes, veçanërisht për vendet dhe popullsitë ku kjo shkallë është më e larta; dhe të luftojnë gjymtimin gjenital të femrave.

Financimi sipas kësaj linje buxheti është i hapur për autoritetet administrative në nivel kombëtar, rajonal e lokal; komunitetet lokale; OJQ-të, organizatat rajonale; institutet e universitetet kërkimore; donatorë të tjerë si Kombet e Bashkuara. Shuma maksimale e çdo granti është 90% e kostos së përgjithshme të mundshme.

**Kontaktoni:** Mr Martyn PENNINGTON (Head of Unit)
Relations ëith EU institutions, international organisations and donors
EuropeAid – F4
Tel 32 2 299 2597
Fax 32 2 296 7368
E-mail martyn.pennington@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/europeaid/projects/health/index_en.htm

## **21 02 07 04** —Ndihmë për sëmundjet nga varfëria në vendet në zhvillim, të ndryshme nga HIV/SIDA, malaria dhe tuberkulozi, dhe bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet BE dhe partneriteteve publike-private ndërkombëtare

**Buxheti i dhënë:** 10.00 milion

Veprimtari përgatitore për të luftuar sëmundje të ndryshme nga HIV/SIDA, malaria dhe tuberkulozi, duke plotësuar dhe përforcuar përpjekjet e organizatave dhe shteteve të tjera, financohet nga kjo linjë buxheti. Vëmendje e veçantë u kushtohet kontributeve për programet e imunizimit ndaj sëmundjeve të tilla si fruthi, difteria, tetanozi, pertussis, hepatiti B, hemofiia, gripi B, ethet e verdha, milingjiti dhe sëmundja e induktuar nga pneumokoku.

Objektivi i kësaj veprimtarie përgatitore është përmirësimi i bashkërendimit ndërmjet BE, shteteve anëtare dhe partneriteteve kryesore publiko-private në fushën e shëndetit publik dhe imunizimit dhe sigurimi i më shumë investimeve në sistemin shëndetësor në vendet në zhvillim.
Partnerët e mundshëm për ndihmë financiare përfshijnë: autoritetet dhe agjencitë administrative në nivel kombëtar, rajonal e lokal të qeverisjes; autoritetet lokale dhe organet e tjera të decentralizuara; komunitetet lokale; OJQ-të, organizatat në bazë komuniteti dhe persona të tjerë jopërfitues fizikë dhe juridikë nga sektori privat; organizatat rajonale; organizatat ndërkombëtare të tilla si Kombet e Bashkuara dhe agjencitë e tyre, fondet dhe programet e tyre, si dhe bankat e zhvillimit, institucionet financiare, iniciativat globale, partneritetet ndërkombëtare publike/private, institutet e universitetet kërkimore.

**Kontaktoni:** Mr Martyn PENNINGTON (Head of Unit)
Relations with EU institutions, international organisations and donors
EuropeAid — F4
Tel 32 2 299 2597, Fax 32 2 296 7368
E-mail martyn.pennington@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/europeaid/projects/health/index_en.htm

### 5.2.2.10 Bashkëpunimi i decentralizuar

**21 02 13** – Bashkëpunimi i decentralizuar në vendet në zhvillim

**Buxheti i dhënë:** p.m.

Ky buxhet ka për qëllim forcimin e shoqërisë civile, demokratizimin bazë dhe pjesëmarrjen nëpërmjet rritjes së aftësisë së shoqërisë civile dhe autoriteteve lokale për të vepruar, duke nxitur dialogun ndërmjet qeverisë dhe aktorëve joqeveritarë. Ai përfshin grante për operacione të zhvillimit ekonomik dhe social ku të përfitojnë pjesët më të varfra të popullsisë në vendet në zhvillim, veçanërisht grupet e prekshme. Gjithashtu, të përfshira janë iniciativat e zhvillimit të qëndrueshëm, të ndërmarra nga autoritetet lokale, organizatat dhe grupimet në bazë- komuniteti në vendet në zhvillim.
Veprimtaritë që mbulohen lidhen kryesisht me skema të informacionit, edukimit, kapitalizimit dhe komunikimit, meqënëse objektivi kryesor i këtij programi është që, aktorët potencialë në këtë fushë të kuptojnë më mirë metodën e bashkëpunimit të decentralizuar dhe të bëhen më aktivë në konsultimet lidhur me programet e komunitetit dhe në zbatimin e bashkëpunimit të decentralizuar.

Partnerët e mundshëm për financim nga kjo linjë buxheti janë autoritetet lokale, OJQ-të, organizatat e popujve autokton, shoqatat lokale të sindikalistëve dhe grupet e qytetarëve lokalë, kooperativat, sindikatat, organizatat e grave dhe të të rinjve, institucionet arsimore, kulturore dhe kërkimore dhe kishat. Organizatat evropiane janë të pranueshme për financim nëse ato punojnë në partneritet me një organizatë lokale në vendin përfitues të fondeve. Mesatarisht, OJQ-të duhet të kontribuojë 20% të kostos së përgjithshme të projektit.

Kërkesat për projekt-propozimet manaxhohen nga vendi përfitues dhe datat e kushtet ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin. Përkatësisht, ju lutemi kontaktoni Delegacionin lokal të KE para dorëzimit të projekt-propozimit për të diskutuar projektin (shih www.europa.eu.int/comm/external_relations/repdel për detaje).

**Kontaktoni:** Mr Aristotelis BOURATSIS (Head of Unit)
Relations with civil society and non-state actors

EuropeAid — F5
Tel : 32 2 299 9244, Fax : 32 2 299 2914
E-mail aristotelis.bouratsis@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/europeaid/projects/ong_cd/cdc_page_en.htm

### 5.2.2.11 Të drejtat e njeriut dhe demokracia

INICIATIVA EVROPIANE PËR DEMOKRACI DHE TË DREJTAT E NJERIUT - EIDHR
**19 04 02** — Mbështetja për viktimat nga abuzimet e të drejtave të njeriut
**19 04 03** — Zhvillimi dhe konsolidimi i demokracisë dhe sundimi i ligjit — Respektimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore
**19 04 04** — Mbështetje për veprimtaritë e Gjykatave ndërkombëtare të krimeve dhe Gjykata Ndërkombëtare e Krimeve
**19 04 05** — Mbështetje për një rrjet për parandalimin e konfliktit

**Buxheti i dhënë:** respektivisht 7.00 / 105.41 / 7.00 / 1.50 milionë

Siç përcaktohet në Rregulloren e Këshillit (KE) 975/99 dhe (KE) 976/99 objektivi i programit të EIDHR-it është të nxitë të drejtat e njeriut, demokracinë dhe parandalimin e konfliktit në vendet e treta. Programimi 2005-6 është më i fokusuar se më parë dhe, në përputhje me këtë, fondet tani kanë objektiv një zonë gjeografike më të gjerë me përqendrim më të shumtë në linjat tematike.
Përgjithësisht, EIDHR-i synon: forcimin e demokratizimit, qeverisje të mirë dhe sundimin e ligjit; mbështetjen e abrogimit të dënimit me vdekje si dhe të luftës kundër torturës dhe pandëshkueshmërisë; mbështetja e jurive ndërkombëtare dhe Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve; dhe luftimi i racizmit, ksenofobisë dhe diskriminimit ndaj minoriteteve etnike dhe popullit autokton.

Për t'i bërë objektivat më të qarta dhe më koherente, janë përcaktuar katër fushata tematike: Këto janë:

- Fushata 1: Inkurajimi i zbatimit të drejtësisë dhe sundimit të ligjit
- Fushata 2: Nxitja e kulturës së të drejtave të njeriut
- Fushata 3: Nxitja e procesit demokratik
- Fushata 4: Çuarja përpara e barazisë, tolerancës dhe paqes.

Të gjitha fushatat do të kryhen në nivel global, në nivel të rajoneve të përzgjedhura dhe në nivel të vendeve të caktuara brenda këtyre rajoneve. Konteksti politik dhe fokusi i çdo fushate në rajonet e mëparshme do të përmblidhet shkurtimisht si më poshtë:

- **Azia Qendrore:** Ky rajon do të jetë objektiv i fushatave 2 dhe 3, në nivel rajonal dhe sa të jetë e mundur në nivel vendi. Brenda fushatës 2, mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe ato civile do të jetë shumë e lartë, me synim forcimin e shoqërisë civile, bashkë me mbështetjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut. Fushata 3 do të synojë forcimin e aftësisë së shoqërisë civile për të marrë pjesë në procesin politik dhe për të përmirësuar situatën e lirisë së shtypit dhe të medias.
- **Azia:** Fushatat 2 dhe 4 janë fokusi kryesor për këtë rajon. Gjatë fushatës 2, përveç trajnimit të zyrtarëve kryesorë mbi të drejtat e njeriut, një përpjekje e veçantë do të bëhet në kontekstin e parandalimit të konfliktit. Kjo do të kërkojë përfshirjen e veprimit që i adresohet trafikimit, punës së fëmijëve dhe ushtarëve fëmijë. Gjatë fushatës 4, çështjet kryesore do të përfshijnë diskriminimin. Përveç kësaj, Fushata 1 do të jetë një përparësi, për të inkurajuar ratifikimin e mëtejshëm në fushën e Statutit të Romës mbi Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve dhe mbizotërimi i zbatimit të dëminit me vdekje.
- **Afrika Nënsahariane:** Programimi i EIDHR-it për 2004-2006 do të ketë si objektiv këtë rajon me të gjitha Fushatat, veçanërisht, 3 dhe 4. Gjatë Fushatës 3, veprimtaritë lidhur me vëzhgimet para dhe pas zgjedhore do të mbështeten së bashku me financimet përkatëse të EDF-së. Përveç kësaj, ka veprimtari që lidhen me rritjen e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në qeverisjen demokratike, trajnimin e gazetarëve dhe zhvillimin e medias. Gjatë Fushatës 4, do të trajtohen çështje mbi mirëkuptimin ndëretnik, minoritetet dhe diskriminimi, veçanërisht, me qëllim që të nxitet pajtimi pas konfliktit. Për pjesë të rajonit, ku ka probleme që lidhen me fëmi-

jët dhe konfliktin e armatosur, trafikimin e fëmijëve e grave dhe torturës, do të zbatohet Fushata 2. Gjithashtu, në disa vende të përzgjedhura, do trajtohen çështje të gjymtimit gjenital të femrës dhe mbështetjes së mbrojtësve të të drejtave. Në nivel rajonal, Fushata 1 mund të ketë, gjithashtu, si objektiv mbështetjen për t'iu përmbajtur Statutit të Romës mbi Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve.

- **Amerika Latine, Karaibet:** Fushatat 2 dhe 4 do të jenë fokusi kryesor për këtë rajon. Gjatë Fushates 2, do të mbështeten mbrojtja e të drejtave të fëmijëve, rritja e ndërgjegjësimit për praktikat e trafikimit dhe edukimi për të drejtat e njeriut, duke përfshirë ngritjen e një Programi Master rajonal për të Drejtat e Njeriut. Fushata 4 do të synojë nxitjen e të drejtave të popullit autokton dhe konfliktet etnike që lidhen me to. Në bazë vendi të veçantë, Haiti dhe Kuba do të jenë objektiv i Fushatës 3 për të nxitur zhvillimet demokratike dhe një mbështetje të vazhdueshme për ndërtimin e demokracisë në Guatemala.

Programimi bën dallimin ndërmjet makro- dhe mikro-projekteve. Makro-projektet janë projekte me vëllim mbështetjeje minimal prej €300,000 për aplikuesit e vendosur në BE për të zbatuar projektin, dhe €50,000 për organizatat aplikuese të shoqërisë civile në rajonin ose vendin e mundshëm për destinacionin e projektit. Projektet rajonale ose globale do të jenë makro-projekte nga natyra dhe aplikantët do të trajtohen mbi baza të barabarta, qoftë ky i vendosur në BE ose në një rajon të mundshëm sipas fushatës. Mikro-projektet, nga ana tjetër, janë projekte me një vëllim mbështetjeje ndërmjet €10,000 dhe €100,000, në dispozicion, ekskluzivisht për aplikantët lokalë të shoqërisë civile, brenda një vendi të mundshëm sipas fushatës. Këta aplikantë lokalë, megjithatë, mund të punojnë bashkë me një OJQ evropiane të BE-së.

Duke vlerësuar të gjithë projektet, preferencë do t'u jepet, nëse është e mundur, projekteve që përfshijnë organizatat që përfaqësojnë popujt autokton ose që kanë në focus popujt autokton, si dhe projektet që përfshijnë aspektet e përkrahjes së objektivave të parandalimit të konfliktit dhe zgjidhjes së konfliktit. Për më tepër, vëmendje e veçantë do ti kushtohet sigurisë që barazia gjinore dhe të drejtat e fëmijëve të reflektohen në të gjitha veprimtaritë.
Përfituesit e veprimtarive të kryera nuk duhet të jenë organizata jofitimprurëse, joqeveritare ose institucione të larta arsimore dhe që

normalisht, kanë shtabin e tyre në BE ose në një vend përfitues. Ata mund të përfshijnë: organizatat rajonale ndërkombëtare, autoritetet kombëtare, rajonale e lokale dhe agjencitë zyrtare, organizatat në bazë-komuniteti dhe institutet dhe operatorët e sektorit publik ose privat dhe siguruesit e shërbimeve. Kriteret për zgjedhjen do të përcaktohen qartë në kërkesën për projekt-propozimet.

**Kontaktoni:** Ms Malin STAËE (Head of Section)
Central management of thematic budget lines
EuropeAid — DGA 4
Tel 32 2 298 7017
Fax 32 2 295 7482
E-mail malin.stawe@cec.eu.int

Faqja elektroni:http://europa.eu.int/comm/europeaid/
projects/eidhr/index_en.htm (general)
http://europa.eu.int/comm/europeaid/cgi
/frame12.pl (calls for proposals)

### 5.2.2.12 Minat kundërpersonel

**19 02 04** — Përfshirja e komunitetit në aksionin lidhur me minat kundërpersonel

**Buxheti i dhënë:** 16.80 milion

Baza ligjore për financimin sipas këtij programi janë rregulloret (KE) 1724/2001 dhe (KE) 1725/2001, për periudhën 2002-2009. Përgjithësisht, kjo shumë e akorduar, e cila plotëson skemat për minat sipas programeve të bashkëpunimit, mbulon kontributin e komunitetit për projektet kundër fushave të minuara me mina kundërpërsonel, përsa i përket aksioneve të tilla si: rehabilitimi i viktimave, pastrimi i minave, shkatërrimi i stoqeve dhe edukimi për rrezikun nga minat. Gjithashtu, këtu përfshihen dhe veprimtaritë e OJQ-ve që kërkojnë ngritjen e çështjes së minave tokësore me grupet e armatosura joshtetërorë.

Objektivi i përgjithshëm i Strategjisë Shumëvjeçare 2005-7 është që t'i afrohet synimit për numrin zero të viktimave nga minat tokësore. Përparësitë tematike për këtë periudhë janë: të zvogëlohët kërcënimi nga minat tokësore; të zbuten vuajtjet e viktimave dhe të ndihmohet ri-integrimi social-ekonomik i tyre, si dhe të rriten ndikimet lokale dhe rajonale të kapacitetit të veprimit efektiv të minave. Vendet ku do të përqendrohet programi për 2006 janë Bosnja and Hercegovina, Kolumbia, Kamboxhia, Gjeorgjia, Jemeni, Sudani, Republika Demokratike e Kongos, Burundi, Afganistani dhe Kosova. Që të jenë të pranueshëm për të dorëzuar projekt-propozimet, përfituesit e grantit duhet të jenë: organizata dhe agjenci ndërkombëtare të sektorit publik ose OJQ; të kenë shtabet e tyre brenda Bashkimit Evropian ose në një vend përfitues (me përjashtim të organizatave dhe agjencive ndërkombëtare). Në raste të veçanta, shtabi mund të jetë në një vend tjetër. Kontributi maksimal i KE-së është 90%.

**Kontaktoni:** Mr Lars-Erik LUNDIN (Head of Unit)
Security Policy
Directorate General External Relations – A4
Tel 32 2 296 5081
Fax 32 2 295 0580
E-mail lars-erik.lundin@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/external_relations/mine/intro/index.htm

## 5.2.2.13 Bashkëpunimi brenda zonave gjeografike të veçanta

## Afrika, Karibbean dhe vendet e Paqësorit (Vendet ACP)

- **Marrëveshja Cotonou:**

Marrëveshja Cotonou, pasuese e Konventës më modeste të Lomé , drejton marrëdhëniet ndërmjet vendeve të BE-së dhe të AKP-së. Ajo u vendos për një periudhë 20 vjeçare nga marsi 2000 deri shkurt 2020, dhe hyri në fuqi në prill 2003. I gjithë grupi AKP përfshin 79

vende nga të cilët 77 e firmosën marrëveshjen – Kuba nuk e firmosi dhe Afrika e Jugut mbetet shtet i asocuar, dhe kështu i papërshtatshëm për preferenca tregtare joreciproke dhe futje në Fondin e Zhvillimit Evropian (EDF), megjithatë ajo mund të marrë pjesë në Institucionet Cotonou dhe firmat e Afrikës së Jugut mund të marrin pjesë në tenderat dhe kontratat e EDF-së në të gjitha vendet e tjera te AKP-së.

Marrëveshja Cotonou bazohet në pesë shtylla të ndërvarura, ku zvogëlimi i varfërisë është tema e kryesore që lidhet me të gjitha:

- Dimension politik i gjithanshëm – duke përfshirë respektimin e plotë të të drejtave të njeriut, parimet demokratike dhe sundimin e ligjit.
- Metodat pjesëmarrëse – për të garantuar përfshrjen e shoqërisë civile dhe për të ndihmuar aktorët joshtetërorë në zbatimin e programeve dhe projekteve.
- Një fokus më i madh në zvogëlimin e varfërisë – dukë përfshirë një strategji globale për zhvillimin, dhe tri tema mbi barazinë gjinore, qëndrueshmërinë e mjedisit dhe zhvillimin institucional dhe ndërtimin e kapaciteteve.
- Një kuadër i ri për bashkëpunimin ekonomik e tregëtar – për të nxitur integrimin e butë të vendeve të ACP-së në ekonominë botërore dhe për të rritur kapacitetet e tyre.
- Një reformë të bashkëpunimit financiar – parime të reja drejtuese do të jenë koherenca, fleksibiliteti dhe efikasiteti. Vendi partner duhet të jetë përgjegjës për politikat e veta, dhe akordimet nuk bëhen më në mënyrë automatike. Aktorëve joshtetërorë do t'u jepet akses i drejtëpërdrejtë në burimet.

Marrëveshja mund të rishikohet çdo pesë vjet kur duhet të miratohet një protokoll financiar. Bisedimet e fundit për rishikimin përfunduan në shkurt 2005, qëllimi I të cilave ishtë të rritej efektiviteti dhe cilësia e partneritetit ACP-BE. Rregullimet ishin të kufizuara dhe kryesisht të lidhura me fusha politike ku BE ka ndërmarrë angazhime kohët e fundit p.sh., në fushën e sigurisë ndërkombëtare. Gjithashtu, u nënvizuan çështje të tjera, ndërmjet të cilave Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit dhe një metodë me efektive dhe më fleksibile për investimet dhe zbatimin e tyre.

Dispozitat e përgjithshme të marrëveshjes kanë si synim nxitjen e përfshirjes së shoqërisë civile, të lojtarëve ekonomikë e socialë dhe të sektorit privat brenda partneritetit. Aktorët joshtetërorë inkura-

johen të marrin pjesë aktive në të gjitha aspektet e bashkëpunimit (formulimin, zbatimin dhe vlerësimin). Sipas Marrëveshjes 15% e fondeve duhet të shkojnë për shoqërinë civile dhe projekt programet treguese të paraqitura në komision duhet të identifikojnë aktorët joshtetërorë të përshtatshëm dhe burimet e akorduara për ta. Ka një Strategji të Mbështetjes së Vendit (CSP) për çdo vend. Kjo është një mjet që përdoret për të analizuar situatën dhe përparësitë e një vendi dhe duke identifikuar kështu masat mbështetëse të KE. Programi Tregues Kombëtar (NIP) është pjesë e CSP dhe përcakton hartën e sektorëve që do të marrin ndihmë, jep një grafik të zbatimit dhe specifikon se si do të përfshihen aktorët joshtetërorë në bashkëpunim. Identifikimi dhe përgatitja e programeve dhe projekteve është përgjegjësi e shteteve përkatës të ACP-së ose përfituesve të tjerë të përshtatshëm. Programi Tregues Rajonal (RIP) siguron nje funksion të ngjashëm për përdorimin e burimeve të akorduara për secilin nga gjashtë rajonet e ACP-së.

Çdo shtet i ACP-së cakton një Zyrtar të Autorizuar Kombëtar (NAO) për ta përfaqësuar atë në çdo program që mbështetet nga KE. NAO-ja është përgjegjës për tenderimin, shpenzimet e autorizuara, duke siguruar që projekti dhe programet të zbatohen siç duhet, si dhe për administrimin e marrëdhënieve me aktorët joshtetërorë.

NAO-t dhe informacione të tjera për çdo vend mund të gjenden në linjat nga:
http://europe.eu.int/comm/development/body/country/country_en.cfm

Për tekstin e plotë të Marrëveshjes së Cotonou, ju lutemi vizitoni faqen elektronike të Komisionit evropian: http://europa.eu.int/comm/development/body/cotonou/agreement_en.htm

### ▸ Fondi i Nëntë i Zhvillimit Evropian (EDF):

Asistenca e zhvillimit e KE për vendet e ACP-së sipas Marrëveshjes Cotonou vjen nga EDF-ja, e cila financohet nga kontributet e drejtëpërdrejta nga vendet anëtare. Shumat e paguara nga vendet anëtare variojnë, midis të tjerash, sipas GNPs dhe lidhjet historike me vendet e ACP-së. Gjithsej, është në dispozicion një shumë e konsiderueshme parash sipas EDF—së — sipas EDF-së të nëntë (2000-). Kjo është 13.50 bilionë euro plus afërsisht 2.5 bilionë të mbartura

nga EDF-të e mëparshme. EDF i dhjetë do të sigurojë 22.7 bilionë euro për periudhën 2008-13.
Marrëveshja Cotonou mbështet strategjitë e zhvillimit kombëtar dhe politikat sektoriale, që do të thotë se ka disa projekte të veçantë dhe se ndihma është përqendruar në një grup të kufizuar sektorësh. Përdorimi i "mbështjetjes së buxhetit" si mjet për të garantuar pronësinë, një ndikim më të madh dhe qëndrueshmëri të ndihmës, nxitet në mënyrë aktive në Marrëveshje, ku "mbështetje e buxhetit" nënkupton që KE paguan paratë drejtpërdrejtë në buxhetin e një vendi të ACP-së. Burimet financiare të EDF-së (fondi i zhvillimit evropian) shpërndahen përmes dy instrumenteve: fondit të mbështetjes së zhvillimit afatgjatë (programi i granteve) dhe programi i investimeve.

Fondi i mbështetjes së zhvillimit afatgjatë i lejon vendet e ACP-së të financojnë një gamë të gjerë operacionesh, duke përfshirë projektet industriale, pagesën e borxheve dhe ndihmat humanitare. Shpërndarja e burimeve do të bazohet në kritere sasiore dhe cilësore dhe mbi një vlerësim paraprak të nevojave dhe rezultatet e shtetit të interesuar. Nivelet e rezultateve maten për të siguruar që vendi do të përdorë më së miri burimet. Financimi i projekteve është zëvendësuar tani me mbështetjen e strategjive të sektorit. Si rrjedhim, për shembull në fushën e shëndetit, ndihma nuk jepet më për ndërtimin e spitaleve, por për mbështetjen e politikave të shëndetit. Programi i investimeve financon operacione të zhvillimit të sektorit privat.

### ‣ EDF dhe aktorët joshtetërorë:

Ka tri mënyra që aktorët joshtetërorë të bëhen pjesë e burimeve të EDF-së të dhëna një vendi ose rajoni të caktuar të AKP-së, por në parim, asnjë fond nuk mund t'u paguhet aktorëve joshtetërore pa pëlqimin paraprak të NAO-it. Pas një programi mbështetjeje për aktorët joshtetërorë që janë të përfshirë në NIP dhe janë përcaktuar kriteret dhe përparësitë e përzgjedhjes, kërkesa për projekt-propozimin do të botohet në gazetat lokale.

- Programet e ndërtimit të kapaciteteve për aktorët joshtetërorë: Veprimtaritë mund të përfshijnë përpjekjet për të përmirësuar organizimin dhe përfaqësimin e aktorëve joshtetërorë; për ngritjen e mekanizmave të konsultimit midis aktorëve joshtetërorë; për të mundësuar punën në rrjet; ose për të ndërtuar kapacitetin e tyre për lobing.

- Mikro-projektet dhe programet e bashkëpunimit të decentralizuar në të cilat një fokus i veçantë vihet te veprimi i drejtëpërdrejtë me qëllim lehtësimin e varfërisë (nenet 70 dhe 71 të Marrëveshjes Cotonou).
- Pjesëmarrja në zbatimin e programeve standarde të EDF-së, d.m.th. programet sektoriale ose projektet e zhvillimit të përkrahura nga qeveria e tyre (dhe të përfshira në Programin Tregues Kombëtar).

EDF-ja merr pjesë në financimin e mikro-projekteve me kërkesë të shteteve të ACP-së. Programet për mikroprojektet mbulojnë projekte të vogla, të cilat mund të kenë ndikim ekonomik dhe social në jetën e njerëzve dhe komuniteteve lokale, plotësojnë një nevojë prioritare të demonstruar dhe të vëzhguar dhe ndërmerren me iniciativën dhe pjesëmarrjen aktive të komunitetit lokal që do të përfitojë prej tyre.
Granti (kontribut i EDF-së) nuk duhet të tejkalojë 75%, dhe pjesa e mbetur duhet të sigurohet nga komunitetit lokal I interesuar (në natyrë ose në formën e shërbimeve ose në para në dorë që duhet të korrespondojë me aftësinë e tij për të kontribuar). Në rrethana të caktuara, shtetiti ACP-së mund të kontribuojë me burime financiare osë përmes përdorimit të pajisjeve, shërbimeve dhe furnizimeve publike. Shuma maksimale prej 75% nga EDF-ja nuk përdoret për ndihmë teknike, e cila, zakonisht, kryhet nga ekspertë individualë ose OJQ evropiane. Përparësi u jepet projekteve që sjellin përfitime kolektive me një ndikim social-ekonomik mbi komunitetet lokale dhe operacionet duhet të iniciohen dhe administrohen nga përfituesit.

Grupet e interesit në mikro-projekte mund të jenë aktorë të tillë si: autoritetet lokale, grupe ose shoqata; institute ose kompani që i shërbejnë komunitetit; grupe ose shoqata që nxitin zhvillimin; federata dhe rrjete; dhe operatorë privatë, veçanërisht ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha.

OJQ-të e interesuara duhet të marrin pjesë ose drejtpërdrejtë ose jo drejtëpërdrejtë (për shembull përmes kolegëve lokalë) në Programet e Mikro-projekteve, duhet të kontaktojnë Delegacionin lokal të Komisionit dhe NAO-në përkatës ose Europe Aid - C1- Geographical coordination and supervision for ACPs, Mr Jose Luis Trimino Peres, Tel: 32 2 299 0823, Fax: 32 2 299 6191, E-mail: jose-luis.trimino-perez@cec.eu.int

- **Linjat e buxhetit të BE-së që përdoren për projektet e propozuara nga aktorët joshtetërorë nga vendet e ACP-së dhe nga rajonet e tjera në zhvillim.**

Ju lutemi për më shumë të dhëna për këto programe shihni titujt përkatës të mësipërm. Vetëm partnerët evropianë mund të aplikojnë për linjën e buxhetit 21 02 03; projektet sipas këtyre linjave të buxhetit mund të propozohen nga aktorët joshtetërorë në vendet e ACP-së.

- Kontributi i komunitetit për skemat që kanë të bëjnë me vendet në zhvillim të kryera nga organizata joqeveritare (linja e buxhetit: 21 02 03)
- Produktet e përfshira në Konventën e Ndihmës për Ushqime (linja e buxhetit: 21 02 01)
- Ndihma të tjera në formë produktesh, operacione të mbështetjes, sisteme të paralajmërimit të hershëm dhe transport i mallrave të magazinuara, shpërndarja, masat anësore dhe masat për të monitoruar zbatimin (linja e buxhetit: 21 02 02)
- Demokracia dhe të drejtat e njeriut (linjat e buxhetit 19.04.02, 19.04.03, 19.04.04, 19.04.05)
- Ndihma për popullsinë dhe kujdesi për shëndetin riprodhues (linja e buxhetit: 21 02 07 03)
- Lufta kundër sëmundjeve të varfërisë (HIV/SIDA, malaria, tuberkulozi) (linja e buxhetit: 21 02 07 02)
- Bashkëpunimi i decentralizuar (linja e buxhetit: 21 02 13)
- Mjedisi në vendet në zhvillim (linja e buxhetit: 21 02 05)
- Çështje të integrimit të gjinive në bashkëpunimin për zhvillim (linja e buxhetit: 21 02 06)
- Veprimtaritë e rehabilitimit dhe rindërtimit në vendet në zhvillim veçanërisht në shtetet e ACP-së. (linja e buxhetit: 21 03 20)

Programet e mëposhtme jepen gjithashtu edhe në buxhetin e KE-së:

- Ndihma në rastet e emergjencës – shtetet e ACP-së (Marrëveshja e Cotonou– neni 72), (linja e buxhetit: 21 03 07)
- Ndihma për refugjatët – shtetet e ACP-së, (Marrëveshja e Cotonou– neni 72), (linja e buxhetit: 21 03 09)

Për informacione të përgjithshme rreth EDF–së dhe Marrëveshjes Cotonou, ju lutemi kontaktoni EuropeAid, Unit C – ACP. Aktualisht drejtuesi i seksionit është Mr Gary Quince, Tel: 32 2 295 4859, Fax: 32 2 299 2902, e-mail gary.quince@cec.eu.int.

Gjithashtu, Sekretariati i grupit të Shteteve të ACP-së ndodhet në Bruksel, i cili është një burim i dobishëm informacioni: General Secretariat of the ACP Group of States, 451 Avenue Georges Henri, B-1200 Brussels, email: info@acp.int, Tel: 32 2 743 06 00, Fax: 32 2 735 55 73, Faqja elektronke: http://www.acpsec.org/

Sekretariati i ACP-së dhe Qendra Evropiane për Manaxhimin e Politikave të Zhvillimit (ECDPM) kanë paraqitur Marrëveshjen Cotonou: Udhëzues për përdoruesin për Aktorët Joshtetërorë, i cili është i disponueshëm në Faqen elektronike të ECDPM -së: http://www.ecdpm.org/

**Amerika Latine dhe Azia**

**19 10 01** – Bashkëpunimi financiar dhe teknik me vendet aziatike në zhvillim
**19 10 02** – Bashkëpunimi politik, ekonomik dhe kulturor me vendet aziatike në zhvillim

**Buxheti i dhënë:** 331.87 and 91.00 milion

**19 09 01** – Bashkëpunimi financiar dhe teknik me vendet në zhvillim të Amerikës Latine
**19 09 02** – Bashkëpunimi politik, ekonomik dhe kulturor me vendet në zhvillim të Amerikës Latine

**Buxheti i dhënë:** 213.11 and 84.00 milion

*Vendet e mëposhtme të ALA janë të përshtatshme për financim nga këto linja buxheti: Afghanistan, Argjentina, Bangladeshi, Burma, Butan, Bolivia, Brazil, Kamboxhia, Kili, Kina, Kolumbia, Kosta Rika, Kuba, El Salvadori, Ekuadori, Guatemala, Hondurasi, India, Indonesia, Laosi, Malajzia, Maldives, Meksika, Mongolia, Mianmar, Nepal, Korea e Veriut, Nikaragua, Pakistan, Panama, Paraguai, Peru,Filipine, Sri Lanka, Tailanda, Uruguai, Venezuela, Vietnami and Jemeni.*

- **Bashkëpunimi financiar dhe teknik:**

Linja e buxhetit 19 10 01 (me shtetet aziatike) jepet për skemat e zhvillimit në vendet aziatike në zhvillim, veçanërisht në ato më të varfrat. Qëllimi është të luftohen problemet makro-ekonomike dhe sektoriale dhe të nxitet progresi institucional bashkë me organizimin ekonomik. Për më tepër, forcimi i shoqërive civile në vendet në fjalë është një qëllim i rëndësishëm.
Fushat e interesit nën këtë shumë të dhënë parash mbulojnë fushat e interesit si më poshtë: operacionet e demokratizimit; mundësia për arsimim të grave dhe fëmijëve; mjedisi, duke përfshirë pyjet tropikale: fushatat kundër drogës dhe SID-ës; masat e bashkëpunimit dhe rindërtimit rajonal; diskriminimi kundër grave dhe shfrytëzimi I fëmijëve; politika e mbrojtjes së konsumatorit; dhe të drejtat e njeriut, demokracia dhe sundimi I ligjit.
Inkurajohen veprimtari që kanë lidhje me informacionin dhe trajnimin sepse informacioni dhe komunikimi kanë përdorim më të madh në projekte. Në këtë kontekst, duhet shënuar se masat për ngritjen e profilit ose rritjen e ndërgjegjësimit në bashkëpunimin e BE-së me vendet aziatike në zhvillim, gjithashtu mirëpriten nga kjo linjë buxheti. Meqënëse zhvillimi i shoqërisë civile është një objektiv i rëndësishëm, vemendje të veçantë i kushtohet gjithashtu veprimtarive të OJQ-ve që nxisin dhe mbrojnë të drejtat e grupeve të dobëta, të tilla si gratë, fëmijët, minoritetet etnike dhe njerëzit me aftësi të kufizuar. Së fundi, një pjesë e këtyre fondeve shkojnë për operacionet që ndihmojnë njerëzit në Timorin Lindor
Përdorimi i kësaj linje buxheti varet nga respektimi i parimeve që mbështesin veprimin e Bashkimit Evropian. Mungesa e veprimit për të parandaluar dhe luftuar dhunën e egër ndaj grave (gjuajtja me gurë, ndëshkimi publik, gjymtimi I organeve gjenitale, djegia ose përdhunimi) do të përbëjnë arsyen për pezullimin e ndihmës së BE-së.

Linja e buxhetit 19 09 01 (me shtetet e Amerikës Latine) jepet për skemat e zhvillimit në vendet aziatike në zhvillim, veçanërisht në ato më të varfrat. Ndihma financiare përdoret kryesisht në të mirë të pjesëve më të pafavorizuara të popullsisë, për projekte në fusha të tilla si: mjedisi, duke përfshirë pyjet tropikale; mundësia për arsimim të grave dhe fëmijëve; barazia gjinore ; fëmijët e rrugës; politika e konsumatorit; demokratizimi; bashkëpunimi rajonal: parandalimi i katastrofave; masat e rindërtimit; dhe procesi i paqes në Kolumbi e procesi i demokratizimit në Kubë

Në përgjithësi, qëllimi është të ndihmohet mbështetja institucionale dhe konsolidimi i demokracisë e sundimit të ligjit. Në këtë kontekst, theksi vihet në operacionet për përmirësimin e strukturave dhe operacioneve ekonomike e juridike duke përfshirë zhvillimin dhe bashkëpunimin istitucional me BE-në. Gjithashtu, mbulohen masat për ngritjen e profilit dhe rritjen e ndërgjegjësimit në bashkëpunimin e BE-së me vendet në zhvillim të Amerikës Latine. Objektiva të tjerë të përgjithshëm nën këtë linjë buxheti përfshijnë luftën kundër varfërisë dhe përjashtimit social, standarde të përmirësuara të arsimimit, infrastrukturat e shëndetësisë dhe transportit dhe mbështetja për integrimin rajonal dhe metodat e integruara (duke e lidhur progresin ekonomik me zhvillimin social, mbrojtjen e mjedisit dhe të konsumatorit.
Pra, Inkurajohen veprimtari që kanë lidhje me informacionin dhe të trajnimit sepse teknologjitë e informacionit dhe komunikimit kanë përdorim më të madh në çdo fushë të veprimtarisë. Së fundi, kjo shumë e dhënë parash mbështet, gjithashtu, veprimtaritë e OJQ-ve që nxisin dhe mbrojnë të drejtat e grupeve të dobëta, të tilla si gratë, fëmijët, minoritetet etnike, si p.sh., aksionet që synojnë të ndihmojnë gratë dhe organizatat e tyre për të reduktuar pabarazinë gjinore në shoqëri dhe për të luftuar diskriminimin kundër grave në shoqëri.

Megjithatë, investimet në tokë, të banuara tradicionalisht nga popullsi vendase ose komunitete lokale, dhe projekte të tjera, që ndikojnë në mënyrë të rëndësishme në mjetet e jetesës dhe organizimin social, nuk do të kryhen, sa të jetë e mundur, pa konsultimin dhe pëlqimin paraprak. Për më tepër, përdorimi i këtij buxheti varet në përputhje me kushtet e neneve të demokracisë në marrëveshjet e bashkëpunimit. Mungesa e veprimit për të parandaluar dhe luftuar dhunën e egër ndaj grave (gjuajtja e gurë, ndëshkimi publik, gjymtimi i organeve gjenitale, djegia ose përdhunimi) do të përbëjnë arsyen për pezullimin e ndihmës së BE-së.
Të paktën 10 % e këtyre fondeve duhet përdorur për politikat e mbrojtjes së mjedisit që rrjedhin nga programi Plani i Punës 21 e miratuar nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin dhe Zhvillimin të mbajtur në Rio de Zhaneiro në 3-14 qershor 1992, duke përfshirë projektet e energjisë së riciklueshme për të lehtësuar transferimin e energjisë së riciklueshme dhe me zero emetime dhe teknologjitë përkatëse. Skemat e ndikimeve mjedisore dhe të zhvillimit, të financuara nga ky nen, monitorohen dhe vlerësohen, dhe rezultatet publikohen në raportin vjetor të vlerësimit.

- **Bashkëpunimi ekonomik:**

Linja e buxhetit 19 10 02 (me shtetet aziatike) synon të mbulojë një varitetet operacionesh në formën e ndihmës teknike, trajnimit, përçimit të teknologjisë dhe mbështetja institucionale në fushat e nxitjes së tregëtisë, energjisë, mjedisit dhe administrimit.

Përmirësimi i kontekstit ekonomik, social, kulturor, ligjor, rregullator dhe lehtësimi i marrëdhënieve ekonomike dhe tregëtisë ndërmjet BE-së dhe Azisë janë me interes të veçantë, siç janë dhe çështje ekonomikisht të lidhura të tilla si: integrimi i vendeve më të pazhvilluara në sistemin tregëtar shumëpalësh, duke përfshirë aftësinë e tyre për të marrë pjesë në OBT; ndërtimi i kapaciteteve, veçanërisht lidhur me transferimin e njohurive si dhe bashkëpunimi ndërmjet lojtarëve të biznesit; nxitja e një klime të ekspansionit ekonomik; përdorimi në rritje I teknologjive të informacionit dhe komunikimit; dhe nxitja e praktikave të shëndosha të biznesit nga pikëpamja mjedisore dhe sociale dhe integrimi rajonal. Përveç kësaj, transferimi i energjisë së riciklueshme dhe me emetime zero e BE, financohet në kuadrin e mbështetjes së transferimit të njohurive teknike mbi praktikat më të mira në teknologjitë e pastra dhe nxitësit ekonomikë.

Një pjesë e kësaj shume parash të dhëna ka për qëllim nxitjen e drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit dhe përdorimi I kësaj linje buxheti varet nga respektimi i parimeve që mbështesin veprimin e BE-së

Së fundi, monitorimi i ndikimit të integrimit rajonal në fushat përkatëse mbulohet nga kjo shumë e dhënë. Këtu, fondet janë në dispozicion të organizatave joqeveritare, fondacioneve të njohura politike dhe grupeve ekonomike e sociale të tilla si shoqatat që përfaqësojnë punëdhënësit, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, bujqësia dhe konsumatori, si dhe organizatat ambjentaliste, sindikatat dhe organizatat e ngjashme me to.

Linja e buxhetit 19 09 02 synon të mbulojë një sërë masash që përfshijnë ndihmën teknike, duke përfshirë tejçimin e teknologjisë, në vendet në zhvillim të Amerikës Latine. Mbështetje i jepet integrimit rajonal, bashkëpunimit kulturor, arsimit, trajnimit, bashkëpunimit të biznesit (veçanërisht në lidhje me mbështetjen institucionale në fushat e nxitjes së tregëtisë), energjisë (energjisë së riciklueshme

dhe me emetime zero si dhe teknologjitë që lidhen me të), mjedisit dhe administrimit.

Qëllimi i përgjithshëm është të përmirësohet konteksti ekonomik, social, ligjor, rregullator dhe të lehtësohen marrëdhëniet tregëtare ndërmjet BE dhe Amerikës Latine. Kështu, në synimet e tjera përfshihen: integrimi i vendeve më të pazhvilluara në sistemin tregëtar shumëpalësh, duke përfshirë aftësinë e tyre për të marrë pjesë në OBT; transferimi i njohurive si dhe bashkëpunimi ndërmjet lojtarëve të biznesit; nxitja e një klime të zgjerimit ekonomik; mbështetja për sindikatat, OJQ-të dhe iniciativat lokale për të monitoruar ndikimin e investimeve evropiane në ekonominë kombëtare (veçanërisht mënyrat e sjelljes dhe marrëveshjet sektoriale që përfshijnë respektin për punën, standardet mjedisore, sociale dhe të të drejtave të njeriut); dhe nxitja e praktikave të biznesit, të shëndosha nga pikëpamja mjedisore dhe sociale dhe integrimi rajonal. Përveç kësaj, transferimi i energjisë së ricikluesshme dhe me emetime zero e BE, financohet në kuadrin e mbështetjes së transferimit të njohurive teknike mbi praktikat më të mira në teknologjitë e pastra dhe nxitjet ekonomikë.

*Ashtu si këto linja buxheti, fondet jepen gjithashtu për bashkëpunimin ndërmjet BE dhe vendet e AAL sipas programeve të mëposhtme:*

**Azia Pro Eco II:** Ky program ka për qëllim mbrojtjen dhe rregullimin e mjedisit urban përmes krijimit të partneriteteve dhe rrjeteve. Financimi është në dispozicion për partneritetet BE-Azi për të nxitur shkëmbimin e teknologjive, praktikave më të mira, politikave, masave dhe ndërtimin e kapaciteteve për të mirën e popullsive urbane aziatike. Për kërkesat për propozime ka vetëm një afat për dorëzimin e projekt-propozimeve në 2006, që është 1 qershor 2006. Programi është i hapur për organizatat publike jofitimprurëse aziatike dhe evropiane. Për më shumë informacion, ju lutemi shikoni http://europa.eu.int/comm/europeaid/projects/asia-pro-eco2/index_en.htm.

**Urb-AL:** Ky është një program bashkëpunimi për të mbështetur krijimin e partneriteteve ndërmjet autoriteteve lokale në qytete, zona urbane dhe rajone të tjera në BE dhe në Amerikën Latine. Që nga 1995, Urb-Al ka sjellë më shumë se 430 autoritete lokale rreth

projekteve për problemet e drogës, mjedisit, pjesëmarrjes qytetare, lehtësimit të varfërisë, transportit, sigurisë, urbanistikës, zhvillimit ekonomik, shoqërisë së informacionit dhe të demokracisë. Rrjetet punojnë si kuadre të përhershëm të bashkëpunimit të llojeve të ndryshme, veçanërisht në projekte të përbashkëta për të përdorur idetë e fituara nga rrjetet tematike dhe sjelljen në to të shoqatave, universiteteve, qendrave kulturore, shkencore dhe teknike, firmave dhe OJQ-ve. Për informacione të mëtejshme rreth këtij programi: E-mail: europeaid-urb-al@cec.eu.int Faqja e Internetit: http://europa.eu.int/comm/europeaid/projects/urbal/index_en.htm

Programi Azia IT&C (Faza II): Azia IT&C është një program për të lidhur Evropën dhe Azinë përsa i përket kërkimeve për risi dhe zgjidhje të përshtatshme në IT & C. Ky program tashmë është i mbyllur. Megjithatë, deri në 2005-ën, projektet që i kushtojnë vemendje të veçantë ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SMEs) dhe njohin rolin kyç që luhet nga sektori i informacionit dhe teknologjisë në nxitjen e tregëtisë dhe investimeve, në mirëkuptimin reciprok ndërmjet BE-së dhe Azisë, do të jenë të përshtatshëm sipas Programit të Investimeve të Azisë. Për më shumë hollësi ju lutemi shikoni http://europa.eu.int/comm/europeaid/projects/asia-invest/html2002/main.htm

**Asia-Link:** Ky program synon nxitjen e ngritjes së rrjeteve rajonale dhe shumëpalëshe ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë në shtetet anëtare të BE-së dhe në Azi me qëllim mbështetjen e partneriteteve dhe të lidhjeve të reja dhe ekzistuese ndërmjet institucioneve evropiane dhe aziatike të arsimit të lartë. Për më shumë informacion, E-mail: europeaid-asia-link@cec.eu.int, Faqja elektronike: http://europa.eu.int/comm/europeaid/projects/asia-link/index_en.htm

Kërkesat për propozimet për grante dhe tendera për projektet AAL publikohen në Faqja elektronike EuropeAid:
http://www.europa.eu.int/comm/europeaid/cgi/frame12.pl

**Kontaktoni:** Mr Vincent PIKET (Head of Unit)
EuropeAid – D2, Asia
Tel : 32 2 299 0430
Fax : 32 2 298 4863
E-mail vincent.piket@cec.eu.int, europeaid-asia-pro-eco@cec.eu.int

Mr Riccardo GAMBINI (Head of Unit)
EuropeAid — B2, Latin America
Tel : 32 2 299 1760
Fax : 32 2 299 1080
E-mail riccardo.gambini@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/europeaid/projects/asia/index_en.htm (Azia)
http://europa.eu.int/comm/europeaid/projects/amlat/index_fr.htm (Amerika Latine)

# KAPITULLI 6

# Ndihmë Para-Pranimit, Ndihma per Ballkanin Perendimor dhe Politika Evropiane e Fqinjesise

## 6.1 NDIHMA E PARA-PRANIMIT

Ju lutemi vini re që programet e PHARE, CARDS, SAPARD and ISPA, si dhe ndihma ndaj Turqisë do të jenë në veprim deri në fund të 2006-s, kur ato do të bashkohen së bashku në Instrumentin e ri të Ndihmës së Para-pranimit (IPA).

**Ju lutemi vini re që programet e PHARE, CARDS, SAPARD and ISPA, si dhe ndihma ndaj Turqisë do të jenë në veprim deri në fund të 2006-s, kur ato do të bashkohen së bashku në Instrumentin e ri të Ndihmës së Para-pranimit (IPA).**

### 6.1.1 INSTRUMENTI PËR NDIHMEN E PARA-PRANIMIT (IPA)

Si pjesë e përgatitjes për Kuadrin e ri Financiar 2007-2013, propozimi për Instrumentin e ri të Ndihmës së Para-pranimit (IPA) u prezantua nga Komisioni në Parlamentin dhe Këshillin Evropian në shtator 2004. Rregullorja e Këshillit të IPA-së (KE) Nr. 1085/2006 u përshtat në 17 qershor 2006.

Spas IPA-së, vendet përfituese do të ndahen në dy kategori:
- *Vendet kandidate të mundshme* (Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia, duke përfshirë Kosovën) do të vazhdojnë të marrin ndihmë sipas objektivave dhe përparësive aktuale të **CARDS.**

**Spas IPA-së, vendet përfituese do të ndahen në dy kategori:**

**• Vendet kandidate të mundshme (Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia, duke përfshirë Kosovën)**

**• Vendet kandidate (Kroacia, Turqia dhe Ish-republika Jugosllave e Maqedonisë)**

- *Vendet kandidate* (Kroacia, Turqia dhe Ish-republika Jugosllave e Maqedonisë) do të marrin ndihmë të ngjashme dhe të mëtejshme përsa i përket zbatimit të acquis dhe në përgatitjen për fondet Strukturore Rurale dhe të Zhvillimit pas pranimit.

### *Fushat që do të mbështeten nga IPA-ja*

Ndihmesa do të përdoret në vendet kandidate dhe kandidate të mundshme për të mbështëtur fushat e mëposhtme:
- Forcimi i institucioneve demokratike, si dhe sundimi i ligjit duke përfshirë edhe përforcimin e ligjit;
- Nxitja dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut si dhe respektimi në rritje për të drejtat e minoriteteve, nxitjen e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimin;
- Reforma e administrimit publik, duke përfshirë krijimin e një sistemi që mundëson decentralizimin e administrimt të ndihmës nga vendi përfitues;
- Reforma ekonomike;
- Zhvillimi i shoqërisë;
- Pajtimi, masat e ndërtimit të besimit, rindërtimi;
- Bashkëpunimi ndërkufitar dhe rajonal.

Në rastin e vendeve kandidate do të mbështeten si shtesë fushat e mëposhtme:
- Adoptimi dhe zbatimi i acquis communautaire
- Mbështetja për politikat e zhvillimit si dhe përgatitja për zbatimin dhe administrimin e politikave të përbashkëta të kohezionit dhe të bujqësisë së Komunitetit.

Në rastin e vendeve kandidate të mundshme do të mbështeten si shtesë fushat e mëposhtme:
- Barazimi progresiv me acquis communautaire
- Zhvillimi social, ekonomik dhe territorial duke përfshirë infra-strukturën, dhe veprimtaritë që lidhen me investimet, në veçanti në fushat e burimeve njerëzore e rajonale dhe ato të zhvillimit rural.

### *5 komponentët e IPA-së*

Për të arritur objektivat e çdo vendi në mënyrë më efektive IPA-ja përbëhet nga 5 komponentë të ndryshëm:

1. Ndihma për tranzicionin dhe ndërtimni e institucioneve
2. Bashkëpunimi ndërkufitar

Dy komponentët e parë janë të hapur për të gjitha vendet përfituese (kandidate dhe kandidate të mundshme) me qëllim që ata të ndihmohen në proçesin e tranzicionit dhe afrimin në BE, si dhe për të inkurajuar bashkëpunimin rajonal ndërmjet tyre.

3. Zhvillimi rajonal
4. Zhvillimi i burimeve njerëzore
5. Zhvillimi rural

Komponentët e zhvillimit rajonal, zhvillimit të burimeve njerëzore dhe zhvillimit rural do të jenë të hapur vetëm për vendet kandidate. Këto komponentë synojnë të përgatisin vendet kandidate për zbatimin e politikave të kohezionit dhe të bujqësisë të BE-së pas pranimit. Kjo kërkon që vendi të ketë kapacitete dhe struktura administrative për të marrë përgjegjësinë për administrimin e ndihmës. Në rastin e vendeve kadidate të mundshme, masa të tilla do të zbatohen përmes asistencës së tranzicionit dhe komponentit të ndërtimit të institucioneve.

**5 komponentët e IPA-së:**

***1. Ndihma për tranzicionin dhe ndërtimni e institucioneve***
***2. Bashkëpunimi ndërkufitar***
***3. Zhvillimi rajonal***
***4. Zhvillimi i burimeve njerëzore***
***5. Zhvillimi rural***

*Kuadri politik dhe strategjik për ndihmën*

Përparësitë e përgjithshme politike për para-pranimin janë të përcaktuara në Partneritetet Evropiane dhe të Pranimit, në raportet vjetore të vendeve dhe në dokumentetet e strategjisë së zgjerimit të përmbledhura në paketën e zgjerimit të paraqitur në Këshillin dhe Parlamentin Evropian çdo vit.

*Shuma e referencës financiare*

Përsa i përket shpërndarjes financiare, IPA-ja do të japë një shumë totale prej 11.468 bilionë eurosh (çmimet aktuale për periudhën 2007-2013.

Çdo vit, Komisioni informon Këshillin dhe Parlamentin Evropian mbi synimet e tij lidhur me ndarjen e paketës së përgjithshme. Për këtë, një kuadër i treguesit financiar shumëvjeçar është krijuar, me bazë tre-vjeçare, për çdo vend e çdo komponent.

## *Kuadri i treguesit financiar shumëvjeçar (MIFF)*

**Përsa i përket shpërndarjes financiare, IPA-ja do të japë një shumë totale prej 11.468 bilionë eurosh (çmimet aktuale për periudhën 2007-2013.**

Kuadri i treguesit financiar shumëvjeçar (MIFF) për Instrumentin e Ndihmës së Para-pranimit (IAP) shërben për të dhënë informacion mbi ndarjen treguese të paketës së përgjithshme të IPA-së të propozuar nga Komisioni në përputhje më nenin 5 të Rregullores së IPA-së (KE) 1085/2006. Ai vepron si një lidhje ndërmjet kuadrit politik brenda paketës së zgjerimit dhe procesit të buxhetimit.

## *Paraqitja e shifrave*

Tabela e mëposhtme jep shifrat e mësipërme në çmimet aktuale dhe në *milionë euro.* Aty paraqiten fondet e shpërndara për çdo vend dhe komponent, si dhe programet rajonale e shumëvendëshe dhe shpenzimet mbështetëse.

## *Paketa për programet rajonale dhe horizontale*

Programet rajonale dhe shumëvendëshe do të përfshijnë veprimtari të ngjashme me programet rajonale sipas CARDS dhe paketës shumëvendësh sipas programit PHARE dhe instrumenteve të parapranimit të Turqisë. Niveli i financimit është i tillë që të dyja llojet e aksioneve janë të mundshme. Që nga 2006, ka patur një përfshirje në rritje të Institucioneve Financiare Ndërkombëtare në para-pranimet, duke përfshirë dhe një instrument të ri për efektshmërinë e energjisë. Shifrat pasqyrojnë nevojën në rritje për programe të tilla. Heqja graduale e administratave të përkohshme civile do të financohet gjithashtu nga ky zarf. Programet e financuara nga ky zarf do të jenë plotësuese për programet kombëtare dhe do të jenë të përshtatshme vetëm nëse ata japin një vlerë të shtuar në procesin e para-pranimit.

**Kuadri Financiar Tregues shumëvjeçar**

Ndarja e instrumentit për zarfin e ndihmës së para-pranimit për vitet 2008-2010 në shpërndarjen për çdo vend dhe komponent

| Vendi | Komponenti | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 |
|---|---|---|---|---|---|
| **TURQIA** | Ndihmë përTranzicionin dhe Ndërtimin e Institucioneve | 252.2 | 250.2 | 233.2 | 211.3 |
| | Bashkëpunimi Ndërkufitar | 6.6 | 8.8 | 9.4 | 9.6 |
| | Zhvillimi Rajonal | 167.5 | 173.8 | 182.7 | 238.1 |
| | Zhvillimi i Burimeve Njerëzore | 50.2 | 52.9 | 55.6 | 63.4 |
| | Zhvillimi Rural | 20.7 | 53.0 | 85.5 | 131.3 |
| | **Totali** | **497.2** | **538.7** | **566.4** | **653.7** |
| **KROACIA** | Ndihma për Tranzicionin dhe Ndërtimin e Institucioneve | 47.6 | 45.4 | 45.6 | 39.5 |
| | Bashkëpunimi Ndërkufitar | 9.7 | 14.7 | 15.9 | 16.2 |
| | *Zhvillimi Rajonal* | 44.6 | 47.6 | 49.7 | 56.8 |
| | Zhvillimi i Burimeve Njerëzore | 11.1 | 12.7 | 14.2 | 15.7 |
| | Zhvillimi Rural | 25.5 | 25.6 | 25.8 | 26.0 |
| | **Totali** | **138.5** | **146.0** | **151.2** | **154.2** |
| **ISH-REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË** | Ndihma për Tranzicionin dhe Ndërtimin e Institucioneve | 41.6 | 39.9 | 38.1 | 36.3 |
| | Bashkëpunimi Ndërkufitar | 4.2 | 5.3 | 5.6 | 5.7 |
| | Zhvillimi Rajonal | 7.4 | 12.3 | 20.8 | 29.4 |
| | Zhvillimi i Burimeve Njerëzore | 3.2 | 6.0 | 7.1 | 8.4 |
| | Zhvillimi Rural | 2.1 | 6.7 | 10.2 | 12.5 |
| | Totali | 58.5 | 70.2 | 81.8 | 92.3 |
| SERBIA | Ndihmë përTranzicionin dhe Ndërtimin e Institucioneve | 178.5 | 179.4 | 182.6 | 186.2 |
| | Bashkëpunimi Ndërkufitar | 8.2 | 11.5 | 12.2 | 12.5 |
| | TotalI | 186.7 | 190.9 | 194.8 | 198.7 |
| MALI I ZI | Ndihmë për Tranzicionin dhe Ndërtimin e Institucioneve | 27.5 | 28.1 | 28.6 | 29.2 |
| | Bashkëpunimi Ndërkufitar | 3.9 | 4.5 | 4.7 | 4.8 |
| | TotalI | 31.4 | 32.6 | 33.3 | 34.0 |
| KOSOVA | Ndihmë për Tranzicionin dhe Ndërtimin e Institucioneve | 60.7 | 62.0 | 63.3 | 64.5 |
| | Bashkëpunimi Ndërkufitar | 2.6 | 2.7 | 2.8 | 2.8 |
| | TotalI | 63.3 | 64.7 | 66.1 | 67.3 |
| **BOSNJE & HERCEGOVINA** | **Ndihmë për Tranzicionin dhe Ndërtimin e Institucioneve** | **58.1** | **69.9** | **83.9** | **100.7** |
| | Bashkëpunimi Ndërkufitar | 4.0 | 4.9 | 5.2 | 5.3 |
| | TotalI | 62.1 | 74.8 | 89.1 | 106.0 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **SHQIPËRIA** | **Ndihmë për Tranzicionit dhe Ndërtimin e Institucioneve** | **54.3** | **61.1** | **70.9** | **82.7** |
| | Bashkëpunimi Ndërkufitar | 6.7 | 9.6 | 10.3 | 10.5 |
| | Totall | 61.0 | 70.7 | 81.2 | 93.2 |
| **Programet Totale t Vendit** | | **1098.7** | **1188.6** | **1263.9** | **1399.4** |
| **Programet rajonale dhe horizontale** | | 100.7 | 140.7 | 160.0 | 157.7 |
| KOSTOT ADMINISTRATIVE | | 55.8 | 54.0 | 56.5 | 64.6 |
| **SHUMA E PERGJITHSHME** | | **1255.2** | **1383.3** | **1480.4** | **1621.7** |

**Kontaktoni:**

**Anne-Marie MASKAY – WALLEZ**
IPA coordination
DG Enlargement
Unit D1- Financial instrument cooerdination
Tel: 32 2 2992350
E-mail: anne-marie.maskay-wallez@cec.eu.int

**Rainer EMSCHERMANN**
Pikë kontakti e IAP-së, çështjet për Ballkanin Perëndimor dhe Kontrollit Financiar në lidhje me negociatat e kapitullit 32.
DG Enlargement
Unit D1- Financial instrument cooerdination
Tel: 32 2 2981707
E-mail: rainer.emschermann@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://ec.europa.eu/enlargement/financial_assistance/ipa/index_en.htm

## 6.1.2. EUROPA QENDRORE E LINDORE

### Ndihmë për para-pranimin e Rumanisë (22 02 01 01)
### Ndihmë për para-pranimin e Bullgarisë (22 02 01 02)
### Ndihmë për para-pranimin e Kroacisë (22 02 01 03)
### Bashkëpunimi ndërkufitar për Evropën Qendrore e Lindore (22 02 02)

**Buxheti i dhënë:** 447.42 / 247.36 / 60.16 / 100.00 milionë respktivisht

**6.1.2.1. Programi PHARE:**

Programi PHARE është një nga tre instrumentet e para-pranimit të financuar nga Komunitetet Evropiane për të ndihmuar vendet kandidate në përgatitjet e tyre për futjen në BE. Pas zgjerimit të 2004, tetë nga dhjetë vendet e zgjedhur të përshtatshëm janë tani Shtete Anëtare të BE-së dhe, përkatësisht, Bullgaria dhe Rumania mbeten përfituesit e vetëm për projektet e reja nga këto vende. Pas hapjes së bisedimeve të pranimit ndërmjet BE-së, Kroacisë dhe Turqisë në 3.10.2005, Kroacia është tani e pranueshme për të tre instrumentet financiare të pranimit (PHARE, ISPA dhe SAPARD). Turqia trajtohet në veçanti sipas linjës së buxhetit 22 02 04 (Ju lutemi shikoni më poshtë për përshkrimin).

**Programi PHARE është një nga tre instrumentet e para-pranimit të financuar nga Komunitetet Evropiane për të ndihmuar vendet kandidate në përgatitjet e tyre për futjen në BE. Pas zgjerimit të 2004, tetë nga dhjetë vendet e zgjedhur të përshtatshëm janë tani Shtete Anëtare të BE-së dhe, përkatësisht, Bullgaria dhe Rumania mbeten përfituesit e vetëm për projektet e reja nga këto vende.**

Perspektiva financiare aktuale për 2000-6 arrin shumën e një buxheti vjetor prej €1.56 bilionë (me çmimet e 1999). Masa të ndryshme janë përdorur për të ndihmuar në shpërndarjen e fondeve sipas fushave ku ndihma nevjitet më shumë: përparësitë e parapranimit janë përcaktuar në Hartat Rrugore dhe Partneritetet e Pranimit, të cilat i drejtohen çështjeve kryesore të çdo vendi kandidat dhe burimeve në dispozicion. Përveç kësaj, një grafik për përgatitjen e pranimit është përcaktuar në Programin Kombëtar për Adaptimin për ***Acquis***. Mbështetja financiare bazohet në parimin e trajtimin të barabartë, pavarësisht nga koha e parashikuar e pranimit, ku vëmendje e veçantë i kushtohet vendeve me nevoja më të mëdha. Kështu, Hartat Rrugore të përgatitura për Bullgarinë dhe Rumaninë në vitin 2002 përfshinë ndihmesën në rritje për para-pranimin me qëllim që të çohet përpara proçesi i pranimit të këtyre vendeve. Traktati i Pranimit u nënshkrua nga shtetet anëtare të BE dhe Bullgaria e Rumania

në 25 prill 2005, dhe vendet që pritet të anëtarësohen në 2007.
Ka dy lloje përparësish për veprimtaritë sipas programit PHARE :

**PHARE I — Ndërtim i institucioneve (rreth 30% të burimeve)**
Përforcimi i kapacitetit institucional dhe administrativ i vendeve aderuese është kërkesë kryesore për zgjerimin, me qëllim që vendet të adoptojnë, zbatojnë dhe të jenë në përputhje me ***acquis.*** Kjo kërkon modernizimin e administratave të tyre dhe të strukturave juridike, e në disa raste struktura tërësisht të reja administrative. Ndërtimi i Institucioneve realizohet kryesisht përmes programeve të mëposhtme, duke venë më shumë theksin tek transferimi i njohurive praktike si:

- Marrëveshjet e binjakëzimit ndërmjet ministrive, institucioneve, organizatave profesionale (p.sh., partnerët juridikë dhe socialë), agjencitë, organet rajonale dhe evropiane dhe autoritetet lokale, në veçanti përmes lëvizjes së zyrtarëve nga shtetet anëtare, të plotësuara, sipas nevojave, nga detyra dhe trajnime afatshkurtra.
- Mbështetja teknike në ***acquis*** përmes TAIEX (Zyra e Shkëmbimit të Informacionit mbi Asistencën Teknike)
- Ndihma për të zhvilluar mjediset e trajnimit të administratës publike në nivelet rajonale dhe qendrore.

PHARE mbështet gjithashtu ndërtimin e institucioneve përmes investimeve, d.m.th, mbështetja për institucionet rregullatore kryesore.

Përgjithësisht, qëllimi është të zbatohet ***acquis*** dhe të përgatiten për pjesëmarrjen në politikat e BE, dhe për të plotësuar kriteret e Kopenhagenit, d.m.th, stabiliteti i institucioneve që garantojnë demokraci, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe respektimi për minoritetet. Përveç asistencës që mund të jepet nga qeveritë për këtë qëllim, asistencë financiare dhe teknike u jepet gjithashtu organizatave joqeveritare me qëllim që: të mbështesin praktikat demokratike dhe sundimin e ligjit, të forconjë kapacitetin institucional të OJQ-ve dhe partnerëve socialë dhe të mbështesin përfshirjen dhe pjesëmarrjen e të gjithë individëve dhe grupeve.

**PHARE II – Investimet në kohezionin ekonomik e social**
(70% e burimeve):
Kohezioni ekonomik dhe social nxitet me qëllim që të ndihmohen vendet aderuese të ndërtojnë një ekonomi tregu funksionale dhe të përballojnë forcën e tregut evropian dhe trysninë konkurruese. PHARE II kërkon të sigurojë që ndërmarrjet dhe infrastruktura në shtetet përkatëse të plotësojnë standardet e Komunitetit dhe të krijojnë një kuadër institucional dhe rregullator funksional.
Përparësitë dhe programimi kombëtar I çdo vendi janë përcaktuar në Planin e Zhvillimit Kombëtar, I cili është një strategji e gjithanëshme për të nxitur konkurrencën dhe, nga ana tjetër, të reduktojë mospërputhjet e brendshme. Ky është nxjerrë nga vetë vendet dhe programimi dhe zbatimi pritet të kryhen jo vetëm nga autoritetet kombëtare, por edhe nga autoritetet lokale e rajonale. Aktorët joqeveritarë përkatës mund të marrin pjesë gjithashtu në këtë proces. PHARE nuk mbështet financimin e projekteve në fushat e transportit, mjedisit ose bujqësisë, përveç infrastrukturës rregulluese, e cila nuk është e përshtatshme për ISPA ose SAPARD.

**Programet PHARE shumëvendshe:**
Ndihmesa sipas programeve shumëvendshe është integruar në programet kombëtare në një shkallë të gjerë dhe, kështu, ato mund të jenë të mundshme vetëm kur përshtatshmëria e tyre demonstrohet veçanërisht ose kur ato janë mjetet më të efektshme për arritjen e një rezultati të caktuar. Disa programe vazhdojnë të zbatohen, më i madhi i të cilëve mbështet ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SMEs). Këto Programet e SMEs janë zhvilluar bashkë me Institucionet Financiare Ndërkombëtare në funksion të inkurajimit të bankave të ndërmjetme për të siguruar financa për SMEs në vendet partnere. Ka gjithashtu Programe Shumëvendëshe, veçanërisht në fushat e infrastrukturës bashkiake dhe luftës kundër mashtrimeve.
Për informacione të mëtejshme referohuni:
http://europa.eu.int/comm/enlargement/pas/phare/programmes/index.htm

**Bashkëpunimi ndërkufitar (CBC):**
CBC i programit PHARE ndihmon rajonet kufitare të kapërcejnë probleme të veçanta dhe synon parandalimin e emergjencës në zonat ekonomike periferike, me qëllim integrimin më të ngushtë të vendeve kandidate dhe BE. Pas zgjerimit të 2004, përfituesit e BN-së u zgjeruan për të përfshirë kufirin bullgar me Turqinë dhe kufijtë

bullgarë dhe rumunë me vendet e tyre fqinje të TACIS dhe CARDS (Ukraina, Moldavia, Serbia & Mali i Zi, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë). Zgjerimi i rajoneve të Bullgarisë dhe Rumanisë që janë në kufi me vendet NIS perëndimore dhe Ballkanin Perëndimor ka marrë një shtytje të mëtejshme nga Komunikata " Shtruarja e rrugës për Instrumentin e Fqinjësisë së Re", informacion për të cilin mund të gjendet në kapitullin e Fondeve Strukturorë të këtij udhëzuesi (Shih kapitullin 3).

Zbatimi i programeve PHARE: Komisioni do të vazhdojë të mbikëqyrë zbatimin e programeve PHARE sipas sistemit të zbatimit të decentralizuar, d.m.th., Delegacionet e BE-së në çdo vend. Pika kontakti për delegacionet e BE-së:

Bullgaria: Dimitris KOURKOULAS, Head of Delegation
9, Moskovska St., 1000 Sofia
Tel: 359 2 933 5252
Fax: 359 2 933 5233
e-mail: delegation-bulgaria@cec.eu.int
**Faqja elektronike:** http://www.evropa.bg

Rumania: Jonathan SCHEELE, Head of Delegation
18 Jules Michelet Street, 1st District
010463 Bucharest
Tel: 40 21 203 5400
Fax: 40 21 230 2453
E-mail: delegation-romania@cec.eu.int
**Faqja elektronike:** http://www.infoeuropa.ro/jsp/default.jsp

Kroacia: Jacques WUNENBURGER, Head of Delegation
Masarykova 1, 10000 Zagreb
Tel: 385 148 96 500
Fax: 385 148 96 555
E-mail: delegation-croatia@cec.eu.int
**Faqja elektronike:** http://www.delhrv.cec.eu.int

Struktura e mëposhtme vazhdon të kërkohet në çdo vend kandidat për zbatimin e programeve PHARE:

1. Një Fond Kombëtar (NF), nën përgjegjësinë e zyrtarit të auto-

rizuar kombëtar (NAO), të vendosur brenda Ministrisë së Financave administron fondet e dhëna.
2. Numri i agjencive zbatuese, përmes të cilave zbatohet programi PHARE në çdo vend nën autoritetin e NAO-ut duhet të vazhdojnë të kufizohet në mënyrë rigoroze.
3. Njësitë Qendrore të Financës dhe Kontraktuale (CFCUs) do të vazhdojnë të përdoren për të kryer tenderimet dhe kontraktimet e programeve specifike të adresuara për sektorë të shumtë si në Ndërtimin/ Binjakëzimin e Institucioneve. Përzgjedhja dhe monitorimi i projektit mbetet përgjegjësi e Ministrive/ administratave që përfitojnë drejtpërdrejtë nga asistenca.

Ndihma do të vazhdojë të kontraktohet mbi bazën e proçedurave ekzistuese, në përputhje me Rregulloren Financiare të Komuniteteve Evropiane dhe Rregullat e zbatimit të saj, i cili mund të shihet në http://europa.eu.int/comm/europeaid/tender/gestion/index_en.htm.

Duke shkuar drejt metodës programatike të Fondeve Strukturore, skemat e granteve janë paraqitur në kuadrin e investimeve të Kohezionit Ekonomik dhe Social. Skemat e granteve përdoren ku projektet janë shumë të vogla për t'u identifikuar apriori ose janë shumë të vogla për t'u administruar me kosto efektive mbi baza individuale. Skemat e granteve duhet të përdoren për një përparësi të qartë brenda Planit të Zhvillimit Kombëtar në një nga fushat e mëposhtme: zhvillimi i burimeve njerëzore, investimet në sektorin prodhues dhe infrastruktura që lidhet me biznesin.

Duke iu përmbajtur parimeve të përqendrimit dhe ndikimit, objektivat e skemave të granteve janë përcaktuar në Memorandumin e Financimit, ndërsa kriteret e përshtatshmërisë dhe përzgjedhjes, procedurat e vlerësimit dhe marrëveshjet e zbatimit janë vendosur me detaje në Projektin Fiches. Projektet individuale përzgjidhen pas vendimit të Komisionit, pas thirrjes për propozim. Skemat e granteve mund të bashkëfinancojnë, për të cilat kontributi i PHARE është nën € 2 milionë. Manaxhimi i shëndoshë dhe i efektshëm kërkon mbajtjen e numrit të projekteve të vegjël në minimum. Kështu, përmasa minimale e projektit duhet të jetë, në parim, jo më e vogël se € 50.000 (Kontribut i PHARE). Mund të ketë përjashtime nga ky limit, ndërmjet të tjerash, për skemat e zbatuara mbi bazën EDIS ose kur Agjencia Zbatuese përkatëse është gjykuar si e aftë duke dhënë siguri për manaxhimin e shëndoshë financiar. Kufiri më i ulët nuk

zbatohet në rastin e OJQ-ve. Nëse projekti nuk është pjesë e skemës së granteve, zbatohet shuma minimale prej € 2 milionësh të projektit.

Lidhur me programet PHARE- BN, zbatohet skema e mësipërme e granteve. Projektet nën €50.000 (Kontributi i PHARE) mund të financohen sipas mundësisë së fondit të projekteve të vegjël në përputhje me nenin 5(2) të Rregullores së Komisionit 2760/98. Aplikimi për projektet minimale me përmasa të ndryshme nga cfarë duhet (Kontributi i PHARE €2 milionë) lejon pakësimin mbi bazën e vlerësimit rast pas rastit dhe nën rrethanat e bashkëpunimit të vërtetë ndërkufitar duke rënë brenda masave të përparësisë të përcaktuar në dokumentet e programimit të përbashkët.
Për informacione rreth PHARE, programeve të tij dhe detaje të pikave të kontaktit për personelin në zgjerimin DG Drejtori e Përgjithshme, ju lutemi konsultoni: http://europa.eu.int/comm/enlargement/pas/phare. Ju lutemi shënoni që deri në 2007 një Instrument i vetëm për Ndihmën e Para-pranimit (IPA) do të zëvendësojë instrumentet aktuale të PHARE, ISPA, SAPARD, CARDS dhe Instrumenti i Para-pranimit të Turqisë.

**ISPA është projektuar për të ndihmuar vendet kandidate në kapjen e standardeve infrastrukturore të BE në dy fusha: transporti dhe mjedisi.**

### 6.1.2.2. ISPA (Instrumenti për Politikat Strukturore për Para-pranimin)

ISPA është projektuar për të ndihmuar vendet kandidate në kapjen e standardeve infrastrukturore të BE në dy fusha: transporti dhe mjedisi. Gjatë periudhës nga 2000 deri në 2006, një shumë totale prej 1040 milionë euro çdo vit (me çmimet e 1999) është vënë në dispozicion për projektet në vendet kandidate. Përsa i përket ISPA-së, janë identifikuar objektivat e mëposhtëm:

- Të ndihmojë vendet kandidate për të kapur standardet mjedisore evropiane
- Të zgjerojë dhe të lidhë sistemet e transportit me rrjetet trans-evropiane të transportit
- Të familjarizojë vendet kandidate me politikat dhe proçedurat e fondeve të Kohezionit dhe ato Strukturore të BE-së.

Programi ISPA është i hapur për Bullgarinë dhe Rumaninë dhe që nga Janari 2005, Kroacia është gjithashtu e pranueshme.

Ka tre sektorë që mbulohen nga programi ISPA, kryesisht mjedisi, transporti dhe ndihma teknike. ISPA financon projekte të mëdha për mjedisin, veçanërisht ato lidhur me ndotjen e ujit, manaxhimin e mbeturinave dhe ndotjen e ajrit. Përsa i përket transportit, fondet nga ISPA -ja kanë si qëllim ndërtimin dhe riparimin e infrastrukturës së transportit në vendet kandidate dhe në krijimin e lidhjeve me rrjetet e transportit të Bashkimit.
Përsa i përket OJQ-ve, ato që merren me problemet e mjedisit mund të sigurojnë ndihmë teknike ose studime përgatitore brenda projekteve të ISPA -së. Ndihma teknike ka një rol të rëndësishëm në garantimin e nje niveli të lartë të cilësisë së projekteve, lidhur si me administrimin dhe ndikimin.
Qeveritë qendrore të vendeve kandidate janë marrësit e ndihmës së ISPS-së. Vetëm aplikimet e marra nëpërmjet koordinatorit të ISPA -së Kombëtare shqyrtohen nga shërbimet e Komisionit dhe projektet duhet të jenë pjesë e një plani investimi në sektorin e ISPA -së, të adoptuar nga vendet kandidate. Aplikimi do të shqyrtohet nga shërbimet e Komisionit dhe (kur është e nevojshme) diskutohet me vendin kërkues. Kur Komisioni e konsideron projektin të pranueshëm, ai do të dorëzojë projektin për të marrë mendimin e Komitetit të Manaxhimit, të përbërë nga përfaqësues të vendeve anëtare. Pasi është marrë mendimi pozitiv nga Komiteti i Administrimit, Komisioni do të përshtasë projektin dhe do të dorëzojë një Memorandum Financimi për nënshkrim në vendin kërkues.
Për të aplikuar për financim sipas programit ISPA, OJQ-të duhet të konsultojnë dokumentet kryesore dhe informacionin mbi ISPA -në me qëllim që të identifikojnë sektorët që mbulohen nga ndihma e ISPA –së që përshtaten me fushën e tyrë të veprimtarisë. Dokumentet kryesore lidhur me procedurat e ISPA -së janë manuali i ISPA -së, manuali i DIS-së (sistemi i Zbatimit të Decentralizuar) dhe udhëzuesi praktik për procedurat e kontraktimit. Të gjitha këto dokumente , bashkë me broshurat e informacionit gjenden në:
http://europa.eu.int/comm/regional_policy/funds/ispa/docum_en.htm#manuals

Informacione të mëtejshme për mundësitë e ISPS-së mund të merren nga Directorate e ISPA -së në Drejtorinë Përgjithshme të Politikës Rajonale në Komisionin Europian, delegacionet evropiane në vendet kandidate dhe koordinatorët kombëtarë të ISPA -së në vendet kandidate. Adresat janë të disponueshme në internet: http://europa.eu.int/comm/regional_policy/funds/ispa/contacts_en.htm#2

**Directorate H:** Programmes and Projects in France, Poland, Portugal , Slovenia and ISPA

Luis RIERA FIGUERAS - Director
Tel : 32 2 296 5068
Fax : 32 2 295 4397
E-mail: luis.riera-figueras@cec.eu.int

Erich UNTERËURZACHER
(Unit H4) — Head of Unit ISPA
Tel :32 2 299 3964
Fax :32 2 295 3614
E-mail: erich.unterëurzacher@cec.eu.int
Faqe elektronike:http://www.europa.eu.int/comm/dgs/
regional_policy/index_en.htm

**Koordinatorët Kombëtarë:**

Bullgaria
c/o Boriana PENCHEVA
Ministry of Finance, Management of EU Funds Directorate
102 Rakovski Street - 1040 Sofia
Tel: (359)2 9859 2900 // 2901 or (359)2 980 6401
Fax: (359)2-987 9888 or (359) 2 9859 2928
E-mail : b.pencheva@minfin.bg

Croatia
c/o Davor CILIC,
Ministry of European Integration
Petreticev trg 2, Zagreb
Tel: 385 1 4599 360
Fax: 385 1 4599 - 460
E-mail: davor.cilic@mei.hr

Romania
c/o Eugen TEODOROVICI
Ministry of Public Finance
Bvd. Libertatii 12, Bucuresti 5
Tel : (w40)21 335 98 77 Fax : (ë40) 21 335 98 88
E-mail: eugen.teodorovici@mfinante.gv.ro

### 6.1.2.3. SAPARD (Program i Veçantë i Para-pranimit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural)

SAPARAD, pjesë e ndihmës së para-pranimit për vendet kandidate, jep ndihmesë në fushën e bujqësinë dhe zhvillimit rural. Programi është i hapur për Bullgarinë, Rumaninë dhe Kroacinë.

SAPARD ka dy përparësi kryesore: Të ndihmojë çdo vend të zbatojë "**acquis communautaire**" dhe të zgjidhë përparësitë dhe problemet specifike që lidhen me zhvillimin e një sektori të qëndrueshëm të bujqësisë dhe zonave rurale. Ndryshe nga masat e tjera, SAPARD-i administrohet tërësisht në nivel kombëtar dhe Komisioni nuk përfshihet në asnjë nga fazat e tij. Përsa i përket programeve të tjera të ndihmës së para-pranimit , SAPARD-i përfaqëson mbështetjen për arritjen e përparësive të politikës kyçe të përcaktuara në Partneritetet e Pranimit dhe Programet Kombëtare për Adoptimin e **'acquis'**. Në sektorin e agro-ushqimit këto përfshijnë në veçanti:

**SAPARAD, pjesë e ndihmës së para-pranimit për vendet kandidate, jep ndihmesë në fushën e bujqësinë dhe zhvillimit rural. Programi është i hapur për Bullgarinë, Rumaninë dhe Kroacinë.**

- Barazimin me 'acquis' bujqësor
- Zbatimin e kërkesave veterinare, fitosanitare dhe të marketimit
- Ngritjen e standardeve të përpunimit të ushqimeve
- Ristrukturimin e sektorit agro-ushqimor për të përmirësuar konkurencën
- Zbatimin e politikave koherente të zhvillimit strukturor e rural

Buxheti i përgjithshëm i SAPARD-it është € 529 milionë në çdo vit të programit shtatëvjeçar (2000-2006). Shpërndarja sipas vendeve bazohen në kriteret e mëposhtme: madhësia e popullsisë bujqësore, zona e përgjithshme bujqësore, GDP për frymë, bazuar në barazinë e fuqisë blerëse, dhe situata specifike e zonave rurale. Në financimin e programit, Komuniteti mund të kontribuojë deri në 75% të shpenzimeve publike të përgjithshme, megjithëse, kjo mund të ngrihet deri në 100% të vëllimit të përgjithshëm të programit për ndihmë teknike.

OJQ-të që kërkojnë mundësi financimi nga SAPARD-i duhet të ndjekin vetëm ato masa, që mund të përfshihen në fushat e tyre të veprimtarisë. Masa si shumëllojshmëria ekonomike, ngritja e grupeve të prodhuesve, rinovimi dhe zhvillimi i fshatrave, përmirësimi i trajnimit profesional dhe ndihma teknike janë më të mundshme për t'u përshtatur me veprimtaritë e OJQ-ve.

Duke ndjekur parimin e administrimit të decentralizuar të ndihmesës së para-pranimit, një organ kombëtar, d.m.th., Agjencia e SAPARD—it është e ngarkuar me administrimin e decentralizuar të projekteve të programit të SAPARD-it. Kështu, aplikimet për projektet duhet të dorëzohen në agjencinë kombëtare të SAPARD-it. Përgjegjësitë praktike për projektet do të kalojnë te vendi kandidat, ndërsa zbatimi i Programit do t'i nështrohen kontrollit dhe auditimit nga Komisioni.

Duke marrë parasysh se SAPARD-i është plotësisht i decentralizuar, të gjitha kërksesat për tendera publikohen nga Agjencia e SAPARD-it në nivel kombëtar. Për informacione të mëtejshme kontaktoni ose delegacionet e Komisionit në vendet kandidate ose Agjencitë në çdo vend:

**DG-Argiculture:**

AGRI B2 — Enlargement
Mr Rudy VAN DER STAPPEN (Head of Unit)
Tel : 32 2 295 4509

AGRI B3 — Neighbourhood Policy, EFTA
Mr Nicolas VERLET (Head of Unit)
Tel : 32 2 296 1508

SAPARD — E4 (Programme Manager)
Mr Jorge CASQUILHO
Tel : 32 2 296 0304
Fax : 32 2 295 1746

Për Agjencitë e SAPARD-it në Vendet Kandidate, ju lutemi shikoni: http://europa.eu.int/comm/agriculture/external/enlarge/countries/index_en.htm

## 6.1.3. TURQIA

### Ndihmë për Para-pranimin e Turqisë (22 02 04 01)

**Buxheti i dhënë:** 470.50 milionë

Kjo linjë buxheti mbulon operacione të ndryshme, qëllimi i të cilëve është të ndihmojnë Turqinë të plotësojë kriteret e anëtarësimit në

BE. Strategia e para-pranimit për Turqinë u përcaktua në Këshillin Evropian të Helsinkit të 1999 dhe është rishikuar më pas. Pra, strategia e para-pranimit mbështet ndërtimin e institucioneve, forcimin e strukturave që duhet të veprojnë në përputhje me **acquis**, dhe kohezioni social dhe ekonomik. Në mënyrë të veçantë, operacionet e financuara sipas programit mund të klasifikohen në dy kategori:

- Ndërtimi i institucionev për të mundësuar zbatimin e *acquis communautaire*, duke vënë theks të veçantë mbi: afrimin e legjislacionit; reformat strukturore dhe politikat rajonale; nxitjen e demokracisë, dialogut social dhe shoqërisë civile; bashkëpunimi aktiv në fushat e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme; dhe hapja e Programeve të Komunitetit, gjithashtu në fushën e përjashtimit shoqëror.
- Finamcimi investimeve për të ndihmuar Turqinë të veprojë në përputhje me standardet legjislative të Komunitetit dhe të adoptojë *acquis communautaire* në fushën e kohezionit ekonomik dhe shoqëror. Ndihmesa këtu do të marrë parasysh progresin e bërë drejt adoptimit të acquis, dhe në veçanti i kushtohet vëmendje pjesëmarrjes në projektet e caktuara (për të ngritur kapacitetin juridik dhe në projektet në fushën e drejtësisë) dhe në disa programe dhe agjenci të Komunitetit si dhe përdorimi i asistencës teknike të dhënë nga TAIEX (Zyra e Informacionit për Shkëmbimin e Asistencës Teknike). Gjithashtu, matet shkalla e bashkëpunimit ndërkufitar dhe masat për informacionin dhe arsimin për të përkrahur shoqërinë civile dhe për të forcuar dimensionin njerëzor tëTurqisë.

Pjesë e shumës së dhënë do të përdoret për të përmirësuar situatën e grave dhe duhet shënuar se të gjitha masat i nënshtrohen perspektivës gjinore.

**Kontaktoni:** Mr Martin HARVEY
Directorate-General Enlargement – B1
Tel : 32 2 299 5681
Fax : 32 2 299 1044
E-mail enlargement@cec.eu.int

**Faqja elektronike:**
http://europa.eu.int/comm/enlargement/turkey/index.htm#financial

## 6.2. NDIHMA PËR BALLKANIN PERËNDIMOR - CARDS

### Ndihmë për vendet e Ballkanit Perëndimor (22 05 01)

**Buxheti i dhënë:** 180.00 / 198.00 / 59.50 milionë

**Ky program ndihme ka për objekt Ballkanin Perëndimor me qëllim që të krijojë më shumë stabilitet në rajon dhe lidhje më të ngushta ndërmjet rajonit dhe BE-së, kryesisht nëpërmjet Proçesit të Stabilizim-Asocimit (SAP), i cili është kuadri politik i BE-së drejt rajonit.**

**Për më tepër, në samitin e Zagrebit u konfirmua që SAP është një instrument me objektiv të fundit anëtarësimin në BE.**

Ky program ndihme ka për objekt Ballkanin Perëndimor me qëllim që të krijojë më shumë stabilitet në rajon dhe lidhje më të ngushta ndërmjet rajonit dhe BE-së, kryesisht nëpërmjet Proçesit të Stabilizim-Asocimit (SAP), i cili është kuadri politik i BE-së drejt rajonit. SAP ndjek objektivat e mëposhtme: stabilizimi dhe kalimi në ekonomi tregu; bashkëpunimi rajonal; dhe perspektiva e pranimit në BE. Vendet që kanë bërë përparim të mjaftueshëm nën ASP-në mund të hyjnë në marrëdhënie kontraktuale zyrtare me BE-në në formën e një Marrëveshjeje të Stabilizim-Asocimit, e cila është projektuar për të ndihmuar çdo vend të përparojë me ritmet e veta drejt integrimit më të madh evropian. Për më tepër, në samitin e Zagrebit u konfirmua që SAP është një instrument me objektiv të fundit anëtarësimin në BE.

Vendet përfituese sipas programit CARDS janë Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Kroacia (deri në fund të vitit 2006), ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Serbia e Mali i Zi bashkë me Kosovën. Veprimtaritë më specifike sipas këtij programi përfshijnë: stabilizimin e rajonit; kthimin e refugjatëve dhe personave të zhvendosur; rindërtimi dhe asistenca; ngritja e një kuadri institucional dhe legjislativ për të mbështetur demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve; pajtimi dhe konsolidimi i shoqërisë civile dhe pavarësia e mediave; forcimi i ligjshmërisë dhe lufta kundër krimit të organizuar; zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe reformat e ekonomisë së tregut; bashkëpunimi rajonal, ndërkombësh, ndërkufitar dhe ndërrajonal; zhvillimi social, në veçanti lehtësimi i varfërisë, barazia gjinore, arsimi, mësimdhënia e trajnimi dhe rehabilitimi mjedisor.

Vëmendje e veçantë i kushtohet nxitjes së të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit. Kjo shumë e dhënë synon, gjithashtu, të mbulojë programet operacionale që i janë besuar Agjencisë Evropiane për Rindërtimin (EAR) dhe shpenzimet e saj operative.

Sipas Rregullores të Këshillit 2666/2000 (baza ligjore për CARDS), organet e mëposhtme do të jenë të pranueshme për financim: organet

lokale dhe rajonale, organet publike dhe gjysmëpublike, partnerët socialë, organizatat që japin mbështetje për bizneset, kooperativat, shoqëritë reciproke, shoqatat, fondacionet dhe organizatat joqeveritare. Asistenca e Komunitetit do të jetë në formën e granteve dhe bashkëfinancimi do të kërkohet, kur është i mundshëm.

**Bashkëpunimi dypalësh:**
Asistenca e Këshillit të Evropës i është përshtatur nevojave dhe përparësive të reformave të çdo vendi. Ajo mbështet SAP-në dhe zbatimin e Marrëveshjeve të Stabilizim-Asocimit (SAA) dhe përcakton vlerat dhe parimet e përbashkëta që drejtojnë marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe vendit të interesuar. Disa nga përparësitë më të rëndësishme specifike sipas vendeve janë:

**Asistenca e Këshillit të Evropës i është përshtatur nevojave dhe përparësive të reformave të çdo vendi.**

- *Shqipëria:* lufta kundër krimit të organizuar; mashtrimet dhe korrupsioni; forcimi i administratës publike; mbështetja e tregëtisë, arsimit dhe transportit; monitorimi i ndotjes dhe urbanistikës; dhe reforma në sistemin elektoral.
- *Bosnje dhe Hercegovina:* kthimi i refugjatëve; mbështetja e institucioneve (taksat dhe doganat); zhvillimi lokal dhe kohezioni social; polici, azilkërkimi dhe migracioni; manaxhimi i integruar i kufirit; dhe mjedisi e burimet natyrore.
- *Kroacia:* kthimi i refugjatëve; tregëtia, klima e investimeve dhe kohezioni social; polici dhe krimi i organizuar; administrim i integruar i kufirit, reforma në administratën publike; dhe mjedisi e burimet natyrore.
- *Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë:* stabilizimi demokratik; reforma në administratën publike; çështjet e brendshme dhe të drejtësisë; investimet, tregëtia dhe infrastruktura; arsimi dhe punësimi; dhe mjedisi.
- *Serbia dhe Mali i Zi:* marrëdhëniet ndëretnike dhe shoqëria civile; tregëtia dhe zhvillimi i sektorit privat; zhvillimi i infrastrukturës; reformat e gjyqësorit; manaxhimi i integruar i kufirit; emigrimi dhe azilkërkimi; lufta kundër krimit të organizuar.

Kontrolloni http://europa.eu.int/comm/enlargement/cards/bilateral_en.htm për informacione të mëtejshme.

**Bashkëpunimi rajonal:**
Një nga elementet kryesore të SAP-it është bashkëpunimi rajonal midis pesë vendeve në Ballkanin Perëndimor, bazuar në modelin e integrimit dhe bashkëpunimit në BE. Fushat kryesore të ndërhyrjes janë:

**Një nga elementet kryesore të SAP-it është bashkëpunimi rajonal midis pesë vendeve në Ballkanin Perëndimor, bazuar në modelin e integrimit dhe bashkëpunimit në BE. Fushat kryesore të ndërhyrjes janë**

- *Nxitja e administrimit të integruar të kufirit:* Çështjet e administrimit të kufirit janë mbështetur me programe të furnizimit me pajisje, të investimeve dhe të ndërtimit të institucioneve, bazuar në një strategji të qartë kombëtare. Mbështetja përdoret për të lehtësuar rrjedhën e tregëtisë dhe njerëzve përmes kufijve, për të forcuar kontrollin në kufi, për të zhvilluar rajonet kufitare dhe për të nxitur bashkëpunimin aktiv ndërmjet agjencive të përfshira.
- *Nxitja e stabilitetit demokratik:* Meqënëse, shkalla e nevojave të stabilizimit demokratik në rajon është e madhe, fonde shtesë për programet kombëtare CARDS dhe EIDHR do të jepen nga Programi Rajonal CARDS për të mbështetur punën e fondacioneve dhe organizatave ndërkombëtare ekzistuese për programe që përfshijnë më shumë së një vend, veçanërisht në fushat e mëposhtme: qeverisja dhe sundimi i ligjit; liria e mendimit dhe e medias; respektimi i minoriteteve dhe diversiteti; lufta kundër racizmit dhe ksenofobisë; parandalimi dhe zgjidhja e konflikteve; dhe zhvillimi i qëndrueshëm.
- *Ndërtimi i institucioneve:* Në këtë fushë, fokusi kryesor është mbi reformën e përgjithshme të shërbimeve dhe në forcimin e kapaciteteve të administratës publike në administrimin fiskal dhe financiar, prokurimet, çështjet e brendshme dhe të drejtësisë, marëveshjet e tregëtisë dhe veprimtaritë që lidhën më lehtësimin e tregëtisë, si dhe familjarizimi me acquis communautaire.
- *Zhvillimi i infrastrukturës rajonale:* Ky program mbështet zhvillimin e strategjive koherente për infrastrukturën (transport, energji dhe mjedis) me një dimension ndërkombëtar. Një nga veprimtaritë kryesore është zhvillimi i studimeve për të shtrirë Sistemin e Rrjetit Pan-Evropian në Ballkanin Perëndimor. Fusha e dytë e ndërhyrjes është forcimi i kapaciteteve në institucionet e përfshira në sigurimin dhe kontrollin e trafikut ajror.
- *TEMPUS:* Ky program ka të bëjë me arsimin e lartë dhe trajnimin profesional. Për më shumë informacion rreth programit, ju lutemi shikoni programin TEMPUS te përshkrimi i TACIS.
- *SIGMA (Mbështetja për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Administrimit):* Ky program fokusohet në mbështetjen e reformës administrative në vendet në tranzicion duke ngritur kuadre ligjore dhe institucionale të efektshme për institucionet publike nën autoritete e zgjedhur në mënyrë demokratike, që veprojnë nën sundimin e ligjit dhe të përshtatshme për ekonominë e tregut
- *Binjakëzimi:* Programi nuk është një program rajonal por një instrument që u ofrohet të gjitha vendeve të rajonit për t'u financuar

nëpërmjet Akordimeve Kombëtare të CARDS. Ai mbështet dërgimin e ekspertëve civilë nga shtetet e BE-së të punojnë si këshilltarë në institucione në shtetin përfitues për të realizuar programet e ndërtimit të institucioneve.

Kërkesat për propozime për grante dhe tendera për projektet CARDS janë publikuar në Faqen elektronike të EuropeAid: http://www.europa.eu.int/comm/europeaid/cgi/frame12.pl. Ju lutemi shënoni se që nga viti 2007 një instrument i vetëm për parapranimin do të zëvendësojë instrumentet aktuale të CARDS, PHARE, ISPA, SAPARD, Instrumentin e Para-pranimint të Turqisë

**Kontaktoni:** Ms Sofia PAPANTONIADOU (Project Manager)
Directorate General Enlargement – D4
Tel :32 2 299 8916
E-mail sofia.papantoniadou@cec.eu.intcec.eu.int

**Faqja elektronike:**
ttp://europa.eu.int/comm/enlargement/cards/index_en.htm

## Ndihma për Rindërtimin e Kosovës (22 05 03)

**Buxheti i dhënë:** 59.50 milionë

